



International
Labour
Organization

INSTAT
Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikës

FËMIJËT QË PUNOJNË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

REZULTATET E STUDIMIT KOMBËTAR
MBI PUNËN E FËMIJËVE PËR VITIN 2010

International
Programme
on the Elimination
of Child Labour
(IPEC)

**International
Labour
Organization**

Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikës

FËMIJËT QË PUNOJNË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

**REZULTATET E STUDIMIT KOMBËTAR
MBI PUNËN E FËMIJËVE PËR VITIN 2010**

Korrik 2012

E drejta e autorit © Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP) dhe Instituti i Statistikave (INSTAT)
i Republikës së Shqipërisë, 2012
Botimi i parë 2012

Kërkesa për të marrë të drejtën e riprodhimit të raportit duhet të drejtohet në ONP: ONP Publikime (të drejtat dhe lejet), Organizata Ndërkombëtare e Punës, CH-1211 Gjenevë 22, Zvicër, ose me e-mail: pubdroit@ilo.org, apo në Institutin e Statistikave të Republikës së Shqipërisë (INSTAT), Bul. “Zhan D’Ark”, Nr .3, Tiranë, Shqipëri. Kërkesa për të marrë të drejtën e përkthimit duhet të bëhet në ILO, duke vepruar në emër të të dy organizatave, në adresën e përmendur më lart.

Bibliotekat, institucionet dhe përdorues të tjerë të regjistruar si organizata me të drejta për riprodhim mund të bëjnë kopje në pajtim me licencat lëshuar atyre për këtë qëllim. Për të gjetur organizatën me të drejtat e riprodhimit në vendin tuaj, vizitoni faqen: www.ifro.org

ONP; INSTAT

Fëmijët që punojnë në Republikën e Shqipërisë – Rezultatet e studimit kombëtar mbi punën e fëmijëve për vitin 2010 / Organizata Ndërkombëtare e Punës, Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (IPEC), Instituti i Statistikave (INSTAT), Republika e Shqipërisë. - Budapest: ILO, 2012.

ISBN: 978-92-2-826977-2 (Print); 978-92-2-826978-9 (Web PDF)

Organizata Ndërkombëtare e Punës, Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (IPEC),
Instituti i Statistikave (INSTAT), Republika e Shqipërisë

Puna e fëmijëve / fëmijë që punon / Shqipëri - 13.01.2

I disponueshëm në anglisht: *Working children in the Republic of Albania – The results of the 2010 National Child Labour Survey*, ISBN: 978-92-2-126977-9 (Print); 978-92-2-126978-6 (web PDF), Budapest, 2012.

Katalogu i publikimit të të dhënave ONP (ILO)

Emërtimet e përdorura në këtë publikim dhe paraqitja e të dhënave nuk nënkuptojnë shprehjen e ndonjë opinioni nga ana e ILO-s dhe INSTAT-it në lidhje me statusin ligjor të ndonjë shteti, rajoni, territori, të autoriteteve të tij apo në lidhje me përcaktimin e kufijve të saj.

ILO dhe INSTAT nuk mbajnë asnjë përgjegjësi në rast të përdorimit të këtyre të dhënave me gabime e pasaktësi si dhe të çdo pasoje që lidhet to.

Printuar në Shqipëri
Redaktimi letrar dhe faqesja: Klara Shoshi

MIRËNJOHJE

Ky raport u përpunua prej Meltem Dayıoğlu nga Departamenti Ekonomik i Universitetit Teknik të Lindjes së Mesme, Ankara (Turqi), nën koordinimin e Pranvera Elezit, INSTAT, dhe Mustafa Haki Ozel, ZNP-PNEPF (ILO-IPEC) zyra e Gjenevës.

Financimi për këtë publikim është dhënë nga Departamenti i Punës i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (Projekti INT/08/93/USA).

Ky botim nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet ose politikat e Departamentit të Punës të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, as nuk përmenden emra të tregtisë, produkteve komerciale ose organizata që kërkojnë miratim nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

PARATHËNIE

Fenomeni i punës së fëmijëve është duke tërhequr vëmendjen e vazhdueshme dhe në rritje të komunitetit kombëtar dhe ndërkombëtar. Në dekadën e fundit, qeveria shqiptare i ka dhënë një përparësi të veçantë mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Kështu, çështjet e fëmijëve, duke përfshirë punën e fëmijëve dhe format më të këqija të punës së fëmijëve, janë integruar në mënyrë sistematike në shtyllat kryesore të politikave qeveritare, si: Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim, Marrëveshja e stabilizim-asocimit (MSA) me Bashkimin Europian, Objektivat e zhvillimit të mijëvjeçarit (OZhM), dhe strategjive të tjera sektoriale të tilla si: Strategjia kombëtare për fëmijët, Strategjia kombëtare për zhvillimin e shërbimeve sociale, Strategjia kombëtare për punësim dhe formim profesional, Strategjia kombëtare për trafikimin e fëmijëve etj. Fushat e ndërhyrjes janë: mbijetesat e fëmijëve, mbrojtja e fëmijëve, zhvillimi i fëmijëve, përfshirja dhe pjesëmarrja e fëmijëve.

Gjatë këtyre viteve, politikëbërësit janë angazhuar mjaft duke adresuar fenomenin e punës së fëmijëve, duke ratifikuar konventa e instrumente ndërkombëtare, si: Konventa e OKB-së “Mbi të drejtat e fëmijës”, shkurt 1992; Konventa e ONP-së, Nr.138 “Mbi moshën minimale të punës”, shkurt 1998; Konventa e ONP-së, Nr.182, “Mbi format më të rënda të punës së fëmijëve”, gusht 2001; Konventa e OKB-së “Kundër krimit të organizuar”, tetor 2002; Protokollin e OKB-së “Për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe të fëmijëve”, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara “Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar”, gusht 2002; Konventa e Këshillit të Europës “Mbi veprimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, shkurt 2007 (hyrë në fuqi në shkurt 2008); Konventa e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e fëmijëve kundër shfrytëzimit dhe abuzimit seksual, prill 2009.

Megjithatë, ky kuadër ligjor i vetëm është i mjaftueshëm për të trajtuar kompleksitetin e situatës së punës së fëmijëve në Shqipëri. Përveç kësaj, një pjesë e legjislacionit kombëtar përmban dispozita të rëndësishme për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe fëmijëve të përfshirë në punë: Kushtetuta shqiptare (1998) përmban dispozita që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, keqtrajtimi dhe shfrytëzimi në punë. Arsimi është i detyrueshëm deri në moshën 16 vjeç, që është edhe mosha minimale për praninë në punë. Kodi i punës (1996) ndalon punësimin e fëmijëve nën moshën 16 vjeç dhe siguron që personat e rinj nën moshën 18 vjeç nuk mund të jenë të punësuar në veprimtari ose punë që rrezikojë sigurinë, shëndetin dhe moralin e tyre. Kodi penal (1995, i ndryshuar në vitin 2001 dhe 2008) vendos sanksione të qarta për personat që abuzojnë me fëmijët në forma të ndryshme, duke përfshirë trafikimin, punën e fëmijëve, pornografinë dhe keqtrajtimin.

Në këtë kuadër, në vitin 1999, qeveria shqiptare nënshkroi Memorandumin e mirëkuptimit me Organizatën Ndërkombëtare të Punës, të përfaqësuar nga Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve. Bazuar në këtë memorandum, në vitin 2001, u ngrit Komiteti Drejtues Kombëtar (KDK) kundër Punës së Fëmijëve, i kryesuar nga ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Gjithashtu, pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPCSSHB) u ngrit Njësia e Punës së Fëmijëve, për të vepruar si pikë fokale kombëtare për çështjet e punës së fëmijëve, dhe sekretariati për KDK-në. Në mars të vitit 2010, njësia u bë pjesë e strukturës organike të MPCSSHB-së, financuar

nga buxheti i shtetit. Në vitin 2010, qeveria e Shqipërisë, nëpërmjet Institutit Kombëtar të Statistikave (INSTAT), filloi zhvillimin e anketës për punën e fëmijëve (APF), me mbështetjen financiare dhe teknike të ILO/IPEC-SIMPOC. Anketa e punës së fëmijëve përfundoi në vitin 2011, duke mundësuar mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore në tregun e punës si dhe të aktiviteteve të fëmijëve. U intervistuan rreth 6840 familje me fëmijë të moshave 5-17 vjeç.

Ky raport ofron një informacion të pasur e të vlefshëm në lidhje me gjendjen e punës së fëmijëve në Shqipëri, duke përfshirë: (i) karakteristikat demografike gjithëpërfshirëse dhe socio-ekonomike të të gjithë fëmijëve të moshës shkollore 5-17 vjeç; (ii) numrin e fëmijëve të angazhuar në aktivitete ekonomike dhe joekonomike; (iii) njohuri mbi kushtet e punës, shëndetin dhe çështjet e sigurisë (lloji, shpeshtësia dhe ashpërsia e lëndimeve/sëmundjeve) të fëmijëve ekonomisht aktivë dhe arsyet pse fëmijët punojnë. Publikimi i raportit mbi punën e fëmijëve shqiptarë do të jetë shumë i dobishëm për politikëbërësit dhe vendimmarrësit në nivel qendror dhe lokal. Shpresojmë që rezultatet të jenë të vlefshme për një audiencë më të gjerë, si: analistë dhe akademikë apo institucione kërkimore, me qëllim përdorimin e plotë të të dhënave në studime të çështjeve të tjera që lidhen me punën e fëmijëve në Shqipëri.

Ne shpresojmë që ky raport të nxisë një dialog efektiv rreth vizioneve, strategjive dhe angazhimeve të përbashkëta për parandalimin dhe reduktimin e punës së fëmijëve në Shqipëri. Do të dëshironim t'u shprehnim falënderime të sinqerta Organizatës Ndërkombëtare të Punës, për sigurimin dhe mbështetjen financiare dhe teknike, si edhe ekipit të ekspertëve ndërkombëtarë dhe kombëtarë, të cilët punuan për përgatitjen e këtij raporti të vlefshëm.

Dr. Ines NURJA
Drejtore e përgjithshme
Institutit të Statistikave



PËRMBAJTJA E LËNDËS

MIRËNJOHJE	iii
PARATHËNIE	v
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	ix
HYRJE	1
SEKSIONI 1 METODOLOGJIA E STUDIMIT DHE GRUPI I TË DHËNAVE	3
1.1. Kampioni	3
1.2. Pyetësorët	4
1.3. Përkufizimet e fëmijëve të punësuar dhe punëtoreve fëmijë	5
1.4. Karakteristikat e kampionit	6
1.4.1. <i>Shpërndarja e grupmoshave</i>	6
1.4.2. <i>Shpërndarja e aktiviteteve të fëmijëve sipas grupmoshës</i>	7
1.4.3. <i>Shpërndarja e fëmijëve sipas marrëdhënies me kreun e familjes</i>	8
SEKSIONI 2 PUNËSIMI, SHKOLLIMI DHE SHËRBIMET E PAPAGUARA NË FAMILJE TË FËMIJËVE	9
2.1. Madhësia e popullsisë së fëmijëve	9
2.2. Punësimi i fëmijëve	10
2.3. Shkollimi i fëmijëve	12
2.3.1. <i>Ndjekja e shkollës</i>	12
2.3.2. <i>Klasa për moshë</i>	14
2.4. Shërbimet e papaguara në familje të kryera nga fëmijët	15
2.5. Fëmijët në aktivitete të shumëfishta	18
SEKSIONI 3 NATYRA E PUNËSIMIT TË FËMIJËVE DHE PUNA E FËMIJËVE	20
3.1. Aktiviteti ekonomik	20
3.2. Profesioni	21
3.3. Vendi i punës	23
3.4. Statusi në punësim	24
3.5. Fitimet dhe përfitimet	25
3.6. Punëtorët fëmijë	26
3.6.1. <i>Lloji i aktivitetit ekonomik të kryer nga punëtorët fëmijë</i>	27
3.6.2. <i>Profesionet e ushtruara nga punëtorët fëmijë</i>	28
3.6.3. <i>Statusi në punësim i punëtorëve fëmijë</i>	29
3.7. Ndryshimet rajonale të fëmijët që punojnë dhe punëtorët fëmijë	29

SEKSIONI 4	SHËNDETI, SHKOLLIMI DHE PUNËSIMI I FËMIJËVE	32
4.1.	Pasojat mbi shëndetin dhe rreziqet në vendin e punës për fëmijët që punojnë	32
4.1.1.	<i>Pasojat mbi shëndetin e fëmijëve që punojnë dhe punëtorëve fëmijë</i>	32
4.1.2.	<i>Rreziqet e vendit të punës për fëmijët që punojnë dhe punëtorët fëmijë</i>	36
4.2.	Rezultatet në shkollë për fëmijët që nuk punojnë, për fëmijët që punojnë dhe për punëtorët fëmijë	38
4.2.1.	<i>Shkalla e ndjekjes (frekuentimit) të shkollës</i>	38
4.2.2.	<i>Mosha e fillimit të shkollës</i>	40
4.2.3.	<i>Klasa më e lartë e përfunduar</i>	41
4.2.4.	<i>Mungesa në shkollë</i>	42
4.2.5.	<i>Formimi profesional</i>	43
KONKLUZION		44
Referencat		46
Shtojca A:	Konceptet dhe përkufizimet	47
Shtojca B:	VENDIMI nr. 207, datë 9.5.2002, MBI PËRCAKTIMIN E PUNËS SË VËSHTIRË APO TË RREZIKSHME	49
Shtojca C:	Sëmundje/dëmtime të shkaktuara nga puna te punëtorët fëmijë dhe te fëmijët që punojnë, por që nuk konsiderohen punëtorë fëmijë	51
ANKETA KOMBËTARE PËR PUNËN E FËMIJËVE		53

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në vitin 2010, Instituti i Statistikave (INSTAT) i Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me ILO/ IPEC (Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve) bëri Studimin e parë kombëtar mbi punën e fëmijëve (SPF) në Shqipëri. SPF-ja u projektua për të ofruar tregues mbi tre aspektet kryesore të jetës së fëmijëve: punësimi, shkollimi dhe shërbimet e papaguara në familje. Studimi mbuloi 7319 familje që përmbanin 27 865 individë, nga të cilët 6003 ishin fëmijë të moshave 5-17 vjeç.

SPF-ja vlerëson se 57 000 fëmijë ose 8.2 për qind e 5-17-vjeçarëve janë ekonomikisht aktivë (tabela E.1). Duke mos marrë parasysh fëmijët që po kërkojnë punë (informacioni mbi papunësinë është i disponueshëm vetëm për 15-17-vjeçarët), shkalla e punësimit të fëmijët është vlerësuar të jetë 7.7 për qind. Kjo përqindje priret të rritet me moshë, me 2.4 për qind për 5-11-vjeçarët e punësuar, krahasuar me 9.4 për qind të 12-14-vjeçarëve dhe 16.8 për qind të 15-17-vjeçarëve. Djemtë priren të kenë një shkallë më të lartë punësimi sesa vajzat (tabela E.2). Ky hendek gjinor rritet me moshë, duke arritur 7.6 për qind të fëmijët 15-17-vjeçarë. Në tërësi, vlerësohet se fëmijët punojnë mesatarisht 18.7 orë në javë.

Tabela E.1. Shpërndarja e fëmijëve sipas grup-moshave dhe statusit të punës

	Moshat 5-17	Moshat 5-11	Moshat 12-14	Moshat 15-17
Popullsia e fëmijëve	698 600	354 400	163 600	180 600
Të punësuar	54 000	8400	15 300	30 300
Fuqia punëtore*	57 000	8400	15 300	33 300
Puna e fëmijëve	35 500	8400	12 600	14 600
Shkalla e punësimit (%)	7.7%	2.4%	9.4%	16.8%
SHPFP (%)**	8.2%	2.4%	9.4%	18.4%
Puna e fëmijëve (%)	5.1%	2.4%	7.7%	8.1%

* Fuqia punëtore përfshin si individët e punësuar, ashtu dhe ata të papunësuar; megjithatë, papunësia është regjistruar vetëm për fëmijët e moshës 15-17 vjeç.

** SHPFP: Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore.

Tabela E.2. Shpërndarja e djemve dhe e vajzave sipas grup-moshave dhe statusit të punës

	Moshat 5-17 vjeç		Moshat 5-11 vjeç		Moshat 12-14 vjeç		Moshat 15-17 vjeç	
	Djem	Vajza	Djem	Vajza	Djem	Vajza	Djem	Vajza
Popullsia e fëmijëve	357 800	340 800	189 700	164 600	79 600	84 000	88 500	92 100
Të punësuar	32 400	21 600	5400	3000	8700	6600	18 300	12 000
Fuqia punëtore*	34 000	23 000	5400	3000	8700	6600	19 900	13 400
Shkalla e punësimit (%)	9.1	6.3	2.9	1.8	10.9	7.9	20.7	13.1
SHPFP (%)**	9.5	6.7	2.9	1.8	10.9	7.9	22.5	14.5

* Fuqia punëtore përfshin si individët e punësuar, ashtu edhe ata të papunësuar; megjithatë, papunësia është regjistruar vetëm për fëmijët e moshës 15-17 vjeç.

** SHPFP: Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore.

FËMIJËT QË PUNOJNË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Rezultatet e studimit kombëtar mbi punën e fëmijëve për vitin 2010

Një përqindje e mirë (40.9%) e fëmijëve angazhohen në shërbime të papaguara në familje (SHPF). Si në rastin e punësimit, kjo përqindje rritet me moshë, duke arritur 68.8 për qind te fëmijët e moshave 15-17 vjeç. Përqindja e vajzave të angazhuara në SHPF është më e lartë se ajo e djemve (49.8% kundrejt 32.5%). Në tërësi, fëmijët harxhojnë mesatarisht 7.2 orë në javë të angazhuar në SHPF.

Mbi 90 për qind e fëmijëve të moshave 5-17 vjeç ndjekin shkollën. Shkalla e ndjekjes së shkollës është më e lartë (94.8%) te fëmijët që ndjekin arsimin e detyruar (domethënë fëmijët e moshave 6-15 vjeç). Janë regjistruar rënie të dukshme në ndjekjen e shkollës pas arsimit të detyruar, një rënie prej 81.1 për qind dhe 75.2 për qind, respektivisht, te 16 dhe 17-vjeçarët.

Tabela E.3. Modele të përdorimit të kohës nga fëmijët e moshave 6-17 vjeç, sipas seksit

	Të gjithë	Djemtë	Vajzat
Shkollë + të punësuar + shërbime të papaguara në familje	28 200 4.3%	14 800 4.4%	13 400 4.2%
Shkollë + të punësuar	12 500 1.9%	10 500 3.1%	2000 0.6%
Shkollë + shërbime të papaguara në familje	232 300 35.4%	94 100 28.1%	138 300 43.0%
Të punësuar + shërbime të papaguara në familje	9400 1.4%	3900 1.2%	5500 1.7%
Vetëm shkollë	329 600 50.2%	188 700 56.4%	140 900 43.8%
Vetëm të punësuar	3900 0.6%	3200 1.0%	700 0.2%
Vetëm shërbime të papaguara në familje	15 400 2.3%	3200 1.0%	12 200 3.8%
Joaktivë	24 800 3.8%	16 400 4.9%	8400 2.6%
Numri i përgjithshëm i fëmijëve të moshave 6-17 vjeç	656 100	334 800	321 300

Pothuajse gjysma e fëmijëve të moshave 6-17 vjeç ndjekin shkollën dhe nuk janë të punësuar në aktivitete ekonomike ose të angazhuar në SHPF (tabela E.3). Ky model i përdorimit të kohës është 13 për qind më i lartë te djemtë krahasuar me vajzat. Modeli i dytë i përdorimit të kohës i hasur më shpesh te fëmijët është një kombinim i shkollës dhe i SHPF-së. Përqindja e fëmijëve që kombinojnë të tre aktivitetet - shkollë, punësim dhe shërbimet e papaguara në familje - është e vogël, por jo e pakonsiderueshme (4.3%); një përqindje edhe më e vogël, kryesisht djem, kombinojnë shkollën dhe punën (1.9%); dhe vetëm 1.0 për qind e djemve dhe 0.2 për qind e vajzave janë të angazhuar në punë ekonomike pa ndjekur shkollën dhe pa kryer shërbime familjare të papaguara.

Tabela E.4. Shpërndarja e fëmijëve në punësim sipas llojit të aktivitetit ekonomik

Aktiviteti ekonomik (NACE rev.1.1)	Të gjithë	Djem	Vajza
Bujqësi, gjueti, pylltari dhe peshkim	43 200 80.0%	25 200 77.8%	18 000 83.3%
Manifakturë	1000 1.8%	600 2.0%	400 1.6%
Elektricitet, gaz, ujë	200 0.3%	200 0.5%	0 0.0%
Ndërtim	1100 2.0%	1000 3.1%	100 0.5%

FËMIJËT QË PUNOJNË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Rezultatet e studimit kombëtar mbi punën e fëmijëve për vitin 2010

Aktiviteti ekonomik (NACE rev.1.1)	Të gjithë	Djem	Vajza
Tregti me shumicë dhe pakicë	4400 8.2%	2600 8.1%	1800 8.4%
Hotele dhe restorante	2200 4.1%	1700 5.1%	600 2.6%
Transport, magazinim dhe komunikim	500 1.0%	200 0.7%	300 1.4%
Aktivitete të tjera	200 0.6%	0 0.0%	200 1.1%
Të paklasifikuara (transport uji, ndihmë në shtëpi)	1200 2.1%	900 2.8%	300 1.2%
Numri i përgjithshëm i fëmijëve të punësuar	54 000	32 400	21 600

Në tërësi, 80 për qind e fëmijëve që punojnë janë të angazhuar në aktivitete bujqësore. Tregtia me shumicë dhe pakicë si edhe hotelet e restorantet kanë punësuar respektivisht 8.2 për qind dhe 4.1 për qind të fëmijëve që punojnë (tabela E.4); kështu, këto tre aktivitete kanë punësuar mbi 90 për qind të të gjithë fëmijëve që punojnë. Një përqindje më e madhe vajzash sesa djemsh punojnë në bujqësi, ndërsa një përqindje më e madhe djemsh sesa vajzash punojnë në hotele e restorante si edhe në ndërtim. Një numër relativisht i ulët i fëmijëve të secilit seks janë të punësuar në manifakturë.

Tabela E.5. Shpërndarja e fëmijëve në punësim sipas profesionit

Profesioni (ISCO-08)	Të gjithë	Djem	Vajza
Teknikët dhe profesionistët ndihmës	300 0.6%	0 0.0%	300 1.4%
Punëtorët e shërbimeve dhe shitjeve	5700 10.5%	3400 10.3%	2300 10.7%
<i>Punëtorë të shërbimeve personale (518)</i>	2200 4.1%	1600 4.9%	600 2.9%
<i>Shitësit e rrugëve dhe tregjeve (521)</i>	1800 3.3%	900 2.7%	900 4.3%
<i>Të tjerë</i>	1700 3.1%	900 2.7%	800 3.5%
Punëtorë bujqësie të kualifikuar	600 1.2%	400 1.3%	200 1.0%
Punëtorë artizanë	1500 2.9%	1200 3.8%	300 1.5%
Operatorë uzinash dhe makinerish, montatorë	100 0.2%	100 0.4%	0 0.0%
Profesionet elementare	45 500 84.3%	27 000 83.4%	18 500 85.5%
<i>Punëtorët e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit (921)</i>	42 500 78.8%	24 800 76.7%	17 700 82.0%
<i>Punëtorët e minierave dhe ndërtimit (931)</i>	800 1.5%	800 2.5%	0 0.0%
<i>Të tjera</i>	2200 2.9%	1400 4.2%	800 3.5%
Numri i përgjithshëm i fëmijëve të punësuar	54 000	32 400	21 600

Shënim. Informacioni mbi profesionet është i padisponueshëm për 0.4% të të gjithë fëmijëve që punojnë dhe 0.7% të djemve që punojnë.

FËMIJËT QË PUNOJNË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Rezultatet e studimit kombëtar mbi punën e fëmijëve për vitin 2010

Për sa i përket rëndësisë së aktivitetit bujqësor në jetën e fëmijëve që punojnë, 78 për qind e djemve që punojnë dhe 86.5 për qind e vajzave që punojnë janë punëtorë bujqësie (tabela E.5). Punëtorët e shërbimeve dhe shitjeve përbëjnë një grup tjetër të konsiderueshëm (10.5%), ndërsa punëtorët artizanë përbëjnë vetëm 3.8 për qind të djemve që punojnë dhe 1.5 për qind të vajzave që punojnë. Përveç kësaj, 2.5 për qind e djemve që punojnë janë të punësuar si punëtorë minierash dhe ndërtimi - profesione të cilat janë vlerësuar si të rrezikshme për fëmijët.

Punësimi i fëmijëve shpesh merr formën e punës së papaguar në familje. Në Shqipëri, mbi 93 për qind e vajzave që punojnë dhe 87 për qind e djemve që punojnë janë të punësuar bashkë me anëtarët e tjerë të familjes. Përveç kësaj, 5.6 për qind e fëmijëve që punojnë janë të punësuar si punëtorë me pagë dhe 4.5 për qind e këtyre fëmijëve punojnë për llogari të tyre.

Tabela E.6. Shpërndarja e djemve dhe e vajzave të punësuar sipas statusit në punësim

Statusi në punësim	Të gjithë	Djem	Vajza
Punëtor me pagë (punëmarrës)	3100 5.8%	2400 7.4%	700 3.2%
Punëtor për llogari të vet	2500 4.6%	1700 5.4%	700 3.3%
Punëtor në familje i papaguar	48 400 89.7%	28 200 87.2%	20 200 93.4%
Numri total i fëmijëve të punësuar	54 000	32 400	21 600

Tabela E.7. Shpërndarja e punëtorëve fëmijë sipas llojeve të rreziqeve që hasin

Punëtorë fëmijë	Të gjithë		Djem		Vajza	
Numri total i punëtorëve fëmijë (a+b+c)	35 500		22 200		13 300	
Punëtorët fëmijë si përqindje e të gjithë fëmijëve	5.1%		6.2%		3.9%	
a) Fëmijë në punë të rrezikshme	20 200 56.6%	100%	12 500 56.2%	100%	7700 57.4%	100%
Në aktivitet të rrezikshëm ekonomik	1100 3.1%	5.5%	1000 4.5%	8.0%	100 0.8%	1.4%
Në profesione të rrezikshme	500 1.3%	2.3%	500 2.1%	3.7%	0 0.0%	0.0%
Të punësuar në kushte të rrezikshme	18 600 52.2%	92.2%	11 000 49.6%	88.3%	7600 56.6%	98.6%
b) Fëmijë që punojnë të moshës 5-13 vjeç	10 100 28.5%	100%	6600 29.8%	100%	3500 26.4%	100%
c) Moshat 14-15 vjeç që punojnë më shumë se 14 orë/javë dhe moshat 16-17 vjeç që punojnë më shumë se 48 orë/javë	5300 14.8%	100%	3100 14.0%	100%	2200 16.2%	100%

Është vlerësuar se 35 500 fëmijë ose 5.1 për qind e të gjithë 5-17-vjeçarëve dhe 65.8 për qind e 5-17-vjeçarëve janë punëtorë fëmijë, domethënë fëmijë të cilët punojnë në aktivitete ekonomike ose profesione të rrezikshme, për një numër orësh që konsiderohen të jenë tepër të gjata për moshën e tyre ose në kushte pune të rrezikshme (tabela E.7). Në Shqipëri, ajo çfarë i dallon fëmijët që punojnë nga punëtorët fëmijë nuk janë industritë ose profesionet ku ata janë të punësuar, por kushtet në të cilat ata punojnë, duke përfshirë edhe orët e punës që ata duhet të punojnë në javë. Ndërsa shumë pak fëmijë janë të angazhuar në aktivitete ose profesione që kërkojnë heqjen e tyre të menjëhershme, 52.2 për qind e punëtorëve fëmijë janë të punësuar në kushte të rrezikshme dhe 14.8 për qind punojnë me orë të tejzgjatura. Për më tepër, 5-13-vjeçarët, të cilët e kanë të ndaluar nga legjislacioni kombëtar që të punojnë, madje edhe për një orë në javë, përbëjnë 28.5 për qind të punëtorëve fëmijë në Shqipëri.

Djemtë përbëjnë një përqindje më të madhe të punëtorëve fëmijë (63.4%) krahasuar me vajzat. Kjo nuk është një gjetje e çuditshme, duke pasur parasysh faktin se djemtë kanë më shumë mundësi për t'u punësuar sesa vajzat. Pavarësisht mbizotërimit më të lartë të punës së fëmijëve të djemtë, si djemtë edhe vajzat priren të përballen me rreziqe të njëjta (tabela E.6). Më shumë se gjysma e të gjithë djemve (56.2%) dhe vajzave (57.4%) janë klasifikuar si punëtorë fëmijë, sepse janë të angazhuar në punë të rrezikshme; në shtesë 29.8 për qind e djemve dhe 26.4 për qind e vajzave janë klasifikuar si punëtorë fëmijë, sepse ata janë shumë të vegjël për të punuar; gjithashtu 14 për qind e djemve dhe 16.2 për qind e vajzave janë klasifikuar si punëtorë fëmijë, për shkak se ata janë të punësuar në punë të parrezikshme, por përtej numrit të orëve të punës të lejueshme për moshën e tyre. Pavarësisht nga këto modele të gjera, ndryshimet në punën e fëmijëve mund të vëzhgohen në linjat e gjinisë, me një përqindje më të madhe djemsh sesa vajzash të angazhuar në aktivitete ekonomike dhe profesione të rrezikshme, dhe një përqindje më të madhe vajzash sesa djemsh që punojnë në kushte pune të rrezikshme.

Është vlerësuar se 13 për qind e fëmijëve që punojnë dhe 18.4 për qind e punëtorëve fëmijë kanë kaluar një sëmundje ose dëmtim të shkaktuar nga puna një vit para këtij studimi; megjithatë, vetëm në pak raste (më pak se 5% e fëmijëve që kaluan një sëmundje/dëmtim) fëmijët u detyruan të lënë punën ose shkollën përgjithmonë si rezultat i sëmundjes ose i dëmtimit. Lodhja ekstreme dhe temperatura janë problemet shëndetësore më të zakonshme të kaluara nga fëmijët që punojnë dhe nga punëtorët fëmijë. Një përqindje më e madhe djemsh sesa vajzash vuajnë nga probleme shëndetësore të shkaktuara nga puna.

Është vlerësuar se rreth 33.7 për qind e fëmijëve që punojnë dhe 54.2 për qind e punëtorëve fëmijë punojnë në kushte të pafavorshme pune. Rreziqet më të zakonshme në vendin e punës, me të cilat përballen fëmijët, janë puna në temperaturë ekstreme, të nxehtë apo të ftohtë, dhe puna në mjedise me pluhur/me tym. Për më tepër, 8.2 për qind e fëmijëve që punojnë dhe 12.2 për qind e punëtorëve fëmijë ankohen për trajtim të pafavorshëm në punë, kryesisht në formën e të bërtitjes dhe rrahjes; ata fëmijë që ankohen për abuzim fizik janë veçanërisht ata që quhen punëtorë të papaguar në familje.

Tabela E.8. Ndjekja e shkollës nga fëmijët që punojnë dhe fëmijët që nuk punojnë sipas moshës

Ndjekja e shkollës	Mosha 5-17	Mosha 5-11	Mosha 12-14	Mosha 15-17
Fëmijët që punojnë	45 000 77.5%	8500 98.8%	16 800 95.4%	19 700 61.9%
Punëtorët fëmijë	29 200 79.9%	8500 98.8%	13 000 95.2%	7700 54.0%
Fëmijët që nuk punojnë	594 300 93.8%	319 900 92.5%	141 900 97.2%	132 500 89.1%

Krahasimi i rezultateve të shkollës për fëmijët që punojnë dhe fëmijët që nuk punojnë (si edhe punëtorët fëmijë) nxjerr në pah faktin se në moshën 17-vjeçare fëmijët që punojnë, në përgjithësi, kanë kryer 4 vjet më pak shkollë sesa fëmijët që nuk punojnë. Një fëmijë tipik që punon përfundon arsimin e detyruar, por nuk vazhdon shkollën e mesme. Në përgjithësi, puna dhe shkollimi përtej arsimit të detyruar janë aktivitete që nuk përputhen, ku vetëm 61.9 për qind e fëmijëve që punojnë dhe 54 për qind e punëtorëve fëmijë ndjekin shkollën përtej arsimit të detyruar, krahasuar me 89.1 për qind të fëmijëve që nuk punojnë (tabela E.8). Nuk është gjetur ndonjë ndryshim i dukshëm në moshën e fillimit të shkollës midis fëmijëve që punojnë dhe atyre që nuk punojnë. Duke gjykuar sipas klasës për moshë, fëmijët që punojnë, veçanërisht punëtorët fëmijë, ka më shumë gjasa të përsërisin një klasë sesa fëmijët që nuk punojnë. Fëmijët që punojnë, gjithashtu, mungojnë në shkollë më shpesh, megjithëse priren të mungojnë më pak ditë në çfarëdo jave sesa fëmijët që nuk punojnë. Frekuentimi në trajnimin (formimin) profesional është shumë i ulët, me vetëm 4.4 për qind të të gjithë 10-17-vjeçarëve të cilët kanë ndjekur ndonjëherë

një program trajnimi jashtë shkollës dhe me një shkallë edhe më të ulët frekuentimi të programeve të tilla (2.1%) nga fëmijët që nuk shkojnë më në shkollë.

Gjetja që shumica e punëtorëve fëmijë janë punëtorë të papaguar në familje, të punësuar në njësitë bujqësore pronë e familjes, ofron një sfidë dhe një mundësi në luftën kundër punës së fëmijëve. Përmirësimi i kushteve të punës së fëmijëve përbën një sfidë, meqenëse ndërmarrjet bujqësore pronë e familjes shumë shpesh nuk i nënshtrohen inspektimit të punës. Me qëllim që të gjenden mënyra për të ndihmuar familjet në përmirësimin e kushteve të punës për veten dhe fëmijët e tyre, inspektorët e punës, së pari, duhet të identifikojnë rreziqet e vendit të punës, në mënyrë që të nxjerrin rekomandime për reduktimin e tyre. Kur flitet për mirëqenien e fëmijëve të tyre, këto familje ferma ka shumë mundësi të jenë më të hapura ndaj sugjerimeve të inspektorëve të punës dhe ekspertëve që merren me zhvillimin e fëmijëve. Shkalla e lartë e arsimimit të të rriturve si dhe shkalla e lartë e ndjekjes së shkollës së mesme nga fëmijët ofrojnë mundësi të pafundme të prindërit dhe fëmijët për rritjen e ndërgjegjësimit ndaj rreziqeve në vendin e punës, nëpërmjet materialeve të printuara dhe programeve shkollore.

Forcimi i programeve të formimit profesional, me qëllim përmirësimin e aftësive të rinisë që nuk ndjek shkollën, mund të jetë një mënyrë tjetër frytdhënëse jo vetëm për të lehtësuar kalimin e tyre drejt tregut të punës pas shkëputjes nga shkolla, por gjithashtu për të rritur mundësitë e tyre për gjetjen dhe për mbajtjen e vendeve më të mira të punës. Të kuptuarit e arsyeve të rënies së ndjeshme në shkallën e frekuentimit të shkollës menjëherë pas përfundimit të arsimit të detyruar është, gjithashtu, i rëndësishëm për sa i përket ofrimit të drejtimit në politikat arsimore drejt ruajtjes së regjistrimeve.

HYRJE

Studimi kombëtar mbi punën e fëmijëve (SPF) për vitin 2010 u krye nga Instituti i Statistikave (INSTAT) i Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me ILO/IPEC. Vetëm studimi mbuloi 7319 familje që përmbanin 27 865 individë, 6003 prej të cilëve ishin fëmijë të moshave 5-17 vjeç. SPF-ja u hartua me qëllim që të siguronte tregues mbi tre aspektet kryesore të jetës së fëmijëve: punësimi, shkollimi dhe shërbimet e papaguara në familje. Ky raport dokumenton gjetjet e studimit, në veçanti, përhapjen dhe karakteristikat e punësimit dhe punës së fëmijëve, shkallën e frekuentimit të shkollës, përqindjen e fëmijëve të angazhuar në shërbime të papaguara në familje dhe pasojat e mundshme të punësimit të matura nga rezultatet e shëndetit dhe shkollimit.

Me një popullsi prej 3.2 milionë banorësh Shqipëria është një nga vendet më të vogla në Europë. Ajo gjendet në Ballkan midis Malit të Zi, Kosovës, Republikës së Maqedonisë dhe Greqisë dhe ka një vijë bregdetare në detin Adriatik dhe Jon. Pjesa më e madhe e terrenit është malor, me vetëm 22 për qind të sipërfaqes së përgjithshme -prej rreth 29 000 km²- të konsideruar të përshtatshme për bujqësi [Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë, OUB (FAO), 2010]. Pothuajse çereku i popullsisë shqiptare jeton në kryeqytet, në Tiranë.

Shqipëria është një nga vendet më të varfra në Europë. Të ardhurat bruto kombëtare për frymë në vitin 2010 ishin 3,960 dollarë ose rreth 10 për qind e të ardhurave bruto për frymë në vendet e eurozonës (Banka Botërore, 2010a). E përshtatur me koston e jetesës, të ardhurat bruto kombëtare për frymë në Shqipëri, në vitin 2010, ishin \$7,950. Në vitin 2002, mbi një çerek i popullsisë ranë nën kufirin kombëtar të varfërisë. Kjo shifër ra në 18.5 për qind në 2005 dhe në 12.4 për qind në 2008 (Banka Botërore, 2010b; Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, UNDP, 2010a), ndërsa përqindja e popullsisë shqiptare që jetonin nën kufirin ndërkombëtar të varfërisë (2 dollarë në ditë) ishte 8.7 për qind në vitin 2005.

Pavarësisht treguesve të varfër ekonomikë, krahasuar me ekonomitë e tjera europiane, Shqipëria paraqitet mirë për sa i përket treguesve shoqërorë. Jetëgjatësia është 76.9 vjeç, vdekshmëria foshnjore është 15 për 1 000 fëmijë dhe shkalla e arsimimit është 96.7 për qind (Banka Botërore, 2010a, b). Sipas indeksit të zhvillimit njerëzor (IZHNJ) të Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP), Shqipëria renditet në vendin e 64-t nga 169 vende, me vlerë të IZHNJ prej 0.719 (UNDP, 2010b); megjithatë, vlera e indeksit të zhvillimit njerëzor që nuk ka të bëjë me të ardhurat është më e lartë, 0.787. Si rezultat, renditja e saj bazuar në IZHNJ është 19 pikë më e lartë sesa renditja e saj bazuar në të ardhurat kombëtare bruto për frymë. Për më tepër, ndërsa Shqipëria klasifikohet ndër vendet me zhvillim të lartë njerëzor, pozicioni i saj do të kishte qenë më i lartë në renditje po të mos kishte qenë për të ardhurat e saj krahasimisht më të ulëta.

Shqipëria ka një bazë të ngushtë ekonomike që dominohet në pjesën më të madhe nga bujqësia. Për sa i përket vlerës së shtuar sipas sektorit, bujqësia përbën 20.5 për qind të GDP-së, krahasuar me 19.6 për qind për industrinë dhe 60 për qind për shërbimet (Banka Botërore, 2010a). Për sa i përket punësimit, bujqësia llogarit 44.1 për qind të punësimit, krahasuar me 19.9 për qind për industrinë (duke përfshirë ndërtimin) dhe 36 për qind për shërbimet. Baza e burimeve natyrore të Shqipërisë është gjithashtu shumë e ngushtë, me gaz dhe naftë natyror, por të pamjaftueshme për të qenë lokomotiva e ekonomisë. Pas ndryshimit të regjimit në vitin 1990, shumë shqiptarë lanë vendin për të punuar në vende të tjera dhe, pavarësisht përmirësimeve të ndjeshme të ekonomisë, që atëherë, paratë e dërguara nga ata akoma përbëjnë një burim të rëndësishëm të ardhurash për Shqipërinë. Në vitin 2010 paratë e dërguara arrinin

shumën 1.2 bilionë dollarë, shumë kjo në rënie krahasuar me 1.5 bilionë dollarë në vitin 2008 (Banka Botërore, 2010a). Këto shifra janë më të larta sesa shuma e investimeve të huaja direkte në vend gjatë këtyre dy viteve, të cilat arritën shumën 1.1 bilionë dollarë në vitin 2010 dhe pak më pak se 1 bilion dollarë në vitin 2008. Paratë e dërguara përbënin më shumë se 10 për qind të GDP-së gjatë të dy viteve.

Në këtë sfond, ky raport analizon situatën e fëmijëve në Shqipëri. Seksioni 1 shpjegon metodologjinë e studimit dhe të dhënat e përdorura në këtë analizë. Seksioni 2 analizon modelet e përdorimit të kohës nga fëmijët; ai fillon me një informacion të shkurtër mbi numrin e popullsisë së fëmijëve në Shqipëri dhe ndiqet nga një informacion më i hollësishëm mbi përhapjen e punësimit të fëmijët, treguesit kyç të shkollës dhe shërbimet e paguara në familje të kryera nga fëmijët. Seksioni 3 analizon më thellë aktivitetet ekonomike të fëmijëve, duke ofruar më tej statistika përshkruese mbi natyrën e punës së kryer nga fëmijët dhe kushtet në të cilat ata punojnë. Seksioni 4 analizon pasojat e mundshme të punësimit të fëmijëve, e matur nga frekuentimi i fëmijëve në shkollë dhe problemet shëndetësore. Seksioni 5 e përmbyll këtë raport.

SEKSIONI

1

METODOLOGJIA E STUDIMIT DHE GRUPI I TË DHËNAVE

1.1. Kampioni

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2010, me mbështetjen financiare dhe teknike të ILO/IPEC, Instituti i Statistikave (INSTAT) i Republikës së Shqipërisë bëri Studimin e parë kombëtar mbi punën e fëmijëve (SPF) në Shqipëri. Studimi synoi të kuptonte përhapjen dhe karakteristikat e punësimit dhe punës së fëmijëve si edhe pasojat e mundshme të punësimit të fëmijët, të matura nga rezultatet e tyre në shkollë dhe shëndet.

Studimi mbuloi 7319 familje që përmbanin 27 865 individë, 6003 prej të cilëve ishin fëmijë të moshave 5-17 vjeç. Nga 7319 familjet e përzgjedhura, 16 193 shtëpi (58.1%) përmbanin të paktën një fëmijë të moshës 5-17 vjeç. Shumica dërrmuese e intervistave (98.4%) u kryen ballë për ballë, në muajin maj. Masa e kampionit u përzgjedh e tillë që të lejonte nxjerrjen e vlerave përfaqësuese për treguesit kyç të punës së fëmijëve për vendin në përgjithësi, si dhe për 12 rajonet e vendit. Tabela 1.1 tregon shpërndarjen e njësive kampion fillestare (NJKF) dhe të individëve të studiuar sipas rajoneve.

Tabela 1.1. Shpërndarja e njësive kampion fillestare (NJKF)

Rajonet	Nr i NJKF-ve	Nr i familjeve kampion	Nr i familjeve që u përgjigjën	Nr i individëve	Nr i fëmijëve nga moshë 5-17 vjeç
Berat	36	504	467	1640	324
Dibër	30	420	333	1260	364
Durrës	62	868	774	2888	598
Elbasan	68	948	784	3145	707
Fier	70	980	853	3265	711
Gjirokastrë	22	308	234	813	157
Korçë	52	728	634	2160	384
Kukës	20	280	219	1103	312
Lezhë	32	448	377	1512	371
Shkodër	48	661	561	2215	505
Tiranë	146	2044	1743	6535	1321
Vlorë	34	476	412	1329	249
Gjithsej	620	8483	7391	27865	6003

1.2. Pyetësorët

Pyetësori i SPF-së u hartua bazuar mbi modelin e pyetësorit mbi Studimin e punës së fëmijëve të ILO/SIMPOC dhe përbëhej nga tre pjesë kryesore: 1) Pyetësor për të rritur; 2) Pyetësor për karakteristikat e familjes; 3) Pyetësor për fëmijët.

Pyetësori për të rriturit iu drejtua anëtarit më të ditur të familjes dhe u mbledh informacion mbi përbërjen e familjes, shkollën dhe statusin e punësimit të anëtarëve të familjes, shërbimet e papaguara në familje të kryera nga fëmijët dhe perceptimet e prindërve/kujdestarëve në lidhje me punësimin e fëmijëve. Pyetësori i të rriturve përbëhej nga seksionet e mëposhtme:

1. Përbërja e familjes dhe karakteristikat e anëtarëve të familjes
2. Arritjet arsimore (mosha 5 vjeç e sipër)
3. Statusi aktual i aktivitetit ekonomik (mosha 5 vjeç e sipër)
4. Statusi i zakonshëm i punësimit (mosha 5 vjeç e sipër)
5. Detyrat në familje (moshat 5-17 vjeç)
6. Perceptimet/vëzhgimet e prindërve/kujdestarëve në lidhje me fëmijët që punojnë.

Pyetësori mbi karakteristikat e familjes iu drejtua gjithashtu anëtarit më të ditur të familjes dhe mbledhi informacion mbi karakteristikat e familjes, pronësinë e mallrave të qëndrueshëm dhe statusin social-ekonomik. Ai përbëhej nga seksionet e mëposhtme:

1. Karakteristikat e shtëpisë dhe familjes
2. Statusi social-ekonomik i familjes

Pyetësori për fëmijët iu drejtua fëmijëve të moshave 5-17 vjeç dhe synoi mbledhjen e informacionit mbi shkollën e fëmijëve, punësimin dhe pasojat shëndetësore nga këndvështrimi i vetë fëmijëve. Pyetësori përbëhej nga seksionet e mëposhtme:

1. Arritjet mësimore
2. Statusi aktual i aktivitetit ekonomik
3. Çështjet e shëndetit dhe të sigurisë në punë për fëmijët
4. Shërbimet e papaguara në familje (punët e shtëpisë)

Pyetësori për fëmijët përmbante gjithsej 43 pyetje; megjithatë, me qëllim reduktimin e gjatësisë së pyetësorit dhe shmangien e pyetjeve që fëmijët e vegjël mund të kenë vështirësi për t'i kuptuar, fëmijëve të moshës 5-9 vjeç iu drejtuan vetëm 37 nga këto pyetje.¹

Përveç seksionit që ka të bëjë me shëndetin dhe sigurinë në punë, pyetjet në Pyetësorin e fëmijëve janë të njëjta me ato të Pyetësorit të të rriturve. Kjo strukturë mbivendosëse është e dizenuar për të matur dhe kontrolluar ndryshimet, e qëllimshme apo jo, midis përgjigjeve të të rriturve dhe fëmijëve. Në mënyrë që fëmijët të lejohen për t'iu përgjigjur lirshëm pyetjeve që u drejtohen, intervistuesit kërkuar që fëmijët të intervistoheshin vetëm; megjithatë, për shkak të arsyeve të tilla si hapësira e pamjaftueshme dhe ngurrimi nga ana e prindërve/kujdestarëve, kjo nuk ishte gjithmonë e mundur. Nga 6003 fëmijët e studiuar, vetëm 1389 fëmijë (23.1%) u intervistuan vetëm, ndërsa pjesa tjetër u intervistua në prani të një të rrituri ose të një fëmije tjetër.

Analiza e punës, e rezultateve të shkollës dhe e përfshirjes në shërbime të papaguara familjare të fëmijëve, prezantuar në këtë raport, së pari, mbështetet në përgjigjet e të rriturve. Megjithatë, pati disa mospërputhje midis përgjigjeve të dhëna nga të rriturit dhe nga fëmijët. Kjo është e habitshme, duke pasur parasysh faktin që një numër i madh fëmijësh nuk mund të intervistoheshin vetëm.

¹ Pyetjet e hequra kishin të bënin me punën shtesë, orët e punës në punën kryesore dhe atë shtesë, orët e punës gjatë ditës, vendin e punës, statusin e punësimit dhe mënyrën e shpërbërimit.

1.3. Përkufizimet e fëmijëve të punësuar dhe punëtorëve fëmijë

Përkufizimet e koncepteve kyçe, siç janë përdorur në pjesën e mbetur të raportit, janë dhënë më poshtë. (Për përkufizime të tjera të përdorura në studim, shiko shtojcën A.)

Fëmijët në punësim (fëmijët që punojnë): Fëmijët (mosha 5-17 vjeç) përkufizohen si fëmijë që punojnë (ose të punësuar), nëse ata punonin për të paktën një orë gjatë periudhës të cilës i referohemi ose nëse ata kishin një punë ose biznes nga i cili mungonin përkohësisht. Sistemi i Llogarive Kombëtare (SLLK) përshkruan çfarë është dhe çfarë nuk është aktivitet ekonomik. Po të flasim në përgjithësi, të gjitha aktivitetet e orientuara drejt tregut, prodhimi për konsumim personal dhe shërbime të tilla të kryera për familjen ose nga anëtarët e familjes (si p.sh., riparime të rëndësishme në shtëpi, mbushja e ujit ose mbledhja e druve për zjarrin) konsiderohen aktivitete ekonomike dhe personat e angazhuar në to konsiderohen të punësuar.

Punëtorë fëmijë: Punëtorë fëmijë në Shqipëri përkufizohen ata fëmijë që janë të angazhuar në një punë të papërshtatshme për kapacitet e tyre si fëmijë ose në punë që mund të rrezikojnë shëndetin, arsimin apo zhvillimin moral të tyre. Përkufizimi kombëtar bazohet në Konventën e ONP-së, Nr. 182, mbi *Format më të këqija të punës së fëmijëve*, të cilën e ka firmosur edhe Shqipëria. Mosha minimale për punësim në Shqipëri është 16 vjeç; megjithatë, fëmijët e moshës 14-15 vjeç mund të punojnë gjatë pushimeve të shkollës përderisa ky punësim nuk e influencon negativisht zhvillimin e tyre (Kodi shqiptar i punës, neni 98). Pavarësisht moshës së tyre, fëmijët nuk lejohen të kryejnë punë të rrezikshme, që përfshijnë format më të këqija të pakushtëzuara të punës së fëmijëve (p.sh. prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve, skllavërinë dhe punën në kushte skllavërie, dërgimin ushtar të fëmijëve dhe përfshirjen në aktivitete të jashtëligjshme) si edhe çfarëdolloj pune tjetër që mund të jetë e dëmshme për zhvillimin fizik, shoqëror apo psikologjik të fëmijës (Kodi shqiptar i punës, neni 100), siç është përcaktuar me hollësi nga qeveria shqiptare (shiko shtojcën B). Kështu, puna e fëmijëve përfshin:

- i) Fëmijët e punësuar në industritë e rrezikshme, duke përfshirë minierat, guroret dhe ndërtimin.
- ii) Fëmijët e punësuar në profesione të rrezikshme, duke përfshirë, por jo vetëm, punën në miniera dhe nëntoke; punën në aviacionin civil; punën në fermentim në industrinë e prodhimit të duhanit dhe cigareve; punën në fabrikat e pasurimit të bakrit, kromit dhe qymyrit; punën me rrezatimin jonizues në fushën e kujdesit shëndetësor. (Për një listë të plotë të profesioneve shiko shtojcën B.)
- iii) Fëmijët të cilët punojnë në kushte të rrezikshme, që përfshijnë mbajtjen e ngarkesave të rënda, përdorimin e makinerive/pajisjeve të rënda, ekspozimin ndaj kushteve të këqija, si: pluhuri/tymrat, zjarri/gazi/flakët, zhurma e lartë etj., si edhe fëmijët që abuzohen verbalisht ose fizikisht në punë.
- iv) Fëmijët e moshës 5-13-vjeçare të cilët janë të punësuar (madje edhe vetëm për një orë në javë).
- v) Fëmijët e moshës 14-15-vjeçare të cilët punojnë më shumë se 14 orë në javë.²
- vi) Fëmijët e moshës 16-17-vjeçare të cilët punojnë më shumë se 48 orë në javë.³

Një paraqitje skematike e punës së fëmijëve është dhënë në tabelën 1.2.

² Kodi shqiptar i punës nuk specifikon një pikë ndarëse për punën e lehtë. Kështu, kjo analizë përdori pragun prej 14 orësh të përdorur në përkufizimin e sugjeruar nga ONP mbi punën e lehtë të aplikueshme për 12-14-vjeçarët.

³ Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 409, datë 22.04.2009.

Tabela 1.2. Korniza për identifikimin statistikor të punës së fëmijëve

Grup-mosha	Punë e lehtë	Punë e rregullt	Format më të këqija të punës së fëmijëve	
			Punë e rrezikshme	Format më të këqija të punës së fëmijëve përveçse të rrezikshme
5-13 vjeç	Nën moshën minimale për punën e lehtë	Nën moshën minimale për punë	Punësim në industritë dhe profesionet e përcaktuara si të rrezikshme ose punë për më tepër se 48 orë/javë, ose në kushte të rrezikshme në industritë dhe profesionet e përcaktuara si jo të rrezikshme	Fëmijët e trafikuar për punë; puna e fëmijëve e detyruar; shfrytëzimi seksual komercial i fëmijëve; përdorimi i fëmijëve për aktivitete të paligjshme dhe konflikte të armatosura.
14-15 vjeç	14 orë ose më pak në javë	Më shumë se 14 orë në javë		
16-17 vjeç	48 orë ose më pak në javë	Më shumë se 48 orë në javë		

 Tregon punën e fëmijëve  Tregon aktivitetet që nuk konsiderohen punë e fëmijëve

Fëmijët ekonomikisht aktivë: Termi “fëmijë ekonomikisht aktivë” përfshin fëmijët në punësim si edhe fëmijët e papunë. (Statusi i papunësisë i përket vetëm fëmijëve të moshave 15-17 vjeç.)

1.4. Karakteristikat e kampionit

1.4.1. Shpërndarja e grup-moshave

Analiza e paraqitur në këtë raport është ndarë sipas seksit dhe grup-moshës. Siç tregohet në tabelën 1.3, 42.8 për qind e fëmijëve të studiuar ishin 5-11-vjeçarë, 29.1 për qind ishin 12-14-vjeçarë dhe 28.1 për qind ishin 15-17-vjeçarë.

Tabela 1.3. Numri (dhe përqindja) e fëmijëve sipas grup-moshës dhe seksit (rezultate të papeshuara)

	Mosha 5-17	Mosha 5-11	Mosha 12-14	Mosha 15-17
Meshkuj	3088 (100%)	1390 (45.0%)	853 (27.6%)	845 (27.4%)
Femra	2915 (100%)	1179 (40.5%)	894 (30.7%)	842 (28.9%)
Gjithsej	6003 (100%)	2569 (42.8%)	1747 (29.1%)	1687 (28.1%)

Mes fëmijëve të vegjël (mosha 5-11 vjeç), u studiua një numër pak më i madh djemsh sesa vajzash, ndërsa në grup-moshat më të mëdha (12-14 vjeç dhe 15-17 vjeç) djemtë i kaluan me shumë pak vajzat (tabela 1.3). Në tërësi, përfaqësimi gjinor anoi pak më shumë drejt djemve.

1.4.2. Shpërndarja e aktiviteteve të fëmijëve sipas grup-moshës

Në tabelën 1.4 raportohen përqindjet e fëmijëve në punësim, të cilët ndjekin shkollën dhe kryejnë shërbime të papaguara në familje. Siç u diskutua edhe më parë, ky informacion u nxor nga së bashku fëmijët dhe prindërit/kujdestarët e tyre.

Përgjigjet e dhëna nga fëmijët ndryshonin paksa nga ato të prindërve/kujdestarëve të tyre. Për sa u përket pyetjeve mbi punësimin, pati një përqindje paksa më të lartë (11%) të 5-17-vjeçarëve që raportuan se punonin, krahasuar me përqindjen e raportuar nga prindërit/kujdestarët (10%). Mospërputhja në raportim është më e vogël për fëmijët e vegjël sesa për ata më të rritur, gjë e cila nuk është e habitshme, duke pasur parasysh që u intervistua një përqindje më e lartë fëmijësh të vegjël sesa më të rritur në shoqërinë e një të rrituri dhe/ose të një fëmije tjetër. Megjithatë, edhe te fëmijët që nuk u intervistuan vetëm, përgjigjet e fëmijëve dhe prindërve/kujdestarëve jo domosdoshmërisht përputhen. Kjo mund të jetë si rezultat i faktit që disa fëmijë, të cilët nuk u intervistuan vetëm, ishin të shoqëruar nga fëmijë të tjerë, dhe jo nga prindërit/kujdestarët e tyre. Është gjithashtu e mundur që intervistuesit të kenë regjistruar përgjigjet origjinale të dhëna nga fëmijët dhe prindërit, duke injoruar ndonjë diskutim të mëvonshëm midis tyre. Megjithëse nuk ka asnjë të dhënë për të mbështetur cilindo nga këto shpjegime, shpjegimi i parë duket më i mundshmi.

Tabela 1.4. Shpërndarja e aktiviteteve të fëmijëve sipas grup-moshës dhe personave që u përgjigjen (%) (rezultate të papeshuara)

	Mosha 5-17	Mosha 5-11	Mosha 12-14	Mosha 15-17
Numri i përgjithshëm i fëmijëve				
Punësimi (puna)				
Punojnë – raportuar nga prindërit	10.0	2.6	11.8	19.6
Punojnë – raportuar nga fëmijët	11.0	2.8	13.3	21.0
Shkollimi				
Në shkollë – raportuar nga prindërit	91.1	92.7	96.4	83.1
Në shkollë – raportuar nga fëmijët	92.2	94.1	97.6	83.8
Shërbime të papaguara në familje (punët e shtëpisë)				
Kryejnë punë shtëpie – raportuar nga prindërit	43.5	18.2	55.5	69.4
Kryejnë punë shtëpie – raportuar nga fëmijët	44.6	19.5	56.8	70.1

Njësoj si me mospërputhjet e raportuara për punësimin, ndjekja e shkollës raportuar nga fëmijët ishte paksa më e lartë sesa ndjekja e shkollës raportuar nga të rriturit. Megjithatë, në kontrast me gjetjet për punësimin, mospërputhja në raportimin për ndjekjen e shkollës nga fëmijët e vegjël ishte më e madhe sesa ajo e fëmijëve më të rritur. Mospërputhje u vërejtën edhe në përgjigjet e fëmijëve dhe ato të prindërve/kujdestarëve të tyre në lidhje me shërbimet e papaguara në familje; megjithëse më shumë fëmijë sesa prindër raportuan përfshirjen e fëmijëve në shërbimet e papaguara në familje, mospërputhja në përgjigje nuk i kalon më shumë se 2 për qind për cilindo grup-moshë.

Pavarësisht këtyre mospërputhjeve, siç tregohet në tabelën 1.4, pa marrë parasysh faktin nëse janë përdorur përgjigjet e fëmijëve apo prindërve/kujdestarëve të tyre, modelet që dalin të përdorimit të kohës nga fëmijët kjo janë shumë të ngjashme. Kështu, përdorimi i përgjigjeve të të rriturve si baza e analizës ka mundësi të mos ketë ndonjë impakt të rëndësishëm mbi treguesit e vlerësuar ose konkluzionet kryesore të paraqitura në këtë raport.

1.4.3. Shpërndarja e fëmijëve sipas marrëdhënies me kreun e familjes

Shumica e fëmijëve të studiuar (82.9%) ishin fëmijë të kreut të familjes dhe shumica e pjesës tjetër të fëmijëve (15.7%) ishin nipër e mbesa të kreut të familjes (tabela 1.5). Ky model është i vërtetë për fëmijët e grup-moshave të ndryshme, megjithëse një përqindje më e lartë e 5-11-vjeçarëve janë nipër e mbesa të kreut të familjes. Kjo nuk është për t'u habitur, duke pasur parasysh faktin që fëmijët më të vegjël kanë prindër më të rinj, të cilët kanë më shumë gjasa të përballen me kufizime financiare dhe, si rrjedhim, ka më shumë mundësi që të jetojnë në një familje më të zgjeruar. Në të vërtetë, nënat e 95.2 për qind dhe baballarët e 83.3 për qind të fëmijëve 5-11-vjeçarë, të klasifikuar si nipër e mbesa të kreut të familjes, ishin gjithashtu të pranishëm në shtëpi në kohën e studimit. Në total, 81.9 për qind e 5-11-vjeçarëve që jetojnë me gjyshërit i kishin të dy prindërit të pranishëm në shtëpi. Këto shifra janë shumë të ngjashme me ato të marra për të gjithë grupin e 5-17-vjeçarëve që jetojnë me gjyshërit, respektivisht 94.3 për qind, 82.8 për qind dhe 81.0 për qind. Pra, konkluzionet e nxjerra në këtë raport mund të kuptohen si të lidhura me fëmijët që jetojnë me prindërit e tyre, pa marrë parasysh faktin nëse anëtare të tjerë të familjes më të zgjeruar janë gjithashtu të pranishëm.

Tabela 1.5. Marrëdhënia e fëmijëve të studiuar me kreun e familjes, sipas grup-moshës (%) (rezultate të përbashkëta)

	Mosha 5-17	Mosha 5-11	Mosha 12-14	Mosha 15-17
Bashkëshort	0.0	0.0	0.0	0.1
I biri/e bija	82.9	76.6	85.9	89.3
Vëlla/motër	0.2	0.0	0.2	0.4
Nuse/dhëndër	0.2	0.1	0.1	0.4
Nip/mbesë (për gjyshërit)	15.7	21.7	13.3	9.0
Nip/mbesë (për hallat, dajat etj.)	0.9	1.3	0.5	0.7
Thjeshtër	0.1	0.1	0.0	0.1
I afërm tjetër	0.2	0.2	0.1	0.2
Nr. i vëzhgimeve	6003	2569	1747	1687

SEKSIONI

2

PUNËSIMI, SHKOLLIMI DHE SHËRBIMET E PAPAGUARA NË FAMILJE TË FËMIJËVE

Ky seksion i raportit paraqet gjetjet e Studimit kombëtar mbi punën e fëmijëve për vitin 2010 në lidhje me përdorimin e kohës nga fëmijët, domethënë përfshirjen e tyre në punësim, shkollim dhe shërbimet e papaguara në familje. Analiza e hollësishme e aktiviteteve të fëmijëve është paraprirë nga një diskutim i shkurtër mbi madhësinë e popullsisë së fëmijëve në Shqipëri dhe madhësinë e saj në lidhje me popullsinë totale.

2.1. Madhësia e popullsisë së fëmijëve

Popullsia e Shqipërisë është vlerësuar të jetë 3 195 000 banorë, nga të cilët 699 000 (21.9%) janë fëmijë të moshave 5-17 vjeç. Vajzat përbëjnë një përqindje paksa më të vogël (48.8%) të 5-17-vjeçarëve sesa djemtë (51.2%). Piramida e popullsisë në figurën 2.1 ka një bazë të ngushtë, e cila është tregues për shkallën e ulët të lindjeve, ndërsa zgjerohet shumë në majë (70+), gjë që tregon për një popullsi në plakje. Është shumë interesante të shihet se numri i popullsisë bie papritmas pas mesit të të 20-tave: Ndërsa 20-24-vjeçarët përbëjnë 9.6 për qind të popullsisë, 25-29-vjeçarët përbëjnë vetëm 8 për qind, ndërsa 30-34-vjeçarët vetëm 6.6 për qind. Këto rënie të papritura mund të shpjegohen me tendencën e të rinjve për të emigruar jashtë vendit. Si rezultat i shkallës së ulët të lindjeve dhe emigracionit, popullsia në moshë për punë (18-64-vjeçarët), e vlerësuar rreth 2 milionë, përbën 62 për qind të popullsisë, ndërsa popullsia e varur (në ngarkim të dikujt tjetër) është rreth 1.2 milionë. Kështu, raporti i varësisë, domethënë raporti i popullsisë së varur nga popullsia në moshë për punë, është 62.4 për qind. Megjithatë, duke pasur parasysh që remitancat (paratë e dërguara) mund të burojnë nga anëtarët emigrantë të familjes, ky raport mund të mos jetë një reflektim ekzakt i përqindjes së popullsisë që duhet të mbështetet nga popullsia në moshë për punë në vend.




Figura 2.1. Piramida e popullsisë sipas moshës dhe seksit

2.2. Punësimi i fëmijëve

Është vlerësuar se në Shqipëri punojnë 54 000 fëmijë të moshës 5-17 vjeç. Kjo shifër përfaqëson 7.7 për qind të popullsisë së fëmijëve në këtë grup-moshë. Shpërndarja e punësimit rritet me moshë, kështu që 2.4 për qind e 5-11-vjeçarëve janë të punësuar, krahasuar me 9.4 për qind të 12-14-vjeçarëve dhe 16.8 për qind të 15-17-vjeçarëve.

Kur marrim parasysh fëmijët e moshës 15-17 vjeç, të cilët po kërkojnë punë (statusi i papunësisë është i vlefshëm vetëm për fëmijët e kësaj grup-moshe), numri i fëmijëve ekonomikisht aktivë rritet deri në 57 000. Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore⁴ te 15-17-vjeçarët është vlerësuar të jetë 18.4%.

Tabela 2.2. Shpërndarja e punësimit sipas moshës - periudhë e shkurtër reference (1 javë)

	Mosha 5-17	Mosha 5-11	Mosha 12-14	Mosha 15-17
Popullsia e fëmijëve	698 600	354 400	163 600	180 600
Punojnë (nr.)	54 000	8 400	15 300	30 300
Punojnë (%)	7.7	2.4	9.4	16.8

Shënim. Periudha e referimit është java që i paraprin studimit.

Tabela 2.3. Shpërndarja e punësimit sipas moshës dhe seksit - periudhë e shkurtër referimi (1 javë)

	Mosha 5-17		Mosha 5-11		Mosha 12-14		Mosha 15-17	
	Djem	Vajza	Djem	Vajza	Djem	Vajza	Djem	Vajza
Popullsia e fëmijëve	357 800	340 800	189 700	164 600	79 600	84 000	88 500	92 100
Punojnë (Nr.)	32 400	22 600	5 400	3 000	8 700	6 600	18 300	12 000
Punojnë (%)	9.1	6.3	2.9	1.8	10.9	7.9	20.7	13.1

Shënim. Periudha e referimit është java që i paraprin studimit.

Shpërndarja e punës është më e lartë te djemtë sesa te vajzat (tabela 2.3). Ndërsa 9.1 për qind e djemve të moshës 5-17 vjeç vlerësohen të jenë të punësuar, kjo shifër është 6.3 për qind për vajzat. Për më tepër, megjithëse hendeku gjinor në punësim është më i lartë te fëmijët më të rritur sesa tek ato më të vegjël, përsëri ai ekziston në të gjitha moshat: ekziston një ndryshim (hendek) prej 1.1 për qind (statistikisht i rëndësishëm në masën 10%) te 5-11-vjeçarët; një ndryshim prej 3 për qind (statistikisht i rëndësishëm në masën 1%) te 12-14-vjeçarët dhe një ndryshim prej 7.6 për qind (statistikisht i rëndësishëm në masën 1%) te 15-17-vjeçarët.

Ndërsa në tabelat 2.2 dhe 2.3 jepen shifrat e punësimit të fëmijëve bazuar në përfshirjen e tyre në aktivitet ekonomike, siç u raportua për javën që i parapriu studimit, në tabelat 2.4 dhe 2.5 jepen shifrat e punësimit të fëmijëve të raportuara për vitin që i parapriu studimit. Vlerat më të larta të paraqitura në tabelat e fundit mund të shpjegohen me përdorimin e një periudhe më të gjatë referimi.

Kur merret viti para studimit si periudhë referimi, shpërndarja e vlerësuar e punësimit te 5-17-vjeçarët rritet deri në 9.5 për qind, e cila përfaqëson një rritje të konsiderueshme (1.8 pikë ose 23%) mbi vlerën e bazuar në një periudhë më të shkurtër referimi. Ndryshime të magnitudave të njëjta janë vëzhguar për fëmijët e vegjël dhe ata më të rritur; vlera e shpërndarjes së punës bazuar në një periudhë 1-vjeçare referimi është 1.8 pikë (23%) më e lartë sesa vlera e bazuar në periudhën 1-javore të referimit te 5-11-vjeçarët, 2.2 pikë (23%) më e lartë te 12-14-vjeçarët dhe 4.0 pike (24%) më e lartë te 15-17-vjeçarët.

⁴ Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore (SHPFP) është shuma e të punësuarve dhe e të papunëve të ndarë sipas popullsisë. Për fëmijët nën moshën 15 vjeç, SHFPF-ja është e barabartë me shkallën e punësimit.

Tabela 2.4. Shpërndarja e punësimit sipas moshës - periudhë e gjatë referimi (1-vjeçare)

	Mosha 5-17	Mosha 5-11	Mosha 12-14	Mosha 15-17
Popullsia e fëmijëve	698 600	354 400	163 600	180 600
Punojnë (Nr-)	66 100	9 600	19 100	37 500
Punojnë (%)	9.5	2.7	11.6	20.8

Shënim. Periudha e referimit është viti para studimit.

Tabela 2.5. Shpërndarja e punësimit sipas moshës dhe seksit - periudhë e gjatë referimi (1-vjeçare)

	Mosha 5-17		Mosha 5-11		Mosha 12-14		Mosha 15-17	
	Djem	Vajza	Djem	Vajza	Djem	Vajza	Djem	Vajza
Popullsia e fëmijëve	357 800	340 800	189 700	164 600	79 600	84 000	88 500	92 100
Punojnë (Nr.)	41 100	24 900	6 200	3 500	11 400	7 500	23 600	13 900
Punojnë (%)	11.5	7.3	3.3	2.1	14.3	9.0	26.6	15.1

Shënim. Periudha e referimit është viti që i parapriu studimit.

Në përgjithësi, ndryshimi në periudhën e referimit ka një impakt më të madh në punësimin e djemve sesa të vajzave. Ndërsa vlera e punësimin të vajzave rritet me 1.0 pikë (nga 6.3% deri 7.3%) kur përdoret periudha më e gjatë e referimit, vlera e punësimin të djemve rritet me 2.4 pikë (nga 9.1% deri 11.5%). Këto shifra përfaqësojnë një rritje prej 16 për qind në vlerat e punësimin të vajzat dhe një rritje prej 26 për qind të djemtë. Megjithatë, te fëmijët më të vegjël, periudha e referimit ka një efekt më të madh mbi vlerat e punësimin të vajzave sesa të djemve: Te 5-11-vjeçarët, periudha më e gjatë e referimit rezulton në një rritje prej 16.7 për qind në vlerat e punësimin të vajzat, krahasuar me një rritje prej 13.8 për qind për djemtë, ndërsa rritjet korresponduese për 12-14-vjeçarët dhe 15-17-vjeçarët janë 13.9 për qind dhe 15.3 për qind, respektivisht, për vajzat, dhe 31.2 për qind dhe 28.5 për qind, respektivisht, për djemtë.

Përmbledhtazi, diskutimi i mësipërm sugjeron se në varësi të periudhës së referimit, 9-12 për qind e djemve dhe 6-9 për qind e vajzave janë në punësim. Ndryshimet në vlera nuk janë të habitshme, duke pasur parasysh që Studimi mbi punën e fëmijëve u krye kryesisht gjatë muajit maj, kohë kur shkollat janë të hapura dhe aktiviteti bujqësor nuk është në kulmin e tij. Punësimi sezonal i fëmijëve është ilustruar në figurën 2.1, e cila tregon përqindjen e fëmijëve të punësuar çdo muaj në lidhje me popullsinë e fëmijëve të punësuar në çfarëdo kohe të vitit.



Figura 2.1. Përqindja e fëmijëve të punësuar sipas muajve

Nuk është për t'u habitur që kulmi i punësimit të fëmijëve është në muajt korrik dhe gusht, kur 88 për qind e fëmijëve që punojnë janë të punësuar gjatë këtyre dy muajve. Pavarësisht nga punësimi sezonal, është e rëndësishme të vëmë në dukje se një përqindje e madhe e fëmijëve që punojnë, pothuajse 40%, punojnë gjatë gjithë vitit. Numri mesatar i muajve gjatë të cilëve fëmijët punojnë është afërsisht 7.5 për djemtë dhe 7.9 për vajzat.

Një tregues tjetër i ofertës së punës është numri i orëve që ata punojnë. SPF-ja mbledhi të dhëna mbi orët e punës bazuar në një periudhë referimi 1-javore dhe përfshiu informacion mbi punën kryesore të fëmijëve, si edhe mbi ndonjë punë shtesë të bërë gjatë javës së referimit. (Rreth 3 për qind e fëmijëve të punësuar kishin një punë shtesë gjatë javës së referimit.) Në tërësi, u vlerësua se fëmijët shpenzonin mesatarisht në punë 18.7 orë në javë, ku djemtë punonin pak më shumë orë në javë (19.5) sesa vajzat (17.6). Siç tregohet në figurën 2.2, shumica e fëmijëve punojnë rreth 10-20 orë në javë. Një përqindje e vogël e fëmijëve -9.3 për qind e të gjithë fëmijëve të punësuar- punojnë më shumë se 40 orë në javë, që do të thotë se ata kanë punë të rregullt, pra, me kohë të plotë. Numri më i lartë i orëve të punës në javë për djemtë sesa për vajzat është rezultat i faktit se një përqindje mjaft më e lartë djemsh sesa vajzash punojnë më shumë se 25 orë në javë.




Figura 2.2. Shpërndarja përmblendhëse empirike e orëve të punës së djemve dhe vajzave

2.3. Shkollimi i fëmijëve

Para vitit shkollor 2008-2009, arsimi i detyruar në Shqipëri zgjaste 8 vjet. Megjithatë, duke filluar nga viti shkollor 2008-2009, si rezultat i një amendimi të ligjit arsimor në vitin 2004, arsimi bazë i detyruar u rrit nga 8 në 9 vjet, për të përfshirë fëmijët e moshave 6 deri 14 vjeç. Si rezultat i këtij ndryshimi, fëmijët e studiuar nga SPF-ja u nënshtrohen dy lloje rregulloresh: një grup fëmijësh të cilët mbaruan arsimin bazë 8-vjeçar në fund të vitit shkollor 2007-2008 dhe meqenëse e kishin marrë diplomën e arsimit bazë mund të mos e vazhdonin shkollimin, dhe me një grup tjetër të cilët nuk e kishin mbaruar ende arsimin bazë 8-vjeçar të cilëve u kërkohej që të rrinin në shkollë deri sa të përfundonin 9 vitet e arsimit bazë. As parashkollorja, e cila mbulon fëmijët e moshave 3-6 vjeç, as shkolla e mesme, që normalisht zgjat 3 deri në 4 vjet dhe mbulon fëmijët e moshave 15 vjeç (ose, sipas ligjit të vjetër, moshë 14 vjeç) e lart, nuk janë të detyruara.

2.3.1. Ndjekja e shkollës

Shkalla mesatare e ndjekjes së shkollës nga 5-17-vjeçarët është vlerësuar të jetë 90.2 për qind, ku te djemtë kjo përqindje është paksa më e lartë (90.4%) sesa te vajzat (89.9%). Fëmijët e moshës shkollare të detyrueshme (6-15 vjeç) kanë një shkallë mesatare frekuentimi më të lartë (94.8%), me një ndryshim

po aq të vogël gjinor sa nuk është i rëndësishëm statistikisht (94.3% për djemtë dhe 95.3% për vajzat). Siç tregohet në piramidën e regjistrimit në shkollë⁵ (fig. 2.3), shkalla e ndjekjes së shkollës nga fëmijët e moshave 7-15 vjeç është më e lartë, por jo universale, dhe ndërsa parashkollorja nuk është e detyrueshme, pothuajse 65 për qind e 5-vjeçarëve janë regjistruar në shkollë.

Shkalla e ulët e ndjekjes së shkollës të 6-vjeçarët krahasuar me fëmijët më të rritur (78.4%) mund të shpjegohet me hyrjen me vonesë të 6-vjeçarëve në shkollën fillore, gjë që ndodh me fëmijët e lindur në çerekun e fundit të vitit, meqenëse prindërit mund t'i mbajnë fëmijët në shtëpi kur e ndjejnë se ata nuk janë të përgatitur për arsimin bazë. Koha kur u krye studimi gjithashtu mund të shpjegojë shkallën relativisht të ulët të ndjekjes së shkollës nga 6-vjeçarët. Megjithatë të dhënat e studimit nuk ofrojnë datat e sakta të lindjes, nëse lindjet janë pa një rend të caktuar, një e treta e 6-vjeçarëve mund ta kishin festuar ditëlindjen në vitin 2010 para se të intervistoheshin në maj, por nuk i kishin mbushur 6 vjeç deri pas fillimit të vitit shkollor 2009-2010; kështu, mund të ishte normale ta shtynin hyrjen në shkollë deri në fillim të vitit shkollor 2010-2011 në shtator. Në fakt, shkalla e ndjekjes së shkollës prej 98 për qind e 8- dhe 9-vjeçarëve konfirmon se shumica e 6-vjeçarëve që nuk ndiqnin shkollën gjatë kohës së studimit ka mundësi ta kenë filluar atë menjëherë më pas. Pas moshës 15-vjeçare përqindja e ndjekjes së shkollës bie ndjeshëm: për 16-vjeçarët, përqindja mesatare e ndjekjes së shkollës u vlerësua të jetë 81.1 për qind dhe për 17-vjeçarët, 75.2 për qind.




Figura 2.3. Piramida e regjistrimit në shkollë

Piramida e ndjekjes së shkollës tregon përqindje baras të favorshme të ndjekjes së shkollës nga djemtë dhe vajzat sipas moshës. Megjithatë shkalla e frekuentimit është pak më e lartë për vajzat sesa për djemtë në vitet e para të shkollimit (deri rreth moshës 12 vjeç), këto ndryshime nuk janë të rëndësishme nga ana statistikore (përveçse në moshën 10-vjeçare, kur ekziston një ndryshim prej 3.4 pikësh në favor të vajzave). Te fëmijët më të rritur, përqindjet e vlerësuara janë paksa më të larta për djemtë, por përsëri ndryshimet nuk janë të rëndësishme nga ana statistikore (përveçse në moshën 13-vjeçare, kur ekziston një ndryshim prej 2.8 pikësh në favor të djemve). Përtej arsimit të detyruar, përqindja e ndjekjes së shkollës bie ndjeshëm si për djemtë, ashtu edhe për vajzat. Në moshën 16-vjeçare rënia është më e madhe te vajzat, duke rezultuar në një ndryshim të rëndësishëm statistikor prej 4.6 pikësh në favor të djemve; megjithatë, hendeuku gjinor zhduket në moshën 17-vjeçare, si rezultat i daljes së hershme të djemve nga sistemi shkollor.

Figura 2.4 ilustron shpërndarjen e fëmijëve që nuk shkojnë në shkollë sipas moshës. Fëmijët më të vegjël (5-6 vjeç) dhe fëmijët më të rritur (16-17 vjeç) përfaqësojnë shumicën e fëmijëve pa shkollë, ku vetëm 5-vjeçarët përbëjnë 22 për qind të fëmijëve pa shkollë, të ndjekur nga 17-vjeçarët (20.3%),

⁵ Sipas piramidave të regjistrimit sipas moshës të Orazem dhe King (2008).

16-vjeçarët (16.3%) dhe 6-vjeçarët (14.9%). Është gjithashtu e rëndësishme të vëmë në dukje që përqindje jo të papërfillshme të 14- dhe 15-vjeçarëve nuk ndjekin shkollën. Ka mundësi që këta fëmijë i janë nënshtruar legjislacionit të mëparshëm dhe, kështu, mund të kenë lënë shkollën në vitin 2008 pas përfundimit të 8 viteve të shkollimit të detyruar.




Figura 2.4. Shpërndarja e fëmijëve që nuk ndjekin shkollën sipas moshës

Për sa i përket shumicës së fëmijëve të moshave 5-vjeçare, të cilët nuk ndjekin shkollën, ka mundësi që ata ta fillojnë shkollën brenda disa viteve. 15.8 për qind e 7-17-vjeçarëve raportuan se nuk kishin shkuar kurrë në shkollë; shumica e tyre (63.3%) raportuan se vuanin nga një paaftësi (invaliditet) dhe/ose sëmundje që i pengonte ata të shkonin në shkollë. Në këtë grup, aftësia për shkrim e lexim është vetëm 8.9 për qind, krahasuar me 84.5 për qind të të gjithë fëmijët që nuk ndjekin shkollën dhe 92.8 për qind të fëmijët që nuk ndjekin shkollën, por që nuk kanë as paaftësi, as sëmundje. Këto shifra nxjerrin në pah një nevojë urgjente për të hetuar arsyet që fshihen pas shkallës së lartë të analfabetizmit të fëmijët e paaftë dhe të fëmijët e tjerë në moshë për arsim të detyruar, të cilët nuk dinë as të shkruajnë e as të lexojnë në çfarëdolloj gjuhe.

2.3.2. Klasa për moshë

Tabela 2.6 ofron informacion mbi nivelin e klasës së fëmijëve aktualisht të regjistruar në shkollë sipas moshës. Shumica dërrmuese (99.3%) e 5-vjeçarëve që ndjekin shkollën janë në parashkollor. Shumica (65.4%) e 6-vjeçarëve që ndjekin shkollën janë po në parashkollor, ndërsa pjesa tjetër e 6-vjeçarëve që ndjekin shkollën (34.6%) janë në klasën e parë të arsimit bazë të detyruar. Siç u tha më lart, kjo mund të ketë lidhje me periudhën e vitit gjatë së cilës fëmijët kanë lindur. Te fëmijët 7-vjeçarë, mbi 80 për qind janë në klasën e parë të arsimit bazë, ndërsa 19.3 për qind kanë kaluar në klasën e dytë; edhe te fëmijët 8-vjeçarë, 69.2 për qind janë në klasën e dytë, 18 për qind janë në klasën e tretë ose më lart dhe vetëm një përqindje e vogël (12.8%) janë akoma në klasën e parë. Disa nga fëmijët 8-vjeçarë që ndjekin klasën e parë mund ta kenë filluar shkollën vonë.

Përqendrimi i fëmijëve që ndjekin shkollën në klasat e pritshme për moshën e tyre është tregues i kalimit normal të fëmijëve nga një klasë në tjetrën. Megjithatë, me kalimin e moshës, shpërndarja në klasë për moshë rritet. Për shembull, 68 për qind e 17-vjeçarëve janë në klasën e tretë të shkollës së mesme, 12.4 për qind janë në klasën e katërt të shkollës së mesme dhe pjesa tjetër, 19.3 për qind, janë në klasat më të ulëta. Në varësi të kohës kur ata filluan shkollën, në moshën 6- ose 7-vjeçare, fëmijët e moshës 17-vjeçare në kohën e studimit mund të ishin duke ndjekur ose vitin e tretë, ose të katërt të shkollës së mesme, duke nënkuptuar që ata që ishin në klasat më të ulëta mund të ishin përsëritës. Për më tepër, duke

pasur parasysh që fëmijët që përsërisin klasën janë më të prirë të lënë shkollën, progresioni i studentëve në nivelet e klasave mund të mos jetë aq normal dhe i lehtë sa ç'është treguar në tabelën 2.6.⁶

Tabela 2.6. Shpërndarja e fëmijëve të regjistruar aktualisht sipas nivelit të shkollës dhe të klasës (%)

	Mosha 5	Mosha 6	Mosha 7	Mosha 8	Mosha 9	Mosha 10	Mosha 11	Mosha 12	Mosha 13	Mosha 14	Mosha 15	Mosha 16	Mosha 17
Para-Shkollor	99.3	65.4	0.2										
AD Klasa 1	0.7	34.6	80.5	12.8		0.5							
AD Klasa 2			19.3	69.2	5.3	0.2							
AD Klasa 3				16.8	93.3	19.7	2.9						
AD Klasa 4				1.2	1.2	61.0	15.9						
AD Klasa 5						18.5	65.3	17.2	0.6		0.4		
AD Klasa 6							15.9	68.4	16.3	1.3	0.7		
AD Klasa 7					0.2*			14.1	70.2	16.4	2.6		0.2
AD Klasa 8								0.1	12.6	67.1	18.4	1.4	0.6
AD Klasa 9									0.2	15.2	64.1	15.4	1.8
Shkolla e mesme kl 1										0.04	13.9	58.9	8.3
Shkolla e mesme kl 2												22.4	8.6
Shkolla e mesme kl 3								0.11*				1.9	68.0
Shkolla e mesme kl 4												0.04	12.5
Shkollim jo standart									0.1				0.1

Shënim. AD i referohet arsimit të detyruar.

*Këto elemente larg diagonales ka mundësi të jenë gabime të dhënash.

Rezultatet mësimore të fëmijëve që ndjekin shkollën dhe të atyre që nuk shkojnë në shkollë mund të krahasohen duke analizuar rezultatet mësimore të fëmijëve në mosha të ndryshme.⁷ Te 16-vjeçarët, fëmijët që ndjekin shkollën është vlerësuar se kanë mbaruar 10.1 klasa, krahasuar me vetëm 8.2 klasa tek ato që kanë braktisur shkollën. Shifrat korresponduese të 17-vjeçarët janë respektivisht 11.8 dhe 8.2. Pra, në moshën 17-vjeçare, krijohet një hendek në rendin e 3.6 klasave midis fëmijëve që ndjekin shkollën dhe atyre pa shkollë.

Te 17-vjeçarët që nuk ndjekin më shkollën, shumica (85.7%) e lanë atë menjëherë pas përfundimit të arsimit të detyruar dhe një 2.3 për qind tjetër përfunduan nivelet e klasave më të larta para braktisjes së shkollës. Ky është një tregues që shumica e 17-vjeçarëve (93.3%), aktualisht, përfundojnë minimalisht arsimin e detyruar përpara lënies së sistemit shkollor.

2.4. Shërbimet e papaguara në familje të kryera nga fëmijët

Sipas SPF-së, 40.9 për qind e fëmijëve vlerësohet të jenë të angazhuar në shërbime të papaguara në familje (SHPF), (tabela 2.5). Shpërndarja e këtij lloj aktiviteti rritet me moshë, me 19.3 për qind të 5-11-vjeçarëve që kryejnë SHPF, krahasuar me 57.0 për qind të 12-14-vjeçarëve dhe 68.8 për qind të 15-17-vjeçarëve.

⁶ Moshat e fillimit të shkollës nga fëmijët nuk janë përfshirë në Pyetësoin e të rriturve. Pavarësisht faktit nëse fëmijët që ishin në moshën 17-vjeçare në momentin e studimit e filluan shkollën në moshën 6, 7 apo edhe 8 vjeç, ata duhet t'i jenë nënshtruar ligjit të vjetër që kërkonte 8 vite arsim bazë. Duhet theksuar, gjithashtu, se gabimet në të dhënat e raportimit të moshës apo të klasës mund të rezultojnë në një mbivlerësim të përsëritësve të klasës.

⁷ Kërkohet përshtatje për ndryshimet në moshë midis atyre që kanë lënë shkollën dhe fëmijëve që ndjekin shkollën, sepse të parët janë më të mëdhenj në moshë sesa fëmijët që janë aktualisht në shkollë. Meqenëse shumica e fëmijëve që kanë lënë shkollën janë të moshës 16-17 vjeç, rezultatet krahasohen mbi bazën e këtyre dy grup-moshave.

Një përqindje më e lartë vajzash sesa djemsh kryejnë shërbime të papaguara në familje. Te të gjithë fëmijët e moshës 5-17 vjeç, ndryshimi gjinor është 17.3 pikë (32.5% kundrejt 49.8%). Megjithatë, siç tregohet në tabelën 2.5, ky hendek priret të rritet me moshë nga 5.9 pikë te 5-11-vjeçarët deri në 19.9 pikë te 12-14-vjeçarët dhe 29.2 pikë te 15-17-vjeçarët. Për më tepër, vajzat harxhojnë më shumë kohë duke kryer shërbime të papaguara në familje sesa djemtë - mesatarisht 8.2 orë në javë për vajzat, krahasuar me 5.8 orë në javë për djemtë. Me fjalë të tjera, vajzat janë më të përfshira në kryerjen e SHPF-ve sesa djemtë, për sa i përket përqindjes së fëmijëve si edhe kohës së harxhuar.

Tabela 2.5. Shpërndarja e shërbimeve të papaguara në familje sipas moshës

	Mosha 5-17	Mosha 5-11	Mosha 12-14	Mosha 15-17
Popullsia e fëmijëve	698 600	354 400	163 600	180 600
SHPF (nr.)	285 800	68 300	93 300	124 200
SHPF (%)	40.9	19.3	57.0	68.8

Shënim. Periudha e referimit është java që i parapriu studimit.

Tabela 2.5. Shpërndarja e shërbimeve të papaguara në familje sipas moshës dhe seksit

	Mosha 5-17		Mosha 5-11		Mosha 12-14		Mosha 15-17	
	Djem	Vajza	Djem	Vajza	Djem	Vajza	Djem	Vajza
Popullsia e fëmijëve	357 800	340 800	189 700	164 600	79 600	84 000	88 500	92 100
SHPF (nr.)	116 300	169 600	31 400	36 900	37 300	56 100	47 700	76 600
SHPF (%)	32.5	49.8	16.5	22.4	46.8	66.7	53.9	83.1

Shënim. Periudha e referimit është java që i parapriu studimit.

Figura 2.5 pasqyron shpërndarjen përmblledhëse të djemve dhe të vajzave që kryejnë SHPF. Pavarësisht kontributit më të madh në dukje të vajzave në krahasim me djemtë, shumica dërrmuese e të dy palëve shpenzojnë më pak se 20 orë në javë, e cila korrespondon me afërsisht tre orë në ditë. Vetëm 3.9 për qind e të gjithë fëmijëve që kryejnë SHPF harxhojnë mbi 20 orë në javë (2.3% e djemve dhe 5.0% e vajzave).




Figura 2.5. Shpërndarjet përmblledhëse empirike të orëve të SHPF-së sipas seksit

Ekziston një hendek gjinor për sa i përket llojit të shërbimeve të papaguara në familje të kryera nga fëmijët, ku djemtë priren të angazhohen në bërjen e pazarit dhe të riparimeve, ndërsa vajzat angazhohen më shumë me gatim, pastrim, larje dhe aktivitete përkujdesjeje (figura 2.6).




Figura 2.6. Lloji i shërbimeve të papaguara në familje të kryera nga fëmijët sipas seksit




Figura 2.7. Lloji i shërbimeve të papaguara në familje të kryera nga fëmijët sipas moshës

Aktivitetet e kryera nga fëmijët gjithashtu ndryshojnë sipas moshës (figura 2.7). Bërja e pazarit, i cili është shërbimi i papaguar në familje më i zakonshëm i kryer nga fëmijët, angazhon një përqindje më të madhe të fëmijëve të vegjël sesa të fëmijëve më të rritur. Në rastin e fëmijëve të vegjël, “bërja e pazarit” i referohet më shumë punëve të shpejta, si p.sh dërgohen për të blerë bukë për darkë, sesa blerje më të mëdha të furnizimit të shtëpisë. Fëmijët më të vegjël janë më pak të përfshirë në aktivitete si gatimi, pastrimi dhe larja, të cilat kërkojnë më shumë fuqi fizike dhe njohuri. Çuditërisht, një përqindje më e madhe fëmijësh të vegjël sesa fëmijësh të mëdhenj janë të përfshirë në aktivitete përkujdesjeje: Ndërsa pothuajse një çerek i 5-11-vjeçarëve të cilët kryejnë SHPF angazhohen në aktivitete përkujdesjeje, përqindjet korresponduese të 12-14-vjeçarët dhe 15-17-vjeçarët janë respektivisht 18.5 për qind dhe 17.1 për qind. Në tërësi, këto gjetje sugjerojnë një ndarje të punës të fëmijët sipas moshës dhe gjinisë - *e para*, tregues i fuqisë fizike dhe, *e dyta*, tregues i roleve të përshtatshme në shoqëri për meshkujt dhe femrat.

2.5. Fëmijët në aktivitete të shumëfishta⁸

Një përqindje e madhe (43%) e fëmijëve të moshave 6-17 vjeç angazhohen në aktivitete të shumëfishta. Në përgjithësi, aktiviteti i vetëm më i rëndësishëm në jetën e fëmijëve është shkolla, ku 50.2% e 6-17-vjeçarëve ndjekin shkollën pa u përfshirë as në aktivitet ekonomik, as në shërbime të papaguara në familje (tabela 2.6). Modeli i dytë i përdorimit të kohës, i cili haset më shpesh (35.4%), është ai që kombinon shkollën me shërbimet e papaguara në familje, ndërsa një përqindje e vogël, por jo e papërfillshme e fëmijëve (4.3%), kombinojnë shkollën me shërbimet e papaguara në familje dhe aktivitetin ekonomik. Modele të tjera të përdorimit të kohës, që hasen më rrallë, përfshijnë kombinimin e shkollës me punësimin (1.9%), kombinimin e punësimit me shërbimet e papaguara në familje (1.4%), angazhimin ekskluzivisht në punësim (0.6%) dhe angazhimin ekskluzivisht në shërbime të papaguara në familje (2.3%).

Tabela 2.6. Modelet e përdorimit të kohës nga fëmijët e moshës 6-17 vjeç, sipas seksit

	Të gjithë	Djem	Vajza
Shkollë + punësim + shërbime të papaguara në familje	28 200 4.3%	14 800 4.4%	13 400 4.2%
Shkollë + punësim	12 500 1.9%	10 500 3.1%	2 000 0.6%
Shkollë + shërbime të papaguara në familje	232 300 35.4%	94 100 28.1%	138 300 43.0%
Punësim + shërbime të papaguara në familje	9 400 1.4%	3 900 1.2%	5 500 1.7%
Vetëm shkollë	329 600 50.2%	188 700 56.4%	140 900 43.8%
Vetëm punësim	3 900 0.6%	3 200 1.0%	700 0.2%
Vetëm shërbime të papaguara në familje	15 400 2.3%	3 200 1.0%	12 200 3.8%
Jo aktiv (nuk bën asgjë)	24 800 3.8%	16 400 4.9%	8 400 2.6%
Numri i përgjithshëm i fëmijëve të moshës 6-17 vjeç	656 100	334 800	321 300

Tabela 2.7. Modelet e përdorimit të kohës nga fëmijët e moshës 6-17 vjeç, sipas moshës

	Mosha 6-11	Mosha 12-14	Mosha 15-17
Shkollë + punësim + shërbime të papaguara në familje	4 600 1.5%	10 500 6.4%	13 100 7.3%
Shkollë + punësim	3 400 1.1%	4 000 2.5%	5 200 2.9%
Shkollë + shërbime të papaguara në familje	61 700 19.8%	79 600 48.6%	91 100 50.4%
Punësim + shërbime të papaguara në familje	300 0.1%	400 0.3%	8 600 4.8%
Vetëm shkollë	225 300 72.2%	62 800 38.4%	41 500 23.0%
Vetëm punësim	100 0.02%	400 0.2%	3 500 1.9%
Vetëm shërbime të papaguara në familje	1 100 0.4%	2 800 1.7%	11 400 6.3%
Jo aktiv (Nuk bën asgjë)	15 400 5.0%	3 100 1.9%	6 200 3.5%
Numri i përgjithshëm i fëmijëve	311 800	163 600	180 600

⁸ Ky seksion mbulon fëmijët e moshave 6-17 vjeç, meqenëse fëmijët nuk fillojnë arsimin e detyruar deri në moshën 6 vjeç.

Modelet e përdorimit të kohës ndryshojnë mes djemve dhe vajzave. Për shembull, përqindje më të mëdha të djemve sesa të vajzave ndjekin shkollën pa u përfshirë as në aktivitete ekonomike, as në shërbime të papaguara në familje (56.4% kundrejt 43.8%), kombinojnë shkollën me aktivitetin ekonomik (3.1% kundrejt 0.6%) ose angazhohen ekskluzivisht në punësim (1.0% kundrejt 0.2%). Në krahasim me këtë, përqindje më të mëdha vajzash sesa djemsh kombinojnë shkollën me shërbimet e papaguara në familje (43% kundrejt 28.1%) ose angazhohen ekskluzivisht në shërbime të papaguara në familje (3.8% kundrejt 1.0%).

Modelet e përdorimit të kohës gjithashtu ndryshojnë edhe sipas moshës (tabela 2.7). Ndryshimi më i rëndësishëm shtrihet në përqindjen e fëmijëve që ndjekin shkollën pa u angazhuar as në aktivitete ekonomike, as në shërbime të papaguara në familje. Kjo shifër është më e lartë te 6-11-vjeçarët (72.2%), ndjekur nga 12-14-vjeçarët (38.4%) dhe 15-17-vjeçarët (23%). Me kalimin e moshës, fëmijët priren të kombinojnë shkollën me aktivitete të tjera, ku më të zakonshmet ndër to janë shërbimet e papaguara në familje. Përqindja e fëmijëve të angazhuar ekskluzivisht në punësim ka një tendencë rritjeje me kalimin e moshës, megjithëse edhe te fëmijët më të rritur të moshës 15-17-vjeçare, kjo shifër është e kufizuar në 1.9 për qind. Një përqindje e vogël fëmijësh (3.8%) janë joaktivë, domethënë nuk janë të angazhuar në shkollë, aktivitete ekonomike apo shërbime të papaguara në familje. Nga këta, shumica (40.6%) janë 6-vjeçarë; një përqindje e madhe e tyre (88%) janë konsideruar nga prindërit e tyre si shumë të vegjël për të filluar shkollën dhe ka shumë gjasa edhe shumë të vegjël për t'u angazhuar në aktivitete të tjera. Ky lloj mosveprimi ose plogështie, gjithashtu, priret të jetë më e lartë te 16- dhe 17-vjeçarët, të cilët përbëjnë, respektivisht, 11.4% dhe 9.4% të fëmijëve jo aktivë. Fëmijët më të rritur jo aktivë mund të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe kanë zgjedhur të mos vazhdojnë më tej. Duke pasur parasysh faktet që vetëm një përqindje shumë e vogël e fëmijëve më të rritur jo aktivë nuk kanë ndjekur kurrë shkollën (kryesisht për shkak të një invaliditeti/sëmundjeje), që shumica e tyre (67.2%) janë djem dhe që ekziston një shkallë e lartë pjesëmarrjeje në punë te meshkujt në Shqipëri, arrijmë në konkluzionin se shumica e fëmijëve më të rritur jo aktivë janë në procesin e tranzicionit nga shkolla në punë.⁹

⁹ Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore në Shqipëri është dukshëm e ulët te gratë. SPF-ja e vlerëson këtë shkallë të jetë në masën 59.1% për gratë e rritura të moshës 18-64, krahasuar me 84.2% për burrat.

SEKSIONI

3

NATYRA E PUNËSIMIT TË FËMIJËVE DHE PUNA E FËMIJËVE

Ky seksion i raportit i hedh një vështrim nga afër natyrës së punësimit të fëmijëve e matur nga lloji i aktivitetit ekonomik, profesioni, statusi në punësim dhe fitimi. Një pjesë e rëndësishme e këtij seksioni i kushtohet të kuptuarit të mbizotërimit dhe karakteristikave të punësimit dhe punës së fëmijëve. Gjithashtu, në këtë seksion, diskutohen aspektet rajonale të punësimit dhe punës së fëmijëve.

3.1. Aktiviteti ekonomik

Shumica e fëmijëve që punojnë (80%) janë të përfshirë në aktivitetet bujqësor dhe një përqindje tjetër e konsiderueshme (8.2%) janë të përfshirë në tregti me shumicë dhe pakicë. Një përqindje e vogël (2%) punojnë në ndërtim, një lloj aktiviteti ekonomik ky i cili është i ndaluar në shumë vende për individët nën moshën 18 vjeç. Hotelet dhe restorantet punësojnë 4.1 për qind të fëmijëve që punojnë, ndërsa manifaktura punëson 1.8 për qind.

Tabela 3.1. Shpërndarja e fëmijëve në punësim sipas llojit të aktivitetit ekonomik

Aktiviteti ekonomik (NACE rev.1.1)	Të gjithë	Djem	Vajza
Bujqësi, gjueti, pylltari dhe peshkim	43 200 80.0%	25 200 77.8%	18 000 83.3%
Manufakturë	1 000 1.8%	600 2.0%	400 1.6%
Elektricitet, gaz, ujë	200 0.3%	200 0.5%	0 0.0%
Ndërtim	1 100 2.0%	1 000 3.1%	100 0.5%
Tregti me shumicë dhe pakicë	4 400 8.2%	2 600 8.1%	1 800 8.4%
Hotele dhe restorante	2 200 4.1%	1 700 5.1%	600 2.6%
Transport, magazinim dhe komunikacion	500 1.0%	200 0.7%	300 1.4%
Aktivitete të tjera	200 0.6%	0 0.0%	200 1.1%
Të paklasifikuara (mbushja e ujit, ndihma në shtëpi)	1 200 2.1%	900 2.8%	300 1.2%
Numri i përgjithshëm i fëmijëve të punësuar	54 000	32 400	21 600

Shpërndarja e punësimit sipas llojit të aktivitetit ekonomik është njëlloj si për djemtë, ashtu edhe për vajzat. Për shembull, shumica e të dy grupeve janë të angazhuar në aktivitetet bujqësor, megjithëse përqindja e vajzave (83.3%) është paksa më e lartë se ajo e djemve (77.8%). Përqindjet e vajzave dhe të

djemve të angazhuar në tregti me shumicë dhe me pakicë janë gjithashtu të njëjta dhe vlerësohen të jenë 8.4 për qind për vajzat dhe 8.1 për qind për djemtë. Në krahasim me këtë, një përqindje më e madhe djemsh janë të punësuar në manifakturë, ndërtim, hotele dhe restorante.

Tabela 3.2. Shpërndarja e fëmijëve në punësim sipas llojit të aktivitetit ekonomik dhe moshës

Aktiviteti ekonomik (NACE rev.1.1)	Mosha 5-11	Mosha 12-14	Mosha 15-17
Bujqësi, gjueti, pylltari dhe peshkim	7,200 86.2%	12,700 83.1%	23,300 76.7%
Manifakturë	0 0.0%	300 1.9%	700 2.3%
Elektricitet, gaz, ujë	0 0.0%	0 0.0%	200 0.5%
Ndërtim	200 2.2%	100 0.6%	800 2.7%
Tregti me shumicë dhe pakicë	200 2.9%	1,000 6.5%	3,200 10.6%
Hotele dhe restorante	0 0.0%	800 5.4%	1,400 4.6%
Transport, magazinim dhe komunikacion	0 0.0%	100 0.9%	400 1.3%
Aktivitete të tjera	0 0.0%	0 0.0%	200 0.8%
Të paklasifikuara (mbushje dhe transportim uji, ndihmë në shtëpi)	700 8.7%	300 1.6%	200 0.6%
Numri i përgjithshëm i fëmijëve të punësuar	8,400	15,300	30,300

Llojet e aktivitetit ekonomik në të cilat angazhohen fëmijët variojnë me moshë. Fëmijët më të vegjël priren të jenë më të përfshirë në aktivitet bujqësor, që përbën 86.2 për qind të punësimit të fëmijëve të 5-11-vjeçarët, krahasuar me 83.1 për qind të 12-14-vjeçarët dhe 76.7 për qind të 15-17-vjeçarët. Në kontrast me këtë, tregtia me shumicë dhe pakicë -aktiviteti i dytë që haset më shpesh te fëmijët- përbën një përqindje më të lartë të fëmijëve më të rritur sesa të fëmijëve më të vegjël, domethënë, 2.9 për qind e 5-11-vjeçarëve, 6.5 për qind e 12-14-vjeçarëve dhe 10.6 për qind e 15-17-vjeçarëve. Fëmijët më të rritur kanë më shumë mundësi për t'u punësuar në hotele dhe restorante si edhe në manifakturë. Çuditërisht, përveç përqindjeve të 12-14-vjeçarëve (0.6%) dhe të 15-17-vjeçarëve (2.7%) të angazhuar në ndërtim, një përqindje jo e papërfillshme (2.2%) e fëmijëve më të vegjël të moshës 5-11 vjeç gjithashtu janë të angazhuar në ndërtim. Për më tepër, një përqindje e konsiderueshme (8.7%) e 5-11-vjeçarëve janë të angazhuar në aktivitete të paklasifikuara, të cilat kanë lidhje kryesisht me aktivitete ekonomike që kryhen në shtëpi, siç është, për shembull, mbushja dhe transportimi i ujit.

3.2. Profesioni

Tabela 3.3 paraqet shpërndarjen e fëmijëve sipas profesioneve (siç listohen nga sistemi i klasifikimit ISCO-08). Sipas saj, është vlerësuar se 80 për qind e fëmijëve që punojnë janë punonjës bujqësie, ku 78.8 për qind u klasifikuan si punëtorë fillestarë bujqësie dhe 1.2 për qind si punëtorë të kualifikuar bujqësie. Kjo është në përputhje me gjetjen më të hershme që fëmijët punojnë kryesisht në sektorin bujqësor. Punëtorët e shërbimit dhe shitjeve përbëjnë një grup tjetër të rëndësishëm (10.5%) të fëmijëve që punojnë, ku 4.1 për qind u klasifikuan si punëtorë të shërbimeve personale, 3.3 për qind si punëtorë shitjesh në rrugë ose në treg dhe 2.9 për qind si punëtorë artizanë dhe të profesioneve të tjera që kanë lidhje me tregtinë.

Tabela 3.3. Shpërndarja e fëmijëve në punësim sipas profesionit

Profesioni (ISCO-08)	Të gjithë	Djem	Vajza
Teknikë dhe ndihmës	300 0.6%	0 0.0%	300 1.4%
Punëtorë të shërbimit dhe të shitjeve	5700 10.5%	3400 10.3%	2300 10.7%
<i>Punëtorë të shërbimeve personale (518)</i>	2200 4.1%	1600 4.9%	600 2.9%
<i>Shitës në rrugë ose në treg (521)</i>	1800 3.3%	900 2.7%	900 4.3%
<i>Tjetër</i>	1700 3.1%	900 2.7%	800 3.5%
Punëtorë bujqësie të kualifikuar	600 1.2%	400 1.3%	200 1.0%
Punëtorë artizanë	1500 2.9%	1200 3.8%	300 1.5%
Operatorë makinerish në uzina, montatorë	100 0.2%	100 0.4%	0 0.0%
Profesionet elementare	45 500 84.3%	27 000 83.4%	18 500 85.5%
<i>Punëtore bujqësie, pylltarie dhe peshkimi (921)</i>	42 500 78.8%	24 800 76.7%	17 700 82.0%
<i>Punëtore minierash dhe ndërtimi (931)</i>	800 1.5%	800 2.5%	0 0.0%
<i>Tjetër</i>	2200 2.9%	1400 4.2%	800 3.5%
Numri i përgjithshëm i fëmijëve të punësuar	54 000	32 400	21 600

Shënim. Informacioni mbi punësimin është i padisponueshëm për 0.4% të të gjithë fëmijëve që punojnë dhe 0.7% të djemve që punojnë.

Profesionet e mbajtura nga fëmijët ndryshojnë në një farë mënyre nga seksi. Për shembull, 83 për qind e vajzave janë klasifikuar si punëtore bujqësie, duke përfshirë 82 për qind punëtore bujqësie fillestare, ndërsa shifrat korresponduese për djemtë janë 78 për qind dhe 76.7 për qind. Pothuajse në përqindje të barabarta djemsh dhe vajzash punojnë si punëtorë shërbimi dhe shitjesh, por ndërsa në këtë kategori shumica e vajzave janë punëtore shitjesh, shumica e djemve janë punëtorë shërbimesh. Përqindjet e djemve që punojnë si punëtorë artizanë dhe operatorë makinerish në uzina dhe punëtorë minierash e ndërtimi janë më të larta krahasuar me vajzat.

Tabela 3.4. Shpërndarja e fëmijëve në punësim sipas profesionit dhe moshës

Profesioni (ISCO-08)	Mosha 5-11	Mosha 12-14	Mosha 15-17
Teknikë dhe ndihmës	0 0.0%	0 0.0%	300 1.0%
Punëtorë shërbimesh dhe shitjesh	100 0.7%	1600 10.7%	4000 13.1%
<i>Punëtorë të shërbimeve personale (518)</i>	0 0.0%	800 5.4%	1400 4.6%
<i>Shitës në rrugë dhe në treg (521)</i>	0 0.0%	200 1.5%	1,600 5.1%
<i>Tjetër</i>	100 0.7%	600 3.7%	1000 3.4%
Punëtorë bujqësie të kualifikuar	0 0.0%	100 0.8%	500 1.7%
Punëtorë artizanë	0 0.0%	200 1.1%	1400 4.5%
Operatorë makinerish në uzina, montatorë	0 0.0%	0 0.0%	100 0.4%

FËMIJËT QË PUNOJNË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Rezultatet e studimit kombëtar mbi punën e fëmijëve për vitin 2010

Profesioni (ISCO-08)	Mosha 5-11	Mosha 12-14	Mosha 15-17
Profesionet elementare	8100 96.6%	13 400 87.4%	24 000 79.2%
<i>Punëtorë bujqësie, pylltarie dhe peshkimi (921)</i>	7200 86.2%	12 800 83.6%	22 500 74.3%
<i>Punëtorë minierash dhe ndërtimi (931)</i>	200 2.2%	<100 0.3%	600 1.9%
<i>Tjetër</i>	700 8.2%	600 2.5%	900 3.0%
Numri i përgjithshëm i fëmijëve të punësuar	8400	15 300	30 300

Shënim. Informacioni mbi profesionin është i padisponueshëm për 2.7% të 5-11-vjeçarëve që punojnë.

Profesionet e fëmijëve ndryshojnë edhe sipas moshës. Ndërsa bujqësia përfaqëson një prani të fuqishme në jetën e fëmijëve të vegjël dhe atyre më të rritur, përqindja e fëmijëve të angazhuar në bujqësi bie me moshë, ku 86.2 për qind e 5-11-vjeçarëve janë të punësuar si punëtorë fillestarë bujqësie, krahasuar me 84.4 për qind të 12-14-vjeçarëve dhe 76 për qind të 15-17-vjeçarëve. Nga ana tjetër, përqindja e fëmijëve të angazhuar në punë shërbimesh apo shitjesh rritet me moshë, nga 0.7 për qind të 5-11-vjeçarët deri në 10.7 për qind të 12-14-vjeçarët dhe 13.2 për qind të 15-17-vjeçarët. Vlen për t'u përmendur edhe rritja e menjëhershme e përqindjes së fëmijëve të angazhuar si punëtorë shitjesh: ndërsa asnjë fëmijë i moshës 5-11-vjeçarë nuk u klasifikua si punëtor shitjesh, 1.5 për qind e 12-14-vjeçarëve dhe 5.1 për qind e 15-17-vjeçarëve u klasifikuan si punëtorë shitjesh. Përqindja e fëmijëve që punojnë si punëtorë artizanë është shumë e vogël dhe vlerësohet të jetë më pak se 5 për qind e 15-17-vjeçarëve që punojnë dhe afërsisht 1 për qind e 12-14-vjeçarëve që punojnë.

3.3. Vendi i punës

Në tërësi, 73 për qind e fëmijëve punojnë në ferma ose në kopshte; 7.9 për qind punojnë në dyqane, restorante apo hotele; 5.1 për qind punojnë brenda mjediseve të banesës së tyre personale; 4.6 për qind nuk kanë një vend pune fiks dhe 4.4 për qind punojnë me tezgë në rrugë ose në treg.

Tabela 3.5. Shpërndarja e fëmijëve në punësim sipas vendit të punës

Vendi i punës	Të gjithë	Djem	Vajza
Në banesën e tyre	2800 5.1%	1600 4.8%	1200 5.6%
Shtëpia e klientit	700 1.2%	500 1.5%	200 0.8%
Zyrë formale	<100 0.1%	<100 0.2%	0 0.0%
Fabrikë/atelie	400 0.8%	200 0.6%	200 1.0%
Fermë/kopsht/plantacion	39 400 73.0%	22 700 70.0%	16 700 77.4%
Kantier ndërtimi	200 0.4%	200 0.7%	0 0.0%
Miniera/gurore	<100 0.1%	<100 0.2%	0 0.0%
Dyqan/kioskë/kafene/restorant/hotel	4300 7.9%	2500 7.6%	1800 8.3%
Vende të ndryshme (të lëvizshme)	2500 4.6%	2000 6.3%	2500 .2%
Tezgë fikse në rrugë/treg	2400 4.4%	1600 5.0%	800 3.6%

FËMIJËT QË PUNOJNË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Rezultatet e studimit kombëtar mbi punën e fëmijëve për vitin 2010

Vendi i punës	Të gjithë	Djem	Vajza
Ujëmbledhës/liqen/lumë	700 1.3%	500 1.6%	200 0.7%
Tjetër	600 1.1%	500 1.5%	100 0.5%
Numri i përgjithshëm i fëmijëve të punësuar	54 000	32 400	21 600

Në përgjithësi, vendet e punës për djemtë dhe për vajzat janë të njëjta; shumica e tyre (70% e djemve dhe 77.4% e vajzave) punojnë në fermë ose në kopsht. Përqindjet e djemve dhe vajzave që punojnë në dyqane, restorante apo hotele janë gjithashtu të njëjta (respektivisht 7.6% dhe 8.3%); megjithatë, përqindja e djemve të cilët nuk kanë një vend fiks pune është më e madhe sesa e vajzave (respektivisht 6.3% dhe 2.2%).

Tabela 3.6. Shpërndarja e fëmijëve në punësim sipas vendit të punës dhe moshës

Vendi i punës	Mosha 5-11	Mosha 12-14	Mosha 15-17
Në banesën e tyre	400 4.7%	500 3.4%	1900 6.1%
Shtëpia e klientit	<100 0.9%	<100 0.6%	500 1.6%
Zyrë formale	0 0.0%	0 0.0%	<100 0.3%
Fabrikë/atelie	0 0.0%	200 1.0%	300 0.8%
Fermë/kopsht/plantacion	6800 81.8%	12200 79.4%	20400 67.3%
Kantier ndërtimi	0 0.0%	0 0.0%	200 0.7%
Miniera/gurore	0 0.0%	0 0.0%	<100 0.2%
Dyqan/kioskë/kafene/restorant/hotel	60 0.7%	1300 8.2%	2900 9.7%
Vende të ndryshme (të lëvizshme)	300 3.2%	400 2.8%	1800 5.9%
Tezgë fikse në rrugë ose në treg	600 7.7%	400 2.8%	1300 4.4%
Ujëmbledhës/liqen/lumë	80 1.0%	200 1.3%	400 1.3%
Tjetër	0 0.0%	<100 0.5%	500 1.7%
Numri i përgjithshëm i fëmijëve të punësuar	8400	15 300	30 300

Punësimi në fermë ose kopsht bie me rritjen e fëmijëve, gjë që është në një vijë me gjetjen që përqindja e fëmijëve të angazhuar si punëtorë bujqësie bie me kalimin e moshës. Ndërsa 81.8 për qind e 5-11-vjeçarëve punojnë në fermë ose kopsht, kjo shifër është 79.4 për qind te 12-14-vjeçarët dhe 67.3 për qind te 15-17-vjeçarët. Në kontrast me këtë, përqindjet e fëmijëve që punojnë në shtëpinë e klientit dhe në dyqane, restorante apo hotele rriten me moshë. Puna në tezgë në rrugë ose në treg dhe puna pa pasur një vend pune fiks nuk kanë një tendencë të qartë bazuar te moshë.

3.4. Statusi në punësim

Shumica dërrmuese e të gjithë fëmijëve që punojnë (87.2% e djemve dhe 93.4% e vajzave) janë punëtorë pa pagesë në familje, ndërsa përqindje mjaft të vogla fëmijësh punojnë për llogari të tyre (5.4% e djemve dhe 3.3% e vajzave) ose si punëtorë me pagë (7.4% e djemve dhe 3.2% e vajzave). Asnjë fëmijë që punon si punëtor me pagë nuk ka kontratë pune me shkrim.

Tabela 3.7. Shpërndarja e djemve dhe e vajzave të punësuar sipas statusit në punësim

Statusi në punësim	Të gjithë	Djem	Vajza
Punëtor me pagë (punëmarrës)	3100 5.8%	2400 7.4%	700 3.2%
Punëtor për llogari të vet	2500 4.6%	1700 5.4%	700 3.3%
Punëtor i papaguar në familje	48 400 89.7%	28 200 87.2%	20 200 93.4%
Numri i përgjithshëm i fëmijëve të punësuar	54 000	32 400	21 600

Tabela 3.8. Shpërndarja e djemve dhe e vajzave të punësuar sipas statusit në punësim dhe moshës

Statusi në punësim	Mosha 5-11	Mosha 12-14	Mosha 15-17
Punëtor me pagë (punëmarrës)	0 0.0%	500 3.0%	2600 8.7%
Punëtor për llogari të vet	500 5.7%	400 2.8%	1600 5.2%
Punëtor i papaguar në familje	7900 94.3%	14 400 94.3%	26 100 86.1%
Numri i përgjithshëm i fëmijëve të punësuar	8400	15 300	30 300

Puna e papaguar në familje ka një tendencë rënieje me rritjen e fëmijëve. Te fëmijët që punojnë, 94.3 për qind e 5-11-vjeçarëve dhe e 12-14-vjeçarëve janë punëtorë të papaguar në familje, krahasuar me 86.1 për qind të 15-17-vjeçarëve. Puna me pagë, nga ana tjetër, është e kufizuar në 3 për qind të fëmijëve të moshës 12-14 vjeç dhe 8.7 për qind në fëmijët e moshës 15-17 vjeç. Është interesant fakti që puna për llogari të vet priret të jetë më e lartë te fëmijët 5-11 vjeç dhe 15-17 vjeç, sesa te ata 12-14 vjeç, megjithëse ajo nuk i kalon 6 për qind në secilin nga këto grupe.

3.5. Fitimet dhe përfitimet¹⁰

Siç u përmend më sipër, fëmijët që punojnë si punëtorë me pagë ose për llogari të tyre përbëjnë 10.4 për qind të të gjithë fëmijëve që punojnë dhe, marrë së bashku, të ardhurat mujore me para në dorë të tyre vlerësohen të jenë 125 117 lekë shqiptare.¹¹ Në krahasim me këtë, të ardhurat mujore me para në dorë të të rriturve me pagë (domethënë të atyre të moshës 18-64 vjeç) vlerësohen të jenë 291 217 lekë¹² dhe të të gjithë punëtorëve të rritur 270 243 lekë.¹³ Me fjalë të tjera, fëmijët fitojnë rreth 43-46 për qind të asaj çfarë fitojnë të rriturit.

Nga 5.8 për qind e fëmijëve që punojnë, të cilët janë punëtorë me pagë, një përqindje e vogël, gjithashtu, marrin përfitime jomonetare nga puna, si p.sh.: ditë pushimi në javë (16%), ditë pushimi në javë plus leje të paguar për arsye shëndetësore (5.6%), ditë pushimi në javë plus ushqim/vaktet (2.7%) dhe leje vjetore (4.6%). Megjithatë, 71.1 për qind e punëtorëve me pagesë nuk marrin asnjë përfitim jomonetar nga puna.

¹⁰ Si rezultat i një numri të vogël vëzhgimesh, analizat në këtë seksion nuk janë ndarë sipas seksit apo moshës.

¹¹ Devijimi standard: 75 824.

¹² Devijimi standard: 147 796.

¹³ Devijimi standard: 170 686.

3.6. Punëtorët fëmijë

Punëtorët fëmijë përfshijnë fëmijët të cilët kryejnë punë të rrezikshme si edhe fëmijët të cilët, si rezultat i moshës apo orëve të punës, konsiderohen si fëmijë që hasin rreziqe të ndryshme për zhvillimin e tyre fizik, shoqëror, psikologjik apo arsimor si rrjedhojë e punësimit të tyre (shiko seksionin 1.3 mbi përkufizimet). Në Shqipëri vlerësohen të jenë 35 500 fëmijë – 5.1 për qind e të gjithë fëmijëve të moshës 5-17-vjeçare dhe 65.8 për qind e të gjithë fëmijëve që punojnë të moshës 5-17-vjeçare – që konsiderohen punëtorë fëmijë.

Tabela 3.9. Shpërndarja e fëmijëve punëtorë sipas llojit të rreziqeve që hasin (%)

Punëtorët fëmijë	Të gjithë		Djem		Vajza	
Puna e fëmijëve në numra (a+b+c)	35 500		22 200		13 300	
Punëtorët fëmijë si përqindje e të gjithë fëmijëve	5.1%		6.2%		3.9%	
a) Fëmijët në punë të rrezikshme	20 200 56.6%	100%	12500 56.2%	100%	7700 57.4%	100%
<i>Në aktivitet ekonomik të rrezikshëm</i>	1100 3.1%	5.5%	1000 4.5%	8.0%	100 0.8%	1.4%
<i>Në profesion të rrezikshëm</i>	500 1.3%	2.3%	500 2.1%	3.7%	0 0.0%	0.0%
<i>Të punësuar në kushte të rrezikshme</i>	18 600 52.2%	92.2%	11000 49.6%	88.3%	7600 56.6%	98.6%
b) Fëmijët që punojnë të moshës 5-13-vjeçare	10 100 28.5%	100%	6600 29.8%	100%	3500 26.4%	100%
c) Moshat 14-15-vjeçare që punojnë më shumë se 14 orë/javë dhe moshat 16-17-vjeçare që punojnë më shumë se 48 orë/javë	5300 14.8%	100%	3100 14.0%	100%	2200 16.2%	100%

Me qëllim që të kuptojmë më mirë llojet e rreziqeve me të cilat përballen në punë, fëmijët mund të grupohen së bashku në kategori ekskluzive të përbashkëta sipas llojit dhe kushteve të punës së tyre (shiko seksionin 1.3, tabela 1.2). Në një linjë me këtë kategorizim, tabela 3.9 pasqyron shpërndarjen e punës së fëmijëve në të cilën fëmijët numërohen vetëm një herë, edhe pse përballen me rreziqe të shumëfishta. Siç tregon tabela, 56.6 për qind e punëtorëve fëmijë janë të angazhuar në punë të rrezikshme; fëmijët që konsiderohen tepër të vegjël për të punuar, madje edhe për një orë në javë, përbëjnë 28.5 për qind të punëtorëve fëmijë; fëmijët e moshës 14-vjeçare dhe më të mëdhenj, të cilët punojnë orë të tepërta për moshën e tyre, përbëjnë 14.8 për qind të punëtorëve fëmijë. Te fëmijët që janë të angazhuar në punë të rrezikshme, shumica dërrmuese (92.2%) janë të punësuar në kushte të rrezikshme, ndërsa 3.1 për qind janë të angazhuar në aktivitete të rrezikshme ekonomike dhe 1.3 për qind në profesione të rrezikshme. Duhet theksuar se ndërsa vlerësimet e bëra këtu janë ndikuar nga renditja e rreziqeve (dhe si rrjedhim kemi formimin e kategorive ekskluzive të përbashkëta të punës së fëmijëve), duke pasur parasysh faktin që industrinë dhe profesionet e rrezikshme janë të listuara të parat, duhet thënë se fëmijët në Shqipëri klasifikohen si punëtorë fëmijë jo aq shumë për shkak të profesioneve që ata mbajnë apo nga industrinë ku ata punojnë (shumica e fëmijëve janë të punësuar në bujqësi si punëtorë të papaguar në familje), por për shkak të kushteve në të cilat punojnë.

Djemtë përbëjnë 62.5 për qind të punëtorëve fëmijë, pjesërisht si rezultat i shkallës së tyre më të lartë të punësimit krahasuar me vajzat.¹⁴ Megjithatë, siç tregohet në tabelën 3.9, përveç ndryshimit në shkallën e punës së fëmijëve, djemtë dhe vajzat përballen me rreziqe mjaft të ngjashme. Për shembull, te punëtorët fëmijë, 56.2 për qind e djemve dhe 57.4 për qind e vajzave janë të angazhuar në punë të

¹⁴ Nuk është kryer analizë e punës së fëmijëve sipas grup-moshave, meqenëse mosha është tashmë një nga përcaktuesit e punës së fëmijëve.

rrezikshme; 29.8 për qind e djemve dhe 26.4 për qind e vajzave janë fëmijë shumë të vegjël për të punuar dhe 14.0 për qind e djemve dhe 16.2 për qind e vajzave janë fëmijë të moshës 14-vjeçare ose më të mëdhenj, të cilët punojnë për orë tepër të gjata për moshën e tyre. Te djemtë dhe vajzat të angazhuar në punë të rrezikshme, përqindja e vajzave (98.6%) të punësuar në kushte të këqija pune e kalon atë të djemve (88.3%), ndërsa përqindja e djemve të angazhuar në industri ose profesione që kërkojnë heqjen e tyre të menjëhershme e kalon atë të vajzave.

3.6.1. Lloji i aktivitetit ekonomik të kryer nga punëtorët fëmijë

Shumica e punëtorëve fëmijë (81.7%) janë të punësuar në bujqësi (tabela 3.10), një përqindje tjetër e konsiderueshme (6.1%) janë në tregtinë me shumicë dhe pakicë, një tjetër 4.4 për qind punojnë në hotele dhe restorante dhe 3.1 për qind janë në ndërtim. Është interesant fakti që kjo shpërndarje është shumë e ngjashme me atë të fëmijëve të cilët punojnë (shiko tabelat 3.1 dhe 3.10), që tregon se kushtet në të cilat fëmijët punojnë nuk ndryshojnë në mënyrë drastike për aktivitete të ndryshme ekonomike. Nëse, për shembull, bujqësia do të ofronte një mjedis pune më të sigurt sesa sektorët e tjerë ekonomikë, pjesëmarrja e punëtorëve fëmijë do të kishte qenë më e ulët sesa pjesëmarrja e fëmijëve që punojnë. Arsyeja pse nuk ndodh kështu (bujqësia llogarit, respektivisht, 81.7% dhe 80% të punëtorëve fëmijë dhe të fëmijëve që punojnë) tregon se nuk është vetë puna në bujqësi ajo që përbën rrezik për fëmijët, por kushtet në të cilat punojnë fëmijët në bujqësi (duke përfshirë edhe orët e tyre të punës), që rezultojnë në klasifikimin e tyre si punëtorë fëmijë.

Tabela 3.10. Shpërndarja e punëtorëve fëmijë sipas llojit të aktivitetit ekonomik

Aktiviteti ekonomik (NACE rev.1.1)	Të gjithë	Djem	Vajza
Bujqësi, gjueti, pylltari dhe peshkim	29 000 81.7%	17 500 78.7%	11 600 86.6%
Manufakturë	500 1.4%	400 1.7%	100 1.0%
Elektricitet, gaz, ujë	0 0.0%	0 0.0%	0 0.0%
Ndërtim	1100 3.1%	1000 4.5%	100 0.8%
Tregti me shumicë dhe pakicë	2200 6.1%	1500 6.5%	700 5.3%
Hotele dhe restorante	1500 4.4%	1000 4.7%	500 3.9%
Transport, magazinim dhe komunikacion	100 0.4%	100 0.6%	0 0.0%
Aktivitete të tjera	<100 0.2%	0 0.0%	<100 0.5%
Të paklasifikuara (mbushja dhe transporti i ujit, ndihma në shtëpi)	1000 2.8%	700 3.3%	300 1.9%
Numri i përgjithshëm i punëtorëve fëmijë	35 500	22 200	13 300

Në një linjë me gjetjet e mësipërme, shpërndarja sektoriale e punëtorëve fëmijë nuk ndryshon shumë nga ajo e fëmijëve që punojnë, pavarësisht seksit (tabelat 3.1 dhe 3.10). Për shembull, 77.8 për qind e djemve që punojnë dhe 83.3 për qind e vajzave që punojnë gjenden në bujqësi (tabela 3.1), krahasuar me 78.7 për qind të punëtorëve fëmijë djem dhe 86.6 për qind të punëtorëve fëmijë femra (tabela 3.10). Këto gjetje tregojnë qartë se rreziqet me të cilat përballen fëmijët në bujqësi nuk duhen anashkaluar.

Punësimi më i lartë i femrave në bujqësi gjithashtu përkthehet në një përqindje më të lartë të punëtoreve fëmijë femra krahasuar me punëtorët fëmijë meshkuj në bujqësi. Në kontrast me këtë, një përqindje më e lartë e punëtoreve fëmijë meshkuj gjendet në ndërtim, tregtinë me shumicë dhe pakicë, si edhe në hotele e restorante (shiko tabelën 3.10).

3.6.2. Profesione të ushtruara nga punëtorët fëmijë

Për sa i përket përfshirjes së tyre në punët bujqësore, shumica e punëtoreve fëmijë (80.6%) klasifikohen si punëtorë fillestarë bujqësie. Një përqindje tjetër e konsiderueshme e punëtoreve fëmijë janë punëtorët e shërbimeve dhe shitjeve (8.9%), nga të cilët gati gjysma janë punëtorë të shërbimeve personale. Punëtorët artizanë përbëjnë 3 për qind dhe punëtorët fillestarë të minierave dhe të ndërtimit përbëjnë 2.3 për qind të punëtoreve fëmijë. Si në rastin e shpërndarjes sektoriale, shpërndarjet e profesioneve të punëtoreve fëmijë dhe fëmijëve që punojnë (në punësim) janë shumë të ngjashme (tabelat 3.2 dhe 3.11), megjithëse përqindja e punëtoreve të shërbimeve dhe të shitjeve është paksa më e ulët se punëtorët fëmijë sesa të fëmijët që punojnë, ndërsa përqindja e punëtoreve fillestarë është paksa më e lartë se punëtorët fëmijë sesa të fëmijët që punojnë. Kjo do të thotë që punëtorët fillestarë përballen me rreziqe më të mëdha krahasuar me fëmijët në profesione të tjera.

Tabela 3.11. Shpërndarja e punëtoreve fëmijë sipas profesionit

Profesioni (ISCO-08)	Të gjithë	Djem	Vajza
Punëtorë të shërbimeve dhe të shitjeve	3200 8.9%	1900 8.3%	1300 9.9%
<i>Punëtorë të shërbimeve personale (518)</i>	1500 4.2%	1000 4.3%	500 4.0%
<i>Shitës në rrugë dhe në treg (521)</i>	700 1.9%	300 1.2%	400 3.2%
<i>Tjetër</i>	1000 2.8%	600 2.8%	400 2.7%
Punëtorë bujqësie të kualifikuar	200 0.6%	200 0.8%	<100 0.1%
Punëtorë artizanë	1000 3.0%	800 3.7%	200 1.8%
Operatorë makinerish në uzina, montatorë	<100 0.1%	<100 0.2%	0 0.0%
Profesione elementare	30 800 86.8%	19 000 86.0%	11 800 88.2%
<i>Punëtorë bujqësie, pylltarie, peshkimi (921)</i>	28 600 80.6%	17 300 78.0%	11 300 84.8%
<i>Punëtorë minierash dhe ndërtimi (931)</i>	800 2.3%	800 3.7%	0 0.0%
<i>Tjetër</i>	1400 3.9%	900 4.3%	500 3.4%
Numri i përgjithshëm i punëtoreve fëmijë	35 500	22 200	13 300

Shënim. Informacioni mbi profesionin është i padisponueshëm për 0.6% të të gjithë punëtoreve fëmijë dhe 1% të punëtoreve fëmijë meshkuj.

Pothuajse një përqindje e barabartë e punëtorëve fëmijë meshkuj dhe femra (respektivisht 86% dhe 88.2%) punojnë si punëtorë fillestarë. Megjithatë, përqindja e vajzave të cilat janë punëtores fillestare bujqësie është më e madhe se ajo e djemve (84.8% kundrejt 78%). Përqindja e punëtorëve fëmijë meshkuj dhe femra të punësuar si punëtorë shërbimesh dhe shitjesh është e njëjtë (8.3% e meshkujve krahasuar me 9.9% të femrave), megjithëse përqindja e vajzave të klasifikuara si shitëse në rrugë dhe në treg është paksa më e lartë sesa ajo e djemve (3.2% kundrejt 1.2%), dhe përqindja e djemve të klasifikuar si punëtorë artizanë është më e lartë sesa ajo e vajzave (3.7% kundrejt 1.8%). Përveç kësaj, 3.7% e djemve janë punëtorë fillestarë në miniera dhe ndërtim.

3.6.3. Statusi në punësim i punëtorëve fëmijë

Shumica dërrmuese e punëtorëve fëmijë (89.6%) janë të punësuar si punëtorë pa pagesë në familje, gjë që përsëri shkon paralel me gjetjen më të hershme se 89.7 për qind e fëmijëve që punojnë janë punëtorë pa pagesë në familje. Kështu, për sa i përket rreziqeve me të cilat përballen, fëmijët që punojnë si punëtorë pa pagesë në familje nuk ndryshojnë në thelb nga fëmijët që fitojnë një pagë.

Tabela 3.12. Shpërndarja e punëtorëve fëmijë sipas statusit në punësim

Statusi në punësim	Të gjithë	Djem	Vajza
Punëtor me pagë (punëmarrës)	2100 6.0%	1800 8.4%	300 2.0%
Punëtor për llogari të vet	1500 4.4%	1200 5.3%	300 2.8%
Punëtor pa pagesë në familje	31 900 89.6%	19 200 86.3%	12 700 95.2%
Numri i përgjithshëm i punëtorëve fëmijë	35 500	22 200	13 300

Shumica dërrmuese e punëtoresve fëmijë vajza (95.2%) janë të punësuar si punëtores pa pagesë në familje, ndërsa kjo përqindje është paksa më e ulët (86.3%) te punëtorët fëmijë djem (tabela 3.12). Ky ndryshim gjinor nuk është i habitshëm, duke pasur parasysh përqindjet e vajzave dhe djemve (respektivisht 93.4% dhe 87.2 %), të cilët punojnë si punëtorë pa pagesë në familje (shiko tabelën 3.7). Te fëmijët që fitojnë një rrogë, duket se djemtë rrezikojnë më shumë në punën e tyre sesa vajzat.¹⁵

3.7. Ndryshimet rajonale te fëmijët që punojnë dhe punëtorët fëmijë

Tabelat 3.12 dhe 3.13 pasqyrojnë shpërndarjen rajonale të fëmijëve që punojnë, punëtorëve fëmijë dhe të popullsisë së fëmijëve. Në një pjesë të 12 rajoneve të Shqipërisë, mbizotërimi i punësimit të fëmijëve është më i lartë sesa pritet duke u bazuar në popullsi. Për shembull, Elbasani është vendi ku jetojnë 10.7 për qind e popullsisë së fëmijëve, por 27.7 për qind e fëmijëve që punojnë. Berati, Dibra, Korça dhe Shkodra kanë gjithashtu një numër më të lartë të fëmijëve që punojnë sesa pritej, ndërsa Durrësi, Fieri, Lezha, Tirana dhe Vlora kanë shumë më pak fëmijë që punojnë sesa mund të pritej nga popullsia e fëmijëve në këto qytete. Kryeqyteti, Tirana, në të cilin jetojnë mbi një çerek i popullsisë së fëmijëve të të gjithë vendit, ka vetëm 9.3 për qind të fëmijëve që punojnë në të gjithë vendin.

¹⁵ Si rezultat i numrit të vogël të fëmijëve të punësuar si punëtorë me pagë dhe punëtorë për llogari të vet, shpërndarja e punës së fëmijëve nuk është ndarë sipas statusit të punësimit.

FËMIJËT QË PUNOJNË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Rezultatet e studimit kombëtar mbi punën e fëmijëve për vitin 2010

Tabela 3.13. Shpërndarja e fëmijëve që punojnë sipas rajonit

Rajoni	Popullsia e fëmijëve	Fëmijët që punojnë	Djemtë që punojnë	Vajzat që punojnë
Berat	37 400 5.4%	3900 7.2%	2600 8.1%	1300 5.9%
Dibër	30 600 4.4%	3500 6.5%	2200 6.8%	1300 6.1%
Durrës	67 900 9.7%	1500 2.7%	900 2.8%	600 2.6%
Elbasan	74 900 10.7%	14 900 27.7%	8700 26.9%	6200 28.9%
Fier	81 800 11.7%	4200 7.8%	2000 6.3%	2200 10.1%
Gjirokastrë	22 400 3.2%	1000 1.8%	800 2.5%	200 0.9%
Korçë	56 300 8.1%	10 300 19.2%	6200 19.2%	4100 19.2%
Kukës	17 300 2.5%	1300 2.3%	600 1.8%	700 3.1%
Lezhë	34 700 5.0%	700 1.2%	500 1.6%	200 0.7%
Shkodër	53 800 7.7%	7000 13.1%	4200 12.9%	2900 13.4%
Tiranë	175 100 25.1%	5000 9.3%	3300 10.0%	1700 8.2%
Vlorë	46,300 6.6%	600 1.1%	400 1.2%	200 1.0%
Shuma	698 600	54 000	32 400	21 600

Shpërndarja e fëmijëve që punojnë në të gjitha rajonet pasqyron ngjashmëritë midis djemve dhe vajzave. Kjo gjetje tregon se strukturat ekonomike rajonale ofrojnë mundësi të njëjta pune për të gjithë, si për djemtë, ashtu edhe vajzat. Për më tepër, shpërndarja e punëtorëve fëmijë në rajone të ndryshme ndjek shumë ngushtë shpërndarjen e fëmijëve që punojnë; kështu që rajonet me përqindje të mëdha të fëmijëve që punojnë janë gjithashtu vendi ku jetojnë përqindje të mëdha të punëtorëve fëmijë dhe ato me përqindje të vogla të fëmijëve që punojnë janë, gjithashtu, vendi ku jetojnë përqindje të vogla të punëtorëve fëmijë. Për shembull, Elbasani është vendi ku jetojnë 27.7% e fëmijëve që punojnë dhe 26% e punëtorëve fëmijë, ndërsa Tirana është vendi ku jetojnë vetëm 9.3% e fëmijëve që punojnë dhe vetëm 8.7% e punëtorëve fëmijë. Shpërndarja e punëtorëve fëmijë djem dhe vajza në rajone të ndryshme, gjithashtu, ndjek ngushtë shpërndarjen e fëmijëve që punojnë në përgjithësi (shiko tabelën 3.12).

Tabela 3.14. Shpërndarja e punëtorëve fëmijë sipas rajonit

Rajoni	Popullsia e fëmijëve	Punëtorët fëmijë	Punëtorët fëmijë djem	Punëtorët fëmijë vajza
Berat	37 400 5.4%	3100 8.8%	2000 8.9%	1100 8.8%
Dibër	30 600 4.4%	2600 7.3%	1900 8.5%	700 5.3%
Durrës	67 900 9.7%	1200 3.3%	900 3.9%	300 2.3%

FËMIJËT QË PUNOJNË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Rezultatet e studimit kombëtar mbi punën e fëmijëve për vitin 2010

Rajoni	Popullsia e fëmijëve	Punëtorët fëmijë	Punëtorët fëmijë djem	Punëtorët fëmijë vajza
Elbasan	74 900 10.7%	9200 26.0%	5400 24.6%	3800 28.2%
Fier	81 800 11.7%	2600 7.3%	1300 5.8%	1300 9.8%
Gjirokastrë	22 400 3.2%	800 2.3%	750 3.4%	<100 0.4%
Korçë	56 300 8.1%	7700 21.7%	4500 20.1%	3200 24.2%
Kukës	17 300 2.5%	900 2.5%	400 2.0%	500 3.5%
Lezhë	34 700 5.0%	700 1.9%	500 2.3%	200 1.2%
Shkodër	53 800 7.7%	3500 10.0%	2500 11.4%	1000 7.7%
Tiranë	175 100 25.1%	3100 8.7%	1900 8.6%	1200 8.8%
Vlorë	46 300 6.6%	100 0.3%	100 0.5%	0 0.0%
Shuma	698 600	35 500	22 200	13 300




Figura 3.1. Shpërndarja e punës së fëmijëve sipas rajoneve

Figura 3.1 ofron një krahasim vizual midis shpërndarjes së fëmijëve që punojnë dhe punëtorëve fëmijë sipas rajonit. Siç bëhet e qartë nga figura 3.1, rajonet që kanë përqindje të lartë të punësimit të fëmijëve priren gjithashtu të kenë edhe përqindje të larta të punëtorëve fëmijë. Megjithatë, çuditërisht në Elbasan dhe në Shkodër, dy nga rajonet ku përhapja e punës së fëmijëve është më e lartë, përqindja e punëtorëve fëmijë është më e ulët sesa pritet, duke pasur parasysh ngjashmëritë e ngushta midis punësimit të fëmijëve dhe shkallës së punës së rëndë të fëmijëve në rajonet e tjera të vendit. Pavarësisht kësaj, gjetjet në përgjithësi tregojnë se rreziqet me të cilat përballen fëmijët në punë nuk ndryshojnë shumë nga rajoni në rajon.

SEKSIONI

4

SHËNDETI, SHKOLLIMI DHE PUNËSIMI I FËMIJËVE

Punësimi i fëmijëve ngre shqetësime kryesisht për shkak të mundësisë që puna mund të rrezikojë shëndetin dhe/ose shkollimin e tyre. Përveç mbledhjes së informacionit mbi kushtet e punës së fëmijëve, Studimi mbi punën e fëmijëve mbledh informacion mbi pasojat e punës në shëndetin e fëmijëve që punojnë (gjatë vitit që parapriu studimin), me qëllim identifikimin e pasojave afatshkurtra të punës si edhe rreziqet e mundshme me të cilat përballen fëmijët. Informacioni mbi rezultatet afatshkurtra të shëndetit (domethënë sëmundje të shkaktuara nga puna dhe dëmtime të fëmijëve) dhe rreziqet e mundshme në punë, si edhe rezultatet e shkollimit të të dy grupeve, fëmijëve që punojnë atyre që nuk punojnë (të matura nga frekuentimi, klasa më e lartë e përfunduar, mosha e fillimit të shkollës, mungesat në shkollë dhe formimi profesional), u mbledhën drejtpërdrejt nga fëmijët.¹⁶ Duhet theksuar se mospërputhjet e vëzhguara në rezultatet e shkollimit të të dy grupet nuk mund t'i atribuohen menjëherë pasojave negative të punës, por, në fakt, mund të jenë rezultat i faktorëve të tjerë të cilët ndikojnë vendimet për punën dhe shkollën. Pavarësisht kësaj, është e rëndësishme të kuptojmë nëse ekziston një kombinim negativ midis punës dhe shkollimit, me qëllim që të identifikojmë grupet e fëmijëve të cilët mund të përfitojnë nga politikat e shënjestruara.

4.1. Pasojat mbi shëndetin dhe rreziqet në vendin e punës për fëmijët që punojnë

4.1.1. Pasojat mbi shëndetin e fëmijëve që punojnë dhe punëtorëve fëmijë¹⁷

Është vlerësuar se 8000 fëmijë që punonin vuanin nga një sëmundje profesionale ose dëmtim gjatë vitit që i parapriu studimit. Kjo shifër përfaqëson 13% të të gjithë fëmijëve që punojnë. Siç pasqyrohet në tabelën 4.1, ankesa më e zakonshme të fëmijët është lodhja ekstreme, e cila prek 7.2% të të gjithë fëmijëve që punojnë (8.3% të djemve dhe 5.3% të vajzave). Një grup tjetër prej 6% të fëmijëve që punojnë (5.7% e djemve dhe 6.5% vajzave) kishin pasur temperaturë; dhe 2.2% e fëmijëve që punojnë (3.1% e djemve dhe 0.8% e vajzave) kishin pësuar prerje dhe dëmtime sipërfaqësore. Sëmundje/dëmtime të tjera të shkaktuara nga puna (frakturat, tërheqjet, djegiet, problemet me lëkurën etj.) u raportuan nga më pak se 1% e fëmijëve që punojnë.

Tabela 4.1. Sëmundje/dëmtime të shkaktuara nga puna te fëmijët

Lloji i sëmundjes/i dëmtimit	Të gjithë	Djem	Vajza
Prerje/dëmtime sipërfaqësore	1400 2.2%	1200 3.1%	200 0.8%
Fraktura	<100 0.1%	<100 0.2%	0 0.0%

¹⁶ Në kontrast me informacionin e paraqitur në seksionet e mëparshme, vlerat e punës së fëmijëve në këtë seksion janë bazuar në përgjigjet e fëmijëve; kështu, vlerat e paraqitura në këtë seksion mund të ndryshojnë paksa nga ato të seksioneve të mëparshme.

¹⁷ Si rezultat i numrit të vogël të fëmijëve të cilët raportuan sëmundje/dëmtime të shkaktuara nga puna, ky seksion nuk është i ndarë sipas moshës.

FËMIJËT QË PUNOJNË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Rezultatet e studimit kombëtar mbi punën e fëmijëve për vitin 2010

Lloji i sëmundjes/i dëmtimit	Të gjithë	Djem	Vajza
Ndrydhje	400 0.6%	400 1.0%	0 0.0%
Djegje, gërryerje, morth	100 0.2%	100 0.3%	0 0.0%
Probleme me frymëmarrjen	200 0.4%	200 0.6%	0 0.0%
Probleme me lëkurën	500 0.8%	200 0.5%	300 1.1%
Probleme barku/diarre	400 0.7%	200 0.5%	200 1.0%
Temperaturë	3700 6.0%	2200 5.7%	1500 6.5%
Lodhje ekstreme	4400 7.2%	3200 8.3%	1,200 5.3%
Probleme të tjera	200 0.3%	100 0.3%	100 0.3%
Çfarëdolloj sëmundje/dëmtimi	8000 13.0%	5500 14.4%	2500 10.8%
Nr. i fëmijëve të punësuar në 12 muajt e shkuar	61 500	38 200	23 400

Shënim. Periudha e referimit për punësimin është viti që i parapriu studimit.

Figurat 4.1 dhe 4.2 pasqyrojnë problemet shëndetësore të shkaktuara nga puna te punëtorët fëmijë dhe tek ato fëmijë që punojnë, por nuk janë punëtorë fëmijë. Siç tregon krahasimi i dy figurave, punëtorët fëmijë vuajnë më shumë nga probleme shëndetësore të shkaktuara nga puna sesa fëmijët që punojnë, të cilët nuk konsiderohen punëtorë fëmijë¹⁸. Për shembull, ndërsa 18.4 për qind e punëtorëve fëmijë raportuan që kishin vuajtur nga një sëmundje ose dëmtim gjatë vitit që parapriu studimin, përqindja korresponduese tek ata fëmijë që nuk konsiderohen punëtorë fëmijë është vetëm 6 për qind.




Figura 4.1. Dëmtime/sëmundje të kaluara nga punëtorët fëmijë

¹⁸ Më shumë informacion mbi sëmundjet dhe dëmtimet e shkaktuara nga puna te punëtorët fëmijë mund të gjendet në shtojcën C, tabelat A4.1 dhe A4.2.




Figura 4.2. Dëmtime/sëmundje të kaluara nga fëmijët që punojnë, jo nga punëtorët fëmijë

Pavarësisht ndryshimeve në magnitudë, llojet e problemeve shëndetësore të shkaktuara nga puna te fëmijët që punojnë, por që nuk janë klasifikuar punëtorë fëmijë dhe tek ata që janë klasifikuar punëtorë fëmijë janë mjaft të ngjashme, ku të dy grupet e fëmijëve u ankuan më së shumti për lodhje (respektivisht, 3.7% dhe 9.9%) dhe temperaturë (respektivisht, 1.2% dhe 9.4%). Këto gjetje nuk të surprizojnë, duke pasur parasysh që orët e te zgjatura të punës formojnë një nga kriteret sipas të cilit identifikohet statusi i punës. Fëmijët që punojnë me orë të zgjatura -ndoshta edhe në kushte më të vështira- mund të ankohen më shumë për lodhje dhe temperaturë, ndaj të cilës fëmijët më të dobët janë më të ndjeshëm. Gjithashtu, punëtorët fëmijë ka më shumë gjasa të vuajnë nga dëmtime ose sëmundje të shkaktuara nga puna sesa fëmijët e tjerë që punojnë, si për shembull: frakturat, tërheqjet, djegiet, problemet me lëkurën etj.; megjithatë, me përjashtim të dëmtimeve të vogla (të raportuara nga 2.1% e punëtorëve fëmijë dhe 2.8% e fëmijëve që punojnë, por që nuk konsiderohen punëtorë fëmijë), këto probleme u raportuan nga më pak se 2 për qind e punëtorëve fëmijë.

Punëtorët fëmijë meshkuj janë më të prirë të vuajnë nga një dëmtim/sëmundje e shkaktuar nga puna sesa punëtorët fëmijë femra, me një shpërndarje, respektivisht, 19.8 për qind te djemtë dhe 15.8 për qind te vajzat. (Ndryshimi nuk është i rëndësishëm nga ana statistikore, megjithëse mund të jetë rezultat i numrit të vogël të vëzhgimeve.) Ekziston një hendek i vogël gjinor midis fëmijëve meshkuj dhe femra që punojnë, të cilët nuk konsiderohen punëtorë fëmijë (respektivisht 7.0% dhe 4.8%). Llojet e dëmtimeve/sëmundjeve të kaluara nga punëtorët fëmijë meshkuj dhe femra janë të ngjashme, ku shumica e të dy grupeve vuajnë kryesisht nga lodhja ekstreme dhe temperatura. Ndërsa për punëtorët fëmijë femra këto dy probleme pak a shumë i përmbledhin problemet e tyre të shkaktuara nga puna (përveç një grupi të vogël që ankohen për probleme me lëkurën), shumëllojshmëria e sëmundjeve/dëmtimeve të kaluara nga punëtorët fëmijë djem është më e gjerë (shih figurën 4.1).

Për më shumë se gjysmën e të gjithë fëmijëve që punojnë, të cilët raportuan një sëmundje ose dëmtim të shkaktuar nga puna gjatë vitit të mëparshëm, edhe sëmundja/dëmtimi më serioz nuk ishte aq serioz sa t'i pengonte të shkonin në shkollë apo në punë (tabela 4.2). Megjithatë, në 43.1 për qind të rasteve fëmijët nuk shkuan përkohësisht në shkollë apo në punë dhe në 4.1 për qind të rasteve ata e lanë përgjithmonë punën apo shkollën. Gjithashtu, më shumë se gjysma e punëtorëve fëmijë raportuan se nuk kishin pasur pasoja serioze si rezultat i sëmundjeve/dëmtimeve të shkaktuara nga puna (shiko tabelën 4.3). Megjithatë, 4.8 për qind e punëtorëve fëmijë raportuan një problem serioz që i pengoi ata të shkonin në punë ose të ndiqnin përgjithmonë shkollën, ndërsa asnjë nga fëmijët që punojnë, të cilët nuk janë klasifikuar si punëtorë fëmijë, nuk e raportoi një pasojë të tillë.

Tabela 4.2. Pasojat e sëmundjeve/dëmtimeve më serioze për të gjithë fëmijët që punojnë

Pasojat	Të gjithë	Djem	Vajza
Joserioze – nuk e lanë punën ose shkollën	4200 52.9%	3000 54.4%	1200 49.7%
E lanë punën ose shkollën për një periudhë të shkurtër	3400 43.1%	2200 39.7%	1200 50.3%
E lanë punën ose shkollën komplet	300 4.1%	300 5.9%	0 0.0%
Numri i të dëmtuarve në 12 muajt e shkuar	8000	5500	2500

Shënim. Periudha e referimit për punësim është viti që parapriu studimin.

Tabela 4.3. Pasojat e sëmundjeve/dëmtimeve më serioze për punëtorët fëmijë

Pasojat	Të gjithë	Djem	Vajza
Joserioze - nuk e lanë punën ose shkollën	3600 54.2%	2700 58.9%	900 43.5%
E lanë punën ose shkollën për një kohë të shkurtër	2700 41.0%	1600 34.1%	1100 56.5%
E lanë punën ose shkollën komplet	300 4.8%	300 7.0%	0 0.0%
Numri i të dëmtuarve në 12 muajt e shkuar	6700	4700	2000

Shënim. Periudha e referimit për punësim është viti që i parapriu studimit.

Janë vënë re disa ndryshime midis djemve dhe vajzave për sa i përket sëmundjeve/dëmtimeve të shkaktuara nga puna. Ndërsa sëmundja/dëmtimi më serioz nuk e pengoi shumicën e djemve apo vajzave për të ndjekur shkollën apo punën ose e pengoi vetëm përkohësisht, 5.9 për qind e të gjithë djemve që punojnë (dhe 7% e punëtorëve fëmijë meshkuj) raportuan që kishin lënë punën ose shkollën përgjithmonë. Dhe gjëja më e rëndësishme është se 80 për qind e fëmijëve që raportuan një dëmtim ose sëmundje si rezultat i punës ishin punëtorë bujqësie.

Tabela 4.4. Fëmijët që punojnë të cilët i nënshtrohen trajtimit të pafavorshëm në punë

Trajtimi	Të gjithë	Djem	Vajza
U bërtitet vazhdimisht	4100 6.7%	3000 7.9%	1100 4.7%
Fyhen në mënyrë të përsëritur	400 0.6%	100 0.3%	300 1.1%
Rrihen/dëmtohen fizikisht	1900 3.0%	1500 3.8%	400 1.8%
Tjetër	700 1.1%	400 1.0%	300 1.4%
Çdonjëra nga të mësipërmet	5000 8.2%	3500 9.1%	1500 6.8%
Numri i të punësuarve	61 500	38 200	23 400

Tabela 4.5. Punëtorët fëmijë që i nënshtrohen trajtimit të pafavorshëm në punë

Trajtimi	Të gjithë	Djem	Vajza
U bërtitet vazhdimisht	3500 9.6%	2400 10.3%	1100 8.4%
Fyhen në mënyrë të përsëritur	400 1.0%	100 0.5%	300 2.0%
Rrihen/dëmtohen fizikisht	1300 3.7%	900 3.9%	400 3.2%
Tjetër	700 1.9%	400 1.6%	300 2.6%
Çdonjëra nga të mësipërmet	4500 12.2%	2900 12.2%	1600 12.1%
Numri i të punësuarve	36 500	23 500	13 000

Për sa i përket trajtimit të tyre në punë, 8.2 për qind e të gjithë fëmijëve që punojnë raportuan se keqtrajtoheshin në punë, ku ankesat më të zakonshme ishin se atyre u bërtitej në mënyrë konstante (6.7%) ose rriheshin/dëmtoheshin fizikisht (3.0%). Shkalla e keqtrajtimit u raportua si më e lartë te punëtorët fëmijë (12.2%), megjithëse llojet e keqtrajtimit ishin të njëjta, domethënë bërtitja në mënyrë konstante (9.6%) dhe abuzimi fizikisht (3.7%). Një vështrim më nga afër i fëmijëve që raportuan abuzim fizik, nxjerr në pah faktin se ky grup është i përbërë tërësisht nga punëtorë pa pagesë në familje. Me fjalë të tjera, ka shumë gjasa që këta fëmijë rrihen nga prindërit e tyre ose nga një pjesëtar tjetër i familjes. Duke pasur parasysh faktin që nuk është e pazakontë për të rriturit ta shohin ndëshkimin fizik si mjet disiplinimi për fëmijët dhe që u “mëson” atyre të sillen “si duhet”, nuk do të ishte e çuditshme nëse do të zbulonim se keqtrajtimi në punë i raportuar nga fëmijët nuk përfaqëson ndonjë gjë shumë më ndryshe nga mënyra se si ata trajtohen jashtë pune.

Përqindjet e djemve dhe vajzave që ankohen për trajtim të pafavorshëm në punë janë mjaft të ngjashme. Për shembull, te fëmijët që punojnë, 6.8 për qind e vajzave dhe 9.1 për qind e djemve ankohen për njëfarë keqtrajtimi në punë. Te punëtorët fëmijë, shifrat korresponduese për vajzat dhe për djemtë janë respektivisht 12.1 për qind dhe 12.2 për qind. Llojet e ankesave të bëra nga vajzat dhe djemtë janë gjithashtu të njëjta, ku të dy grupet raportojnë që atyre u bërtitet dhe rrihen vazhdimisht. Një përqindje më e lartë e punëtorëve fëmijë djem, sesa e fëmijëve që punojnë, raportuan se fyheshin në mënyrë të përsëritur në punë.

Përfundimisht, për sa i përket keqtrajtimit në punë, duhet theksuar përsëri se një përqindje e konsiderueshme e fëmijëve nuk u intervistuan vetëm dhe që shumica e fëmijëve janë të punësuar nga prindërit e tyre; kështu, vlerat e përqindjeve të fëmijëve që i nënshtrohen trajtimit të pafavorshëm në punë duhen konsideruar si vlera të ulëta.

4.1.2. Rreziqet e vendit të punës për fëmijët që punojnë dhe punëtorët fëmijë

Tabela 4.6 pasqyron shpërndarjen e fëmijëve që punojnë sipas rreziqeve në vendin e punës. Rreziku më i zakonshëm që haset nga fëmijët që punojnë është pluhuri/tymrat (21.2%), ndjekur nga puna në të ftohtë ose në të nxehtë ekstrem (20.1%). Këto nuk janë gjetje të habitshme, pasi shumica e fëmijëve që punojnë, e zhvillojnë aktivitetin e punës së tyre jashtë në njësi bujqësore. Në total, afërsisht një e treta e fëmijëve që punojnë është vlerësuar se punojnë në mjedise të pafavorshme.

Llojet e rreziqeve që hasen në vendin e punës nga vajzat dhe djemtë janë mjaft të ngjashme, megjithëse përqindje më të mëdha djemsh i nënshtrohen rreziqeve që s’kanë të bëjnë me pluhurin/tymrat apo të nxehtin/të ftohtin. Për shembull, një përqindje më e madhe djemsh krahasuar me vajzat (5.4% kundrejt 1.3%) raportojnë se ngrenë pesha të rënda në punë. Fakti që një përqindje më e madhe e vajzave që punojnë raportojnë se punojnë në mjedise me pluhur/tymra dhe në të ftohtë ose të nxehtë ekstrem

mund të ketë të bëjë me vlerësimin subjektiv të rreziqeve të vendit të punës. Për shembull, nëse vajzat janë më të ndjeshme ndaj pluhurit, ka më shumë gjasa që ato të raportojnë që punojnë në rrethana të tilla. Prandaj, një pjesë e mospërputhjeve gjinore për sa i përket rreziqeve duhen konsideruar si rezultat i ndryshimeve në vlerësimin subjektiv të rreziqeve nga djemtë dhe vajzat.

Tabela 4.6. Përqindja e fëmijëve që u nënshtrohen kushteve të pafavorshme në punë

Ambienti i punës	Të gjithë	Djem	Vajza
Ngre pesha të rënda	2400 3.9%	2100 5.4%	300 1.3%
Punon me makineri/pajisje të rënda	500 0.9%	500 1.4%	0 0.0%
Pluhuri/tymrat	13 000 21.2%	7200 18.8%	5800 25.0%
Zjarri/gazi/flaka	300 0.4%	200 0.5%	100 0.2%
Zhurma e lartë ose vibracioni	2000 3.2%	1700 4.3%	300 1.3%
I ftohti ose i nxehti ekstrem	12 400 20.1%	7200 19.0%	5200 22.0%
Vegla të rrezikshme	700 1.4%	600 1.6%	100 0.9%
Punon në lartësi	200 0.2%	100 0.1%	100 0.5%
Punon në ujë/liqen/ujëmbledhës/lumë	500 0.8%	500 1.2%	0 0.0%
Vendi i punës shumë i errët ose i kufizuar	300 0.6%	300 0.9%	0 0.0%
Ajrim i pamjaftueshëm	500 0.8%	300 0.9%	200 0.8%
Lëndë kimike	1 700 2.8%	900 2.5%	800 3.3%
Eksplziv	100 0.2%	0 0.0%	100 0.5%
Tjetër	100 0.1%	100 0.2%	0 0.0%
Cilado nga të mësipërmet	20 700 33.7%	12 400 32.6%	8300 35.4%
Numri i të punësuarve	61 500	38 200	23 400

Tabela 4.7. Përqindja e punëtorëve fëmijë që u nënshtrohen kushteve të pafavorshme të punës

Ambienti i punës	Të gjithë	Djem	Vajza
Ngre pesha të rënda	2400 6.5%	2100 8.8%	300 2.3%
Punon me makineri/pajisje të rënda	500 1.4%	500 2.2%	0 0.0%
Pluhuri/tymrat	12 100 33.2%	6500 27.9%	5600 42.7%
Zjarri/gazi/flaka	300 0.7%	200 0.9%	100 0.4%

FËMIJËT QË PUNOJNË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Rezultatet e studimit kombëtar mbi punën e fëmijëve për vitin 2010

Ambienti i punës	Të gjithë	Djem	Vajza
Zhurma e lartë ose vibracioni	1900 5.3%	1600 7.0%	300 2.1%
I ftohti ose i nxehti ekstrem	12 000 32.9%	7000 29.9%	5000 38.4%
Vegla të rrezikshme	800 2.3%	600 2.6%	200 1.7%
Punon në lartësi	200 0.4%	100 0.2%	100 0.8%
Punon në ujë/liqen/ujëmbledhës/lumë	500 1.3%	500 2.0%	0 0.0%
Vendi i punës shumë i errët ose i kufizuar	400 0.9%	400 1.5%	0 0.0%
Ajrim i pamjaftueshëm	500 1.4%	300 1.4%	200 1.5%
Lënde kimike	1700 4.7%	900 4.0%	800 5.9%
Eksplziv	100 0.3%	0 0.0%	100 0.8%
Tjetër	100 0.2%	100 0.3%	0 0.0%
Cilado nga të mësipërmet	19 800 54.2%	11 800 50.3%	8000 61.3%
Numri i punëtorëve fëmijë	36 500	23 500	13 000

Duke pasur parasysh që punëtorët fëmijë janë përkufizuar pjesërisht duke u bazuar në mjedisin e punës ku punojnë, nuk është i habitshëm fakti që një përqindje më e madhe e punëtorëve fëmijë (54.2%) raportuan se përballëshin me rreziqe në vendin e punës krahasuar me të gjithë fëmijët që punojnë në përgjithësi (33.7%), (tabela 4.7). Ndërsa një e treta e fëmijëve që punojnë dhe e punëtorëve fëmijë raportuan që punonin në mjedise me pluhur/tymra dhe në të nxehtë ose të ftohtë ekstrem, 6.5 për qind e punëtorëve fëmijë raportuan se mbanin pesha të rënda në punë krahasuar me vetëm 3.8 për qind të fëmijëve që punojnë.

Punëtorët fëmijë, meshkuj dhe femra, përballen me rreziqe më të mëdha krahasuar me djemtë e vajzat që punojnë në përgjithësi. Siç u përmend më herët, ky rezultat nuk është i papritur, meqenëse përkufizimi i punës së fëmijëve përfshin rreziqet në vendin e punës. Çka është e rëndësishme të përmendet këtu është që renditja e rreziqeve për sa i përket përqindjeve të fëmijëve të prekur është e njëjtë për fëmijët që punojnë si edhe për punëtorët fëmijë, gjë që është një tregues që mjedisi i punës për të dy grupet është pothuajse i njëjtë.

4.2. Rezultatet në shkollë për fëmijët që nuk punojnë, për fëmijët që punojnë dhe për punëtorët fëmijë

4.2.1. Shkalla e frekuentimit të shkollës

Shkalla e frekuentimit ose e ndjekjes së shkollës ndryshon sipas statusit të punësimit. Te 5-17-vjeçarët, 77.5 për qind e fëmijëve që punojnë dhe 79.9 për qind e punëtorëve fëmijë u vlerësua se ndiqnin shkollën, krahasuar me 93.8 për qind të fëmijëve që nuk punojnë. Megjithatë, ka mundësi që ndryshimi i vërtetë në shkollën e frekuentimit të shkollës është i ekzagjeruar nga fakti se fëmijët që

punojnë dhe punëtorët fëmijë prirën të jenë dy ose tre vjet më të mëdhenj sesa fëmijët që nuk punojnë. Në të vërtetë, kur shkalla e frekuentimit të shkollës krahasohet sipas grup-moshave, ndryshimi midis fëmijëve që punojnë dhe atyre që nuk punojnë zvogëlohet te fëmijët e vegjël, por zmadhohet te fëmijët më të rritur.

Është vlerësuar se shkalla e frekuentimit të shkollës te 5-11-vjeçarët ka arritur 99 për qind te fëmijët që punojnë dhe punëtorët fëmijë, krahasuar me vetëm 92.5 për qind të fëmijëve që nuk punojnë. Shkalla më e ulët për fëmijët që nuk punojnë mund të shpjegohet nga dy faktorë: *së pari*, fëmijët që nuk punojnë janë më të vegjël sesa fëmijët që punojnë dhe punëtorët fëmijë prej 1.7 vjetësh dhe, *së dyti*, probleme të tilla, si: paaftësia fizike, sëmundjet dhe perceptimi prindëror për gatishmërinë e fëmijës për shkollë, të cilat mund të pengojnë ndjekjen e shkollës nga fëmijët, në të njëjtën mënyrë mund të pengojnë punësimin e tyre. Te 12-14-vjeçarët, shkalla e ndjekjes së shkollës nga fëmijët që punojnë dhe punëtorët fëmijë zbret lehtësisht në 95 për qind, ndërsa shkalla e ndjekjes së shkollës nga fëmijët që nuk punojnë rritet në 97.2 për qind. Shkalla e ndjekjes së shkollës te 15-17-vjeçarët regjistron një rënie të menjëhershme, duke zbritur në 61.9 për qind te fëmijët që punojnë, 54 për qind te punëtorët fëmijë dhe 89.1 për qind te fëmijët që nuk punojnë. Kështu, ndryshimi në shkallën e frekuentimit të shkollës midis 12-14-vjeçarëve dhe 15-17-vjeçarëve është 8.1 pikë te fëmijët që nuk punojnë, ndërsa shifra korresponduese te fëmijët që punojnë dhe punëtorët fëmijë është respektivisht 33.5 dhe 41.2 pikë. Koha e rënies së pjesëmarrjes përkon me fundin e arsimit të detyruar.

Përqindjet e përmendura me sipër për fëmijët më të rritur sugjerojnë se ekziston një kombinim negativ midis frekuentimit të shkollës dhe punësimit. Kur fëmijët rriten dhe e kalojnë moshën për arsimin e detyruar, bie edhe pjesëmarrja e tyre në shkollë; megjithatë, kjo rënie është më e dukshme për fëmijët që punojnë dhe punëtorët fëmijë, sesa për fëmijët që nuk punojnë. Siç tregohet në tabelën 4.7, në krahasim me fëmijët që nuk punojnë, fëmijët që punojnë pësojnë një rënie më të madhe prej 25 pikësh në pjesëmarrjen në shkollë (33.5% krahasuar me 8.1%), dhe punëtorët fëmijë një rënie më të madhe prej 35 pikësh (41.2% krahasuar me 8.1%). Megjithëse është tunduese t'ia atribuosh këto ndryshime efektit të punësimit, fakti që të dyja, puna dhe shkolla, janë çështje përzgjedhjeje e komplikon analizën dhe ngjashmëritë në shkallën e frekuentimit të shkollës te fëmijët më të vegjël, pavarësisht statusit të punës që ata kanë, çka hedh dyshime të mëtejshme mbi efektet rastësore të punës mbi pjesëmarrjen në shkollë (tabela 4.8).

Fakti që punëtorët fëmijë pësojnë një rënie më të madhe të pjesëmarrjes në shkollë prej 7.7 pikësh krahasuar me fëmijët që punojnë, mund të interpretohet si efekti negativ i punës së rrezikshme në shkollimin e fëmijëve. Në fakt, ky vlerësim ka mundësi ta ekzagjerojë efektin e punës së rrezikshme në shkollimin e fëmijëve, meqenëse përkufizimi i punës së fëmijëve përfshin orët e punës, që në vetvete është një përzgjedhje e ndryshueshme. Me fjalë të tjera, faktori ose faktorët të cilët bëjnë që fëmijët të punojnë me orë më të gjata mund të jetë burimi i asociimit negativ të shkollës me punën.

Tabela 4.8. Frekuentimi i shkollës nga fëmijët që punojnë dhe fëmijët që nuk punojnë sipas moshës

Ndjekja e shkollës	Mosha 5-17	Mosha 5-11	Mosha 12-14	Mosha 15-17
Fëmijët që punojnë	45 000 77.5%	8 500 98.8%	16 800 95.4%	19 700 61.9%
Punëtorët fëmijë	29 200 79.9%	8 500 98.8%	13 000 95.2%	7 700 54.0%
Fëmijët që nuk punojnë	594 300 93.8%	319 900 92.5%	141 900 97.2%	132 500 89.1%

Tabela 4.9. Shkalla e frekuentimit të shkollës nga fëmijët që punojnë dhe ata që nuk punojnë sipas moshës dhe seksit

	Mosha 5-17		Mosha 5-11		Mosha 12-14		Mosha 15-17	
Ndjekja e shkollës	Djem	Vajza	Djem	Vajza	Djem	Vajza	Djem	Vajza
Fëmijët që punojnë	28 400 79.9%	16 600 73.7%	5500 100%	3000 96.5%	10 100 94.8%	6700 96.3%	12 700 65.9%	7000 55.8%
Punëtorët fëmijë	18 600 79.2%	10 600 81.3%	5500 100%	3000 96.5%	7900 95.3%	5100 95.2%	5100 53.4%	2600 55.3%
Fëmijët që nuk punojnë	300 500 93.2%	293 800 92.3%	169 400 92%	150 500 93.1%	67 300 97.6%	74 600 96.7%	63 700 92.1%	68 800 86.4%

Shkalla e regjistrimit në shkollë të djemve dhe të vajzave që janë të punësuar është shumë larg asaj të palës tjetër, domethënë të fëmijëve që nuk punojnë, veçanërisht në moshat përtej arsimit të detyruar (tabela 4.9). Ndërsa hendeuku i frekuentimit të shkollës midis djemve që punojnë dhe atyre që nuk punojnë të moshave 12-14 vjeç është në masën e 2.8 pikëve, ky hendek rritet në 26.2 pikë te djemtë që punojnë të moshës 15-17 vjeç. Shifrat korresponduese të vajzat janë respektivisht 0.4 pikë dhe 30.6 pikë.

4.2.2. Mosha e fillimit të shkollës

Shumica e fëmijëve raportuan si moshë të fillimit të arsimit bazë të detyruar moshën 6 vjeç (tabela 4.9). Ka një ndryshim shumë të vogël në moshën e fillimit të shkollës nga fëmijët që nuk punojnë, fëmijët që punojnë dhe punëtorët fëmijë. Ndërsa 72.8 për qind e fëmijëve që nuk punojnë e filluan arsimin bazë në moshën 6 vjeç ose edhe më të vegjël, shifrat korresponduese për fëmijët që punojnë dhe punëtorët fëmijë janë respektivisht 71.9 për qind dhe 73.7 për qind (tabela 4.10). Në të njëjtën mënyrë, ndërsa 27.2 për qind e fëmijëve që nuk punojnë e filluan shkollën në moshën 7 vjeç ose më vonë, shifrat korresponduese për fëmijët që punojnë dhe punëtorët fëmijë janë respektivisht 28.1 për qind dhe 26.3 për qind. Kështu, në tërësi, mosha mesatare e fillimit të shkollës nga fëmijët është 6.3 vjeç, pavarësisht statusit të punës.

Tabela 4.10. (Arsimi bazë) mosha e fillimit të shkollës sipas statusit të punës

Mosha e fillimit të shkollës	Fëmijët që nuk punojnë	Fëmijët që punojnë	Punëtorët fëmijë
5 vjeç ose më të vegjël	3600 0.6%	900 1.6%	700 1.8%
6 vjeç	398 600 72.2%	40 300 70.3%	25 800 71.9%
7 vjeç	145 900 26.4%	15 600 27.1%	9000 25.1%
8 vjeç	3400 0.6%	400 0.7%	300 0.9%
Më i madh se 8 vjeç	1000 0.2%	100 0.3%	100 0.3%
Numri i përgjithshëm i fëmijëve të regjistruar ndonjëherë në arsimin bazë	552 400	57 300	35 900

Këto gjetje gjithashtu hedhin dritë mbi gjetjet më të hershme të klasë për moshë (të diskutuara në seksionin 2) dhe konfirmojnë supozimin e mëparshëm se ndërsa një grup i vogël fëmijësh (27.3%), në fakt, e fillojnë arsimin bazë të detyruar më vonë sesa moshë 6 vjeç, shumica (72%) e fillojnë në moshën 6 vjeç.

4.2.3. Klasa më e lartë e përfunduar

Siç u theksua më lart, rezultatet e shkollimit të fëmijëve që punojnë dhe të atyre që nuk punojnë divergjojnë kryesisht përtej moshës së arsimit të detyruar. Tabela 4.11 krahason klasën (vitin) aktuale të 17-vjeçarëve që punojnë, të atyre që nuk punojnë dhe të punëtorëve fëmijë të cilët vazhdojnë të ndjekin shkollën¹⁹, ndërsa tabela 4.12 krahason klasën më të lartë të kryer nga 17-vjeçarët që kanë lënë shkollën sipas statusit aktual të punës.

Tabela 4.11. Klasa aktuale e fëmijëve 17-vjeçarë që ndjekin shkollën sipas statusit të punësimit

Klasa aktuale	Fëmijët që nuk punojnë	Fëmijët që punojnë	Punëtorët fëmijë
Arsimi i detyruar, klasa e 7-të	0 0.0%	<100 0.8%	0 0.0%
Arsimi i detyruar, klasa e 8-të	100 0.3%	<100 0.7%	0 0.0%
Arsimi i detyruar, klasa e 9-të	600 1.5%	100 2.6%	0 0.0%
Shkolla e mesme, viti i parë	3100 8.5%	400 8.3%	400 21.5%
Shkolla e mesme, viti i dytë	2900 8.1%	600 10.8%	100 5.7%
Shkolla e mesme, viti i tretë	24 900 68.2%	3600 68.8%	1000 61.1%
Shkolla e mesme, viti i katërt	4900 13.4%	400 8.0%	200 11.8%
Fëmijë të moshës 17-vjeçare në shkollë	36 400	5200	1700

Shumica e fëmijëve 17-vjeçarë që ndjekin shkollën janë në klasën e tretë të shkollës së mesme. Kjo është e vërtetë për fëmijët që nuk punojnë si dhe për fëmijët që punojnë e punëtorët fëmijë (tabela 4.11). Ajo çka i dallon fëmijët që nuk punojnë nga të tjerët është që përqindja e fëmijëve që nuk punojnë (18.2%), të cilët ndjekin klasat më të ulëta, është më e vogël sesa ajo e fëmijëve që punojnë (23.2%) dhe e punëtorëve fëmijë (25.7%), ndërsa përqindja e fëmijëve që nuk punojnë (13.4%), të cilët ndjekin klasat më të larta (klasën e katërt në shkollën e mesme), është më e madhe sesa ajo e fëmijëve që punojnë (8.0%) dhe e punëtorëve fëmijë (11.2%). Duke pasur parasysh që nuk ekziston ndonjë ndryshim në moshën e fillimit të shkollës midis fëmijëve që nuk punojnë, atyre që punojnë dhe punëtorëve fëmijë, këto gjetje tregojnë se përsëritja e klasës është më e zakonshme te fëmijët që punojnë dhe te punëtorët fëmijë, sesa te fëmijët që nuk punojnë.

¹⁹ Punëtorët fëmijë, të cilët janë aktualisht në shkollë, janë të kufizuar në 17 vëzhgime. Për shkak të këtij kampioni të vogël, vlerat mund të mos jenë të sakta.

Tabela 4.12. Klasa më e lartë shkollore e përfunduar nga 17-vjeçarët që kanë braktisur shkollën sipas statusit të punësimit

Klasa më e lartë e përfunduar	Fëmijët që nuk punojnë	Fëmijët që punojnë	Punëtorët fëmijë
Arsimi i detyruar më pak se klasa e 6-të	300 4.1%	<100 0.8%	0 0.0%
Arsimi i detyruar, klasa e 6-të	200 4.0%	0 0.0%	0 0.0%
Arsimi i detyruar, klasa e 7-të	<100 0.9%	200 3.3%	200 4.8%
Arsimi i detyruar, klasa e 8-të	4700 76.8%	5000 73.3%	2300 66.6%
Arsimi i detyruar, klasa e 9-të	400 7.0%	1300 19.9%	900 24.4%
Shkolla e mesme, viti i parë	200 2.6%	100 2.1%	100 4.2%
Shkolla e mesme, viti i dytë	200 3.8%	0 0.0%	0 0.0%
Shkolla e mesme, viti i tretë	<100 0.8%	<100 0.6%	0 0.0%
Fëmijët 17-vjeçare që nuk ndjekin shkollën	6200	6800	3500

Kur krahasohen braktisjet e shkollës, përqindje më të mëdha të fëmijëve që punojnë (96.5%) dhe punëtorëve fëmijë (95.8%) sesa të fëmijëve që nuk punojnë (84.7%), raportojnë se niveli i tyre më i lartë i shkollimit është klasa e tetë ose e nëntë e arsimit bazë (tabela 4.12).²⁰ Në krahasim me këtë, një përqindje më e madhe e fëmijëve që nuk punojnë sesa e fëmijëve që punojnë dhe e punëtorëve fëmijë përfunduan nivele klasash përtej arsimit të detyruar, dhe një përqindje më e madhe e tyre gjithashtu përfunduan nivele klasash nën ato të arsimit të detyruar (klasës së 8-të ose të 9-të) para se të braktisnin shkollën. Këto gjetje tregojnë se ndërsa shumica e fëmijëve që punojnë dhe e punëtorëve fëmijë e përfundojnë arsimin bazë të detyruar, shumë pak prej tyre vazhdojnë drejt shkollës së mesme para se të braktisin sistemin arsimor. Në rastin e fëmijëve që nuk punojnë, përqindja e konsiderueshme e fëmijëve që lënë shkollën para ose pas përfundimit të ndonjë viti përtej arsimit të detyruar (në vend të braktisjes së menjëhershme pas përfundimit të arsimit të detyruar) do të thotë që ngjarje të papritura ose ndonjë ndryshim rrethanash ndikuan në zgjedhjet e tyre për shkollim. Në kontrast me këtë, për fëmijët që punojnë dhe punëtorët fëmijë, vendimi për të mos vazhduar shkollën përtej asaj që kërkohet ligjërisht duket si një vendim i marrë shumë kohë para diplomimit.

4.2.4. Mungesa në shkollë

Te fëmijët që ndjekin shkollën, 5.7 për qind raportuan se kishin munguar në shkollë gjatë javës së referimit. Kjo përqindje shkon në 10.6 te fëmijët që punojnë dhe në 12.1 për qind te punëtorët fëmijë. Pavarësisht nga fakti se duket sikur mungojnë në shkollë përqindje më të mëdha të fëmijëve që punojnë dhe punëtorëve fëmijë krahasuar me fëmijët që nuk punojnë, numri i ditëve që ata kanë humbur është paksa më i ulët për fëmijët që punojnë dhe punëtorët fëmijë (1.6 ditë) krahasuar me fëmijët që nuk punojnë (1.9 ditë).

²⁰ Siç theksohet më herët në këtë tekst, fëmijët e moshës 17-vjeçare në kohën e studimit duhet t'i jenë nënshtruar ligjit të vjetër të arsimit të detyruar, i cili u kërkonte atyre të përfundonin vetëm 8 vite shkollë të detyruar. Ata që raportuan se kishin përfunduar 9 vite të arsimit të detyruar ka shumë mundësi që filluan shkollën më vonë dhe si rezultat i përsëritjes së klasës iu nënshtruan ligjit të ri që kërkon 9 vite të arsimit të detyruar.

Djemtë priren të mungojnë në shkollë më shumë sesa vajzat, megjithëse dallimi gjinor është më i vogël te fëmijët që punojnë, sesa te fëmijët që nuk punojnë. Te fëmijët që nuk punojnë, 5.9 për qind e djemve dhe 4.8 për qind e vajzave munguan në shkollë gjatë javës së referimit, ndërsa shifrat korresponduese te djemtë dhe vajzat që punojnë janë respektivisht 10.8 për qind dhe 10.1 për qind. Për sa i përket ditëve të humbura në shkollë, mesatarja në javë për djemtë dhe vajzat që nuk punojnë është respektivisht 1.9 ditë dhe 2 ditë, krahasuar me 1.6 ditë dhe 1.7 ditë, respektivisht për djemtë e vajzat që punojnë.




Figura 4.3. Përqindja e fëmijëve që mungojnë në shkollë me arsye

Mbi treçereku i fëmijëve që nuk punojnë, raportuan se mungesat në shkollë vinin si rezultat i sëmundjes/dëmtimit/paafhtësisë (figura 4.3). Në krahasim me këtë, 67.4 për qind e fëmijëve që punojnë dhe 75 për qind e punëtorëve fëmijë raportuan që kishin munguar në shkollë si rezultat i angazhimit në shërbime të papaguara në familje, ndërsa më pak se një e treta e fëmijëve që punojnë dhe e punëtorëve fëmijë raportuan që kishin munguar në shkollë si rezultat i sëmundjes/dëmtimit/paafhtësisë. Për më tepër, më pak se 10 për qind e të gjithë fëmijëve raportuan se mungesat e tyre ishin rezultat i faktorëve të jashtëm, si p.sh.: kushtet e këqija të motit, mungesa e mësuesve ose pushimet e shkollës. Fakti që një përqindje më e madhe e fëmijëve që nuk punojnë mungojnë në shkollë si rezultat i problemeve shëndetësore shpjegon gjithashtu arsyen pse mungesat e tyre janë më të rralla, por zgjasin më shumë sesa ato të fëmijëve që punojnë dhe të punëtorëve fëmijë.

4.2.5. Formimi profesional

Përqindja e fëmijëve që aktualisht po ndjekin ose që kanë ndjekur më përpara një program trajnimi jashtë shkollës është e kufizuar në 4.4 për qind të 10-17-vjeçarëve. Kjo shifër është paksa më e lartë te fëmijët që aktualisht ndjekin shkollën (4.6%) sesa te fëmijët që kanë lënë shkollën (2.1%). U pa që fëmijët që nuk kishin shkuar kurrë në shkollë, nuk kishin ndjekur ndonjë program trajnimi. Këto gjetje tregojnë se faktorët që rrisin mundësinë që fëmijët të ndjekin shkollën, gjithashtu rrisin mundësinë që ata të ndjekin edhe formimin profesional. Pavarësisht nga ky vëzhgim, shkalla e ulët e ndjekjes së programeve të formimit profesional ka nevojë për investigim. Të kuptuarit nëse pjesëmarrja e ulët në programet e formimit profesional është rezultat i kërkesës së ulët apo ofertës së kufizuar do të na ndihmonte për të bërë ndryshime në këto programe, në mënyrë që ato të bëhen një mjet nëpërmjet të cilit fëmijët të përfitojnë një profesion. Për më tepër, programet e drejtuara veçanërisht për fëmijët më të rritur, të cilët kanë lënë shkollën, mund të lehtësonin kalimin e tyre në tregun e punës.

KONKLUZION

Qëllimi i këtij raporti përshkruan ishte paraqitja e rezultateve të *Studimit kombëtar mbi punën e fëmijëve* (SPF) për vitin 2010, i cili u krye nga Instituti i Statistikave (INSTAT) i Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me ILO/IPEC. Rezultatet e studimit tregojnë se mbizotërimi i punës te fëmijët e moshës 5-17 vjeç është 7.7 për qind. Punësimi ka tendencën e rritjes me rritjen e moshës: ndërsa përhapja e punësimit është 2.4 për qind te 5-11-vjeçarët, ajo rritet në 9.4 për qind te 12-14- vjeçarët dhe më tej deri në 16.8 për qind te 15-17-vjeçarët. Kur përdoret një kornizë kohore më e gjatë për të matur punësimin (një vit krahasuar me një javë), raporti i punësimit te 5-17-vjeçarët rritet me 1.8 pikë (ose 23%), nga 7.7 për qind në 9.5 për qind. Mesatarisht, fëmijët që punojnë harxhojnë 18.7 orë në javë në punë.

Në varësi të kornizës kohore që përdoret për të matur punësimin, përhapja e punës prirret të jetë tre deri në katër pikë më e lartë te djemtë sesa te vajzat. Edhe koha mesatare e harxhuar në punë për djemtë që punojnë është më e lartë sesa ajo e vajzave me rreth 2 orë në javë. Në krahasim me këtë, përqindja e vajzave të angazhuara në shërbime të papaguara në familje (SHPF) është më e lartë sesa ajo e djemve (49.8% kundrejt 32.5%) dhe ndërsa fëmijët në përgjithësi harxhojnë rreth 7.2 orë në javë për SHPF, vajzat harxhojnë rreth 2.5 orë më shumë në javë për SHPF sesa djemtë.

Frekuentimi i shkollës në Shqipëri është i lartë. Shkalla e ndjekjes së shkollës te 5-17-vjeçarët është 90.2 për qind dhe kjo rritet në 94.7 për qind te fëmijët e moshës së arsimit të detyruar (6-15 vjeç). Megjithatë, ka rënie të ndjeshme në frekuentim përtej 9 viteve të arsimit të detyruar, ku shkalla e frekuentimit të shkollës nga 16 dhe 17-vjeçarët është vlerësuar të jetë, respektivisht, vetëm 81.1 për qind dhe 75.2 për qind. Nuk janë vënë re ndryshime të dukshme në shkollim midis vajzave dhe djemve.

Modelet e përdorimit të kohës tregojnë që, në mosha të reja, fëmijët kanë tendencën të ndjekin vetëm shkollën, pa e kombinuar atë me aktivitete të tjera si punësimi apo SHPF. Ky model i përdorimit të kohës është vënë re te shumica e 5-11-vjeçarëve që ndjekin shkollën (72.2%). Në krahasim me këtë, modeli i përdorimit të kohës që haset më shpesh te fëmijët më të rritur është ai që kombinon shkollimin me shërbimet e papaguara në familje (48.6% e 12-14-vjeçarëve dhe 50.4% e 15-17-vjeçarëve). Është më pak e zakonshme të gesh fëmijë të çfarëdo moshe që kombinojnë shkollën me punën apo që angazhohen në të tre aktivitetet (shkollë, punë, SHPF) dhe shumë rrallë mund të gesh fëmijë që angazhohen ekskluzivisht në aktivitet ekonomik (0.2% e 12-14-vjeçarëve dhe 1.9% e 15-17-vjeçarëve).

Te fëmijët që punojnë, shumica (80%) janë të angazhuar në aktivitete bujqësore dhe punojnë pothuajse ekskluzivisht si punëtorë të papaguar në familje në njësitë bujqësore të familjeve të tyre (97%). Aktiviteti ekonomik, i dyti për nga madhësia, që ka punësuar 8.2 për qind të fëmijëve që punojnë, është tregtia me shumicë dhe pakicë, e ndjekur nga puna në hotele dhe restorante (4.1%). Edhe në këto aktivitete, mbi 70 për qind e fëmijëve punojnë si punëtorë të papaguar në familje. Në fakt, përqindja e fëmijëve që punojnë me pagë është e kufizuar në 5.6 për qind dhe përbëhet nga punëtorët e shitjeve/shërbimeve (31%), artizanë (25.8%), punëtore fillestarë (33.6%) dhe teknikë (9.7%).

Bazuar në kushtet e tyre të punës dhe natyrës së punës që bëjnë, 5.1 për qind e 5-17-vjeçarëve, ose 65.8 për qind e të gjithë fëmijëve që punojnë, janë vlerësuar si punëtorë fëmijë. Ajo çfarë i dallon fëmijët që punojnë nga punëtorët fëmijë nuk është industria apo profesioni në të cilin ata janë të angazhuar -shumë pak prej tyre janë të përfshirë në aktivitete apo profesione që kërkojnë heqjen e tyre të menjëhershme- por janë kushtet e tyre të punës, duke përfshirë edhe orët e punës. Fëmijët që punojnë, por janë nën moshë -që do të thotë fëmijë 5-13-vjeçarë të cilët ndalohen nga legjislacioni kombëtar për të punuar qoftë edhe një orë në javë- gjithashtu përbëjnë një përqindje të konsiderueshme (28.5%) të punëtorëve fëmijë.

Termi “punëtorë fëmijë” përshkruan një grup fëmijësh që punojnë, të cilët duhet të hiqen menjëherë nga puna si rezultat i rreziqeve të mundshme që ata hasin në punë. Fakti që shumica e këtyre fëmijëve punojnë si punëtorë të papaguar në familje, në bizneset familjare dhe jo në një punë që është në vetvete e dëmshme, por në kushte të pafavorshme, përbën një sfidë për politikëbërësit. Një pjesë e kësaj sfide përfshin gjetjen e mënyrave për të përmirësuar kushtet e punës, veçanërisht në bujqësi, kurse një pjesë tjetër e rëndësishme është që të bindin prindërit që puna mund të ketë një efekt të dëmshëm te fëmijët e vegjë. Të dyja këto detyra kërkojnë rritjen e ndërgjegjësimit dhe krijimin e udhëzuesve praktikë për të ndihmuar përmirësimin e mjediseve të punës për fëmijët. Fatmirësisht, shkalla e lartë e arsimimit të popullsisë së rritur si edhe shkalla e lartë e frekuentimit të shkollës nga fëmijët ofrojnë mundësi të mëdha për shpërndarjen e informacionit mbi efektet e dëmshme të punës së fëmijëve dhe si të mbrohem nga rreziqet në vendin e punës. Arsimi mund të ofrohet jo vetëm nëpërmjet trajnimit formal në shkollë, por edhe nëpërmjet shpërndarjes së materialeve të printuara në familjet e fëmijëve që konsiderohen se janë në rrezik.

Bazuar në të dhënat e studimit, 13 për qind e fëmijëve që punojnë dhe 18.4 për qind e punëtorëve fëmijë u vlerësua se kishin vuajtur nga një sëmundje apo dëmtim i shkaktuar nga puna një vit para studimit, me një përqindje djemsh që e kalonte atë të vajzave për sa i përket problemeve shëndetësore të shkaktuara nga puna. Problemet më të zakonshme shëndetësore të regjistruara për fëmijët që punojnë dhe punëtorët fëmijë ishin lodhja ekstreme dhe temperatura. Në përgjithësi, rreth 33.7 për qind e fëmijëve që punojnë dhe 54.2 për qind e punëtorëve fëmijë u vlerësua se punonin në kushte të pafavorshme. Ndër këto, më të zakonshmet ishin puna në të ftohtë ose në të nxehtë ekstrem dhe në mjedise me pluhur/tymra. Për më tepër, 8.2 për qind e fëmijëve që punojnë dhe 12.2 për qind e punëtorëve fëmijë u ankuan për trajtim të pafavorshëm në punë, kryesisht në formën e të bërtiturës dhe të rrahjes. Fëmijët që u ankuan për abuzim fizik ishin ekskluzivisht punëtorë të papaguar në familje, gjë që tregon se këta fëmijë ka mundësi që të trajtohen keq nga prindërit e tyre apo nga anëtarë të tjerë të familjes.

Krahasimi i rezultateve shkollore të fëmijëve që punojnë dhe të atyre që nuk punojnë zbuloi se në moshën 17-vjeçare, fëmijët që punojnë kanë përfunduar 4 vjet më pak shkollë sesa fëmijët që nuk punojnë. Një fëmijë tipik që punon përfundon arsimin e detyruar, por nuk vazhdon më tej në shkollën e mesme. Në përgjithësi, puna dhe shkollimi pas arsimimit të detyruar nuk janë të pajtueshme: vetëm 61.9 për qind e fëmijëve që punojnë dhe 54 për qind e punëtorëve fëmijë ndjekin shkollën, krahasuar me 89.1 për qind të fëmijëve që nuk punojnë. Duke gjykuar sipas klasës për moshë, fëmijët që punojnë dhe në veçanti punëtorët fëmijë ka më shumë gjasa të përsërisin një klasë sesa fëmijët që nuk punojnë. Ata, gjithashtu, mungojnë në shkollë më shpesh sesa fëmijët që nuk punojnë, megjithëse mungesat e tyre, në çfarëdo jave, janë më të shkurtra sesa ato të fëmijëve që nuk punojnë.

Pavarësisht faktit se të gjitha këto gjetje sugjerojnë se fëmijët që punojnë mbeten prapa fëmijëve që nuk punojnë për sa i përket rezultateve në shkollë, kjo nuk duhet interpretuar si diçka që nënkupton një efekt negativ të punës mbi shkollimin: siç u diskutua më herët, mund të jetë e mundur që faktorë të përbashkët themelorë i çojnë fëmijët drejt angazhimit në punë dhe braktisjes së shkollës.

Gjithashtu është e rëndësishme të theksojmë se programet e trajnimit profesional janë shumë pak të pranishme në sektorin arsimor në Shqipëri. Fuqizimi i programeve të tilla mund të ofrojë një mjet të dobishëm për tërheqjen në sistemin arsimor të një përqindjeje më të lartë të fëmijëve që punojnë dhe mund t'i pajisë ato me aftësi të vlefshme për tregun e punës. Kjo kërkon që të kuptohen arsyet se përse programet e formimit profesional ndiqen kaq pak. Për më tepër, duke pasur parasysh natyrën agrare të vendit tonë dhe mundësitë e kufizuara për punë, është e pritshme që emigrimi aktual ekonomik i të rinjve drejt vendeve më të pasura europiane do të vazhdojë. Kështu, në hartimin e programeve të trajnimit, duhen bërë përpjekje për të siguruar që kualifikimet që përftojnë fëmijët nëpërmjet programeve të tilla të certifikohen dhe të jenë të transferueshme përtej kufijve, domethënë të njihen në vendet e destinacionit. Harmonizimi i sektorit të arsimit shqiptar me atë të BE-së (ku Shqipëria aplikoi zyrtarisht për anëtarësim në vitin 2009) jo vetëm duhet ta vendosë Shqipërinë më afër me vendet e tjera anëtare të BE-së për sa i përket sistemit shkollor, por duhet të rrisë edhe mundësitë e punësimit për rininë shqiptare, ndërsa ata fitojnë akses më të gjerë në tregun e punës së BE-së.

REFERENCAT

OUB (Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë), FAO (2010), *Statistikat e Vendlit: Shqipëria*. www.fao.org.

Orazem, P. dhe King, E. (2008) “Shkollimi në vendet në zhvillim: Rolet e Ofertës, Kërkesës dhe Politika e Qeverisë” në J. Strauss dhe D. Thomas (eds.) *Manuali i Ekonomisë së Zhvillimit*, Vol. 4, Elsevier, f. 3475-3559.

PNUD (UNDP) (2010a), *Raporti Kombëtar i Zhvillimit Njerëzor: Shqipëria 2010*. www.undp.org.al

PNUD (UNDP) (2010b), *Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2010. Pasuria e Vërtetë e Kombeve: Rrugët drejt Zhvillimit Njerëzor*.

Banka Botërore (2010a), Të dhëna dhe Statistika për Shqipërinë , www.worldbank.org.al

Banka Botërore (2010b), *Raporti i Zhvillimit të Botës: Zhvillimi dhe Ndryshimi Klimaterik*, Washington DC.

Shtojca : Konceptet dhe përkufizimet

Fëmijë: Në përputhje me Konventën e KB “Mbi të drejtat e fëmijëve” (KDF) e vitit 1989 dhe me Konventën e ILO-s, Nr. 182, “*Mbi format më të këqija të punës së fëmijëve*”, e vitit 1999, një fëmijë përcaktohet si një individ nën moshën 18-vjeç. Meqenëse është rënë dakord nga të gjithë se një fëmijë nën moshën 5-vjeçare është tepër i vogël për t’u angazhuar në punë ose për të filluar shkollën, SPF-ja analizon vetëm fëmijët e moshës 5-17 vjeç.

Fëmijë në punësim (fëmijë që punojnë): Fëmijët (mosha 5-17 vjeç) përcaktohen si fëmijë që punojnë (ose të punësuar), nëse ata punonin për të paktën një orë gjatë periudhës së referimit ose nëse ata kishin një punë apo biznes nga i cili ishin shkëputur përkohësisht. Sistemi i Llogarive Kombëtare (SLLK) i OKB-së përcakton çfarë është dhe çfarë nuk është aktivitet ekonomik. Po të flasim në përgjithësi, të gjitha aktivitetet e orientuara drejt tregut, prodhimi për konsumim vetjak dhe shërbime të caktuara të kryera për/dhe nga anëtarët e familjes (si p.sh.: riparime të mëdha në shtëpi, mbushja dhe transporti i ujit apo siguri i druve të zjarrit për përdorim familjar) konsiderohen aktivitete ekonomike, dhe ata që janë të përfshirë në këto aktivitete ekonomike konsiderohen të punësuar.

Punëtorë fëmijë: Punëtorë fëmijë në Shqipëri përkufizohen fëmijët që janë të angazhuar në punë të papërshtatshme për kapacitetin e tyre si fëmijë apo në punë që mund të rrezikojnë shëndetin, arsimin apo zhvillimin e tyre moral. Përkufizimi kombëtar është bazuar në Konventën e ONP-së, Nr. 138, “Mbi moshën minimale” (1973) dhe në Konventën e ILO-s, Nr. 182, “*Mbi format më të këqija të punës së fëmijëve*”. Mosha minimale për punësim në Shqipëri është 16 vjeç; megjithatë, fëmijët e moshave 14 deri 15 vjeç mund të punojnë gjatë pushimeve shkollore me kusht që ky punësim të mos ndikojë negativisht në zhvillimin e tyre (Kodi shqiptar i punës, Neni 98). Pavarësisht moshës së tyre, fëmijët nuk lejohen të fillojnë punë të rrezikshme, që përfshijnë format më të këqija të pakushtëzuara të punës së fëmijëve (p.sh. prostitucioni dhe pornografia, skllavëria dhe puna në kushte skllavërie, të dërguarit ushtar dhe përfshirja në aktivitete ilegale) ose çfarëdolloj pune tjetër që mund të jetë e dëmshme për zhvillimin fizik, shoqëror apo psikologjik të fëmijës (Kodi shqiptar i punës, Neni 100), siç përcaktohet me hollësi nga qeveria shqiptare (shih shtojcën B). Kështu, termi “punëtor fëmijë” përfshin:

- i) Fëmijët e punësuar në industritë e rrezikshme, duke përfshirë minierat, guroret dhe ndërtimin.
- ii) Fëmijët e punësuar në profesione të rrezikshme, duke përfshirë, por jo vetëm, punën në miniera dhe nëntokë; punën në aviacionin civil; punën në fermentim në industrinë e prodhimit të duhanit dhe cigares; punën në fabrikat e pasurimit të bakrit, kromit dhe qymyrit; dhe punën me rrezatim jonizimi në fushën e kujdesit shëndetësor. (Për një listë të plotë të profesioneve të rrezikshme, shih Shtojcën B.)
- iii) Fëmijët që punojnë në kushte të rrezikshme, të cilat përfshijnë mbajtjen e peshave të rënda, punën me çfarëdolloj makinerie/pajisje të rëndë, ekspozimi ndaj kushteve të këqija, si: pluhuri/tymrat, zjarri/gazi/flakët ose zhurma e lartë etj., si edhe fëmijët që abuzohen verbalisht apo fizikisht në punë
- iv) Fëmijët e moshës 5-13-vjeçare që janë të punësuar (edhe vetëm për një orë në javë);
- v) Fëmijët e moshës 14-15-vjeçare që punojnë më shumë se 14 orë në javë;
- vi) Fëmijët e moshës 16-17-vjeçare që punojnë më shumë se 48 orë në javë.

Aktiviteti ekonomik: Përfshin të gjitha llojet e njësive apo bizneseve, në të cilat janë angazhuar individët në prodhimin dhe/ose shpërndarjen e mallrave dhe shërbimeve. Në këtë studim është përdorur sistemi kombëtar i klasifikimit të industrive.

Familje/shtëpi: Familja është përcaktuar si një person ose grup personash të cilët jetojnë së bashku në të njëjtën shtëpi apo kompleks, ndajnë të njëjtin organizim shtëpie dhe konsiderohen si një njësi. Anëtarët e kësaj njësie nuk janë domosdoshmërisht të lidhur (të kenë lidhje gjaku apo martesore), dhe jo të gjithë ato që janë të lidhur në të njëjtën shtëpi apo kompleks domosdoshmërisht i përkasin të njëjtës familje.

Profesioni: Profesioni është përcaktuar si një lloj aktiviteti ekonomik që një person zakonisht ndjek për të fituar të ardhura në para apo në natyrë. Nëse një person bën më shumë se dy profesione, profesioni për të cilin u shpenzuan orët e punës maksimale gjatë periudhës së referimit konsiderohet si profesioni kryesor. Nëse shpenzohet kohë e barabartë, profesioni që siguron pjesën më të madhe të të ardhurave konsiderohet si profesioni kryesor. Në këtë studim është përdorur sistemi kombëtar i klasifikimit.

Punë: Çfarëdolloj aktiviteti që është brenda kufijve të prodhimit të Sistemit të OKB-së për Llogaritë Kombëtare (SLLK) konsiderohet punë. Ky kufi mbulon të gjithë prodhimin e tregut dhe lloje të caktuara të prodhimit jo të tregut, duke përfshirë prodhimin dhe përpunimin e produkteve parësore për përdorim vetjak, ndërtimin për llogari të vet dhe prodhime të tjera të aseteve fikse për përdorim vetjak. Nëse aktiviteti kryhet në sektorin formal apo informal, në zonat urbane apo rurale, nëse është i paguar apo jo, nuk ka rëndësi; megjithatë, shërbimet e papaguara në familje, të kryera brenda familjes/shtëpisë nga dhe për anëtarët e kësaj shtëpie, janë të përjashtuara nga ky përkufizim i punës.

Shërbime të papaguara në familje (SHPF): Cilido aktivitet që është brenda kufirit të përgjithshëm të prodhimit, por jashtë kufirit të prodhimit të Sistemit të OKB-së për Llogaritë Kombëtare (SLLK), konsiderohet të jetë shërbim i papaguar në familje. Këto janë shërbime që kryhen nga dhe për anëtarët e familjes pa pagesë. Ato përfshijnë aktivitete të tilla, si: gatimi, hekurosja, pastrimi i shtëpisë, bërja e pazarit, kujdesi ndaj fëmijëve, kryerja e riparimeve të vogla etj. Disa shërbime të papaguara në familje - mbushja dhe transporti i ujit dhe mbledhja e druve të zjarrit për përdorim shtëpiak dhe për riparime të mëdha në shtëpi - trajtohen brenda kufirit të prodhimit të SLLK-së, prandaj dhe konsiderohen si punë.

Shtojca **B**: **VENDIMI nr. 207, datë 9.5.2002, MBI PËRCAKTIMIN E PUNËS SË VËSHTIRË APO TË RREZIKSHME**

Në ndjekje të nenit 100 të Kushtetutës dhe paragrafit 1 të nenit 100 të Ligjit 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i amenduar nga Ligji 8085, datë 13.3.1996, propozimi i ministrit dhe zëvendësministrit të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Përcaktimin si të vështirë apo të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e njeriut, si më poshtë:

a) Punën në miniera, nëntokë dhe në punë të tjera të kryera nga: asistentët në punë minerare, armaturë dhe zjarr (ISCO-08=811); menaxherët teknikë (personeli inxhiniero-teknik); teknikët e inxhinierisë së minierave (ISCO-08=311); punëtorët e ngarkim-shkarkimit dhe transportit (ISCO-08=931); personeli i shpëtimit dhe inspektimit, minierat dhe stafi i departamentit të inspektimit dhe shpëtimit (ISCO-08=821); personeli i shpëtimit dhe inspektimit, minierat dhe stafi i departamentit të shpëtimit dhe inspektimit, minierat, Tiranë (ISCO-08=311).

b) Punët në aviacionin civil kryer nga: komandanti; piloti i aviacionit (ISCO-315); navigatori (ISCO-315); mekaniku (ISCO-723); radio-telegrafi (ISCO-311); radio-telefonisti (ISCO-311).

c) Punët në fabrikat e pasurimit të bakrit, kromit dhe qymyrit, në fonderi dhe në uzinat e pasurimit të rërës bregdetare dhe uzinat e pasurimit të kuarcit, duke përfshirë:

punët në fonderi; punët në kovaçeri; punët në boilerat dhe mjete nën presion; saldimi me hark elektrik dhe puna me operatorë që automatizojnë saldimin; saldimi oksiacetilin (ISCO-721).

d) Punë të tilla, si:

zhytje, saldator, elektrosaldator, rezervuarë, kulla e serbatorë, punëtorët e pastrimit të pjesës së brendshme të rezervuarëve, punëtorët që punojnë me solucione aerosol, radioaktivitet; punëtorët që punojnë me rreze radioaktive dhe në mjedise me radioaktivitet; shoferët dhe ndihmëshoferët (ISCO-754).

e) Punët në fushën e arsimit dhe kulturës, si p.sh.:

balerinët dhe ansamblet e kërcimtarëve; akrobatët dhe gjimnastët e cirkut; solistët e operave; muzikantët e instrumenteve frymore, orkestrat dhe grupet muzikore (ISCO-265).

f) Punët në fushën e shëndetit:

me rrezatim jonizues (terapi me kobalt, radiologjia klasike, skaneri, rezonanca magnetike) (ISCO-221); laboratorët mikrobiologjikë (ISCO-221); shërbimi në kirurgji dhe anestezia në sallat e operacionit me gaz (ISCO-211).

g) Punët në industrinë e bakrit (ISCO-721).

h) Punët në industrinë kimike dhe përpunuese, si p.sh.:

prodhimi i baterive; përpunimi i lëkurës dhe gëzofit (ISCO-815); në fabrikat e letrës (ISCO-814).

i) Punët në industrinë metalurgjike, prodhimin e naftës dhe produkteve të saj, si p.sh.:

në metalurgjinë e ferrokromit; në uzinat e petëzimit; në uzinat e gizës; në furnalta; në prodhimin e substancave sintetike, në industrinë nxjerrëse, polietilen etj.

j) Punët në industrinë elektrike:

varja rreth 1.5 m mbi sipërfaqen e tokës; shërbimet në nënstacione me 110 kw e më tepër; shërbimet e pajisjeve që lëshojnë rreze monokromatike (laser), rrezet elektromagnetike, frekuenca e lartë, shumë e lartë, e ulët dhe shumë e ulët; në shërbimet elektrike të ngarkim-shkarkimit me kulla të lëvizshme; shërbimet operative në filialet elektrike dhe shpërndarje.

k) Punët në prodhimin e tullave dhe pllakave si edhe produkteve qeramike, si p.sh.:

prodhimi i çimentos (ISCO-811); prodhimi i qelqit dhe llambave elektrike; në industrinë e lëkurës; në industrinë e drurit, të letrës dhe pllakave të marangozerisë.

l) Punët në fermentim në industrinë e prodhimit të duhanit dhe të cigareve.

m) Punët në ndërtim:

punëtor i prodhimit të asfaltit (ISCO-931); punëtor që përgatit beton (ISCO-931); punëtor që ngre oxhage industriale (ISCO-931); punëtor që ngre shtylla; punëtor gjermimesh; punëtor me ekskavator (ISCO-834); minator në gurorë (ISCO-811); operator galvanizimi (ISCO-812); drejtues ruli; minator argjile; punëtor në poligrafi.

n) Punët në ndërmarrjet ushtarake:

çmontim municioni; nxjerrja e eksplozivit nga predhat; nxjerrja e barutit nga fishekët e municionit që duhen çmontuar; transportimi i municionit dhe eksplozivëve; manipulimi i enëve nën presion; prodhimi i baterive të thata (përgatitja e elektroliteve dhe përzierja e aglomerateve); në linja prodhimi në tunele; procese galvanizimi; prodhimi i fishekzjarrëve; prodhimi i gomave; saldimi me kallaj; në procesin e pastrimit të rërës; prodhimi i detonatorëve; në linjat e prodhimit dhe përpunimit të eksplozivëve; prodhimi dhe manipulimi i eksplozivëve etj.

Shtojca C: Sëmundje/dëmtime të shkaktuara nga puna te punëtorët fëmijë dhe te fëmijët që punojnë, por që nuk konsiderohen punëtorë fëmijë

Tabela A4.1. Sëmundje/dëmtime të shkaktuara nga puna te punëtorët fëmijë (%)

Lloji i sëmundjes/i dëmtimit	Të gjithë	Djem	Vajza
Prerje/dëmtime sipërfaqësore	2.1	3.0	0.4
Frakturë	0.2	0.3	0.0
Ndrydhje	1.0	1.5	0.0
Djegje, gërryerje, morth	0.3	0.5	0.0
Probleme të frymëmarrjes	0.7	1.0	0.0
Probleme me sytë	0.0	0.0	0.0
Probleme me lëkurën	1.3	0.8	2.0
Probleme me stomakun/diarre	0.9	0.8	1.0
Temperaturë	9.4	9.2	9.9
Lodhje ekstreme	9.9	10.1	9.5
Probleme të tjera	0.5	0.5	0.5
Çfarëdolloj sëmundjeje/dëmtimi	18.4	19.8	15.8
Numri i punëtorëve fëmijë	36 523	23 477	13 046

Shënim. Periudha e referimit për punësim është viti që parapriu studimin.

Tabela A4.2. Sëmundje/dëmtime të shkaktuara nga puna te fëmijët që punojnë të cilët nuk konsiderohen punëtorë fëmijë (%)

Lloji i sëmundjes/i dëmtimit	Të gjithë	Djem	Vajza
Prerje/dëmtime sipërfaqësore	2.8	4.0	1.4
Frakturë	0.0	0.0	0.0
Ndrydhje	0.2	0.3	0.0
Djegje, gërryerje, morth	0.0	0.0	0.0
Probleme të frymëmarrjes	0.0	0.0	0.0
Probleme me sytë	0.0	0.0	0.0
Problem me lëkurën	0.0	0.0	0.0
Probleme stomaku/diarre	0.5	0.0	1.1
Temperaturë	1.2	0.3	2.3
Lodhje ekstreme	3.7	6.7	0.0
Probleme të tjera	0.0	0.0	0.0
Çfarëdolloj sëmundjeje/dëmtimi	6.0	7.0	4.8
Nr. i fëmijëve që punojnë, të cilët nuk janë punëtorë fëmijë	21 558	11 995	9 563

Shënim. Periudha e referimit për punësim është viti që i parapriu studimit.

ANKETA KOMBËTARE PËR PUNËN E FËMIJËVE

(Drejtuar personit më të mirinformuar të familjes)

INFOMACION I PËRGJITHSHËM							
PREFEKTURA..... _ _ RRETHI..... _ _ BASHKIA/KOMUNA..... _ _ QYTETI/FSHATI _ _ _ EMRI DHE MBIEMRI I KRYEFAMILJARIT ADRESA E FAMILJES..... NUMRI I TELEFONIT (-----)				NUMRI I EA-së _ _ _ _ NUMRI I PSU-së _ _ _		NUMRI I NDERTESËS _ _ _	NUMRI I FAMILJES SË INTERVISTUAR _ _ _
VISITAT E ANKETUESIT				VIZITA E FUNDIT			
	1	2	3	DATA/MUAJI/VITI		_ _ - _ _ - _ _ _	
DATA				REZULTATI *		_	
VIZITA TJETËR				(*) KODET E REZULTATIT			
EMRI I ANKETUESIT _ _ _				01. Plotësuar 02. Asnjë pjesëtar i familjes në shtëpi ose asnjë person në shtëpi i aftë për t'u përgjigjur 03. Mungon e gjithë familja për një periudhë të gjatë kohe		04. Refuzim 05. Banesa bosh ose adresa nuk i korrespondon një banese 06. Banesa e shkatërruar 07. Banesa nuk u gjet 96. Tjetër (Specifiko).....	
EMRI I SUPERVIZORIT _ _ _				• Numri i personave në familje • Numri i fëmijëve (5-17 vjeç)		• _ _ • _ _	
EMRI I OPERATORIT _ _ _				Koha e fillimit: ____: ____		Koha e mbarimit: ____: ____	
				Nëse përdoren pyetësorë shtesë shëno Numrin		• _	

PJESA I: PYETËSORI I TË RRRITURVE

Drejtuar personit më të mirinformuar të familjes

SEKSIONI I: Përbërja e familjes dhe karakteristikat për të gjithë anëtarët e saj										
Numri rendor i personit në familje	Ju lutem, a mund të na i thoni emrat e plotë të të gjithë personave që janë pjesëtarë të kësaj familjeje, duke filluar nga kryefamiljari? <i>(Familja përcaktohet si një person ose grup personash të cilët jetojnë së bashku në të njëjtën shtëpi ose banesë, mirëmbajnë së bashku shtëpinë dhe plotësojnë nevojat për ushqime si një njësi. Anëtarët e një familjeje nuk kanë domosdoshmërisht lidhje gjaku apo martesore dhe jo të gjithë personat që jetojnë në të njëjtën shtëpi ose banesë janë domosdoshmërisht të së njëjtës familje)</i>	Cili prej pjesëtarëve të familjes dha informacionin mbi individin? (shkruaj numrin rendor nga A1)	Cila është lidhja e (EMRI) me kryefamiljarin? 1. Kryefamiljari 2. Bashkëshorti/bashkëshortja 3. Djali / Vajza 4. Vëllai / Motra 5. Nuseja e djalit / Dhëndri 6. Fëmija i fëmijës 7. Nipi / mbesa (fëmija i/e motrës/vëllait) 8. Fëmijë i bashkëshort-it/es 9. Babai/nëna, vjehri/vjehrra 10. Punëtor shtëpie (jeton aty) 11. Tjetër, i afërm 12. Tjetër, jo i afërm	Cila është gjinia e secilit prej individëve anëtarë të familjes? 1. Mashkull 2. Femër	Sa vjeç ishte (EMRI) në ditëlindjen e fundit të tij/saj? <i>(Në vite të plota)</i>	Shëno "1" nëse personi është 5-17 vjeç, <i>Përndryshe shëno "0"</i>	Cila është gjendja civile aktuale e (EMRI) (për personat 12 vjeç e lart) (për personat <12 vjeç vendos "0") 1. Beqar/e ose i/e pamartuar asnjëherë 2. I/e martuar 3. I/e martuar, por i/e ndarë 4. Martesë poligamike 5. Bashkëjeton 6. I/e divorcuar 7. I/e ve	Për të gjithë anëtarët e familjes		
								Ju lutemi tregoni numrin rendor të (EMRI) (Shkruani 95 nëse mungon ose nuk aplikohet)		
								Bashkëshorti/ja <i>(nëse aplikohet dhe ai/ajo është mes anëtarëve të familjes)</i>	Nëna natyrale <i>(nëse ajo është mes anëtarëve të familjes)</i>	Babai natyral <i>(nëse ai është mes anëtarëve të familjes)</i>
A1	A2	A3	A4	A5	A6	A7	A8	A9	A10	A11
01		□□	□□	□	□□	□	□	□□	□□	□□
02		□□	□□	□	□□	□	□	□□	□□	□□
03		□□	□□	□	□□	□	□	□□	□□	□□
04		□□	□□	□	□□	□	□	□□	□□	□□
05		□□	□□	□	□□	□	□	□□	□□	□□
06		□□	□□	□	□□	□	□	□□	□□	□□
07		□□	□□	□	□□	□	□	□□	□□	□□
08		□□	□□	□	□□	□	□	□□	□□	□□

SHËNIM I RËNDËSISHËM: SEKSIONI II e në vazhdim të plotësohet sipas kolonave, duke filluar me nr. rendor 01 nga A1.

SEKSIONI II:	Arsimimi për të gjithë anëtarët e familjes në moshë 5 vjeç e lart																
Nr. rendor në A1																	Shko te pyetja
Emri i anëtarit të familjes →																	
Mosha e anëtarit të familjes →																	
A12. A mundet (EMRI) të lexojë e të shkruajë një deklaratë të shkurtër e të thjeshtë me kuptim në ndonjë gjuhë? 1. Po..... 2. Jo.....	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	→A14 →A15
A13. Gjatë këtij viti shkollor a është (EMRI) duke ndjekur shkollën ose edukimin parashkollor? 1. Po..... 2. Jo.....	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	
A14. Cilin nivel shkollor dhe cilin vit është duke ndjekur (EMRI)? Niveli: (N) Klasa: (K)	N	K	N	K	N	K	N	K	N	K	N	K	N	K	N	K	A18 A16
1. Parashkollor.....	1		1		1		1		1		1		1		1		
2. Fillor.....	2		2		2		2		2		2		2		2		
3. 8/9 vjeçare (klasa V-IX).....	3		3		3		3		3		3		3		3		
4. I mesëm.....	4		4		4		4		4		4		4		4		
5. Universitet ose më lart.....	5		5		5		5		5		5		5		5		
6. Program mësimor jostandard...	6		6		6		6		6		6		6		6		
8. Nuk e di.....	8		8		8		8		8		8		8		8		

Nr. rendor në A1																	Shko te pyetja									
Emri i anëtarit të familjes →																										
Mosha e anëtarit të familjes →																										
A15. A e ka ndjekur (EMRI) ndonjëherë shkollën?																									→A16 →A17	
1. Po..... 2. Jo.....	1 2		1 2		1 2		1 2		1 2		1 2		1 2		1 2		1 2									
A16. Cili është niveli dhe klasa më e lartë e shkollimit që ka përfunduar (EMRI)? <i>Niveli: (N) Klasa: (K)</i>	N	K	N	K	N	K	N	K	N	K	N	K	N	K	N	K	} A18									
1. Parashkollor..... 2. Fillor..... 3. 8/9 vjeçar (klasa V-IX)..... 4. I mesëm..... 5. Universitet ose më lart	1 2 3 4 5	☐ ☐ ☐ ☐ ☐	1 2 3 4 5	☐ ☐ ☐ ☐ ☐	1 2 3 4 5	☐ ☐ ☐ ☐ ☐	1 2 3 4 5	☐ ☐ ☐ ☐ ☐	1 2 3 4 5	☐ ☐ ☐ ☐ ☐	1 2 3 4 5	☐ ☐ ☐ ☐ ☐	1 2 3 4 5	☐ ☐ ☐ ☐ ☐	1 2 3 4 5	☐ ☐ ☐ ☐ ☐										
6. Program mësimor jostandard 8. Nuk e di.....	6 8	☐ ☐	6 8	☐ ☐	6 8	☐ ☐	6 8	☐ ☐	6 8	☐ ☐	6 8	☐ ☐	6 8	☐ ☐	6 8	☐ ☐										
A17. Cila është/ishte arsyeja kryesore pse (EMRI) nuk e ka ndjekur asnjëherë shkollën? <i>(Lexo secilën nga alternativat e mëposhtme dhe rretho alternativën më të rëndësishme)</i>																										} A18
1. Shumë i ri/e re 2. I/e paafte / i/e sëmurë..... 3. Nuk ka shkollë/shkola shumë larg 4. Nuk mund ta përballojë shkolimin..... 5. Familja nuk e lejon të shkollohet... 6. Nuk është i/e interesuar për t'u shkolluar..... 7. Shkolimi nuk konsiderohet i vlefshëm. 8. Shkolla jo e sigurt..... 9. Për të mësuar një punë..... 10. Për të punuar kundrejt pagesës 11. Për të punuar si punëtor pa pagesë në biznesin/fermën e familjes 12. Për të ndihmuar në punët e përditshme të shtëpisë 96. Tjetër	01 02 03 04 05 06 07 08 09 10 11 12 96		01 02 03 04 05 06 07 08 09 10 11 12 96		01 02 03 04 05 06 07 08 09 10 11 12 96		01 02 03 04 05 06 07 08 09 10 11 12 96		01 02 03 04 05 06 07 08 09 10 11 12 96		01 02 03 04 05 06 07 08 09 10 11 12 96		01 02 03 04 05 06 07 08 09 10 11 12 96		01 02 03 04 05 06 07 08 09 10 11 12 96											
Tjetër (specifiko)																										

SEKSIONI III:

Statusi aktual i aktivitetit ekonomik i të gjithë anëtarëve të familjes (5 vjeç e lart) gjatë javës së referencës

Nr. rendor në A1										Shko te pyetja
Emri i anëtarit të familjes →										
Mosha e anëtarit të familjes →										
A. Punësimi										
A18. Gjatë javës së kaluar, a ka kryer (EMRI) ndonjë punë qoftë dhe për një orë? (Si i punësuar me pagë, i vetëpunësuar, punëdhënës ose punëtor pa pagesë në biznesin e familjes) 1. Po..... 2. Jo.....	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	→A21 →A19
A19. Gjatë javës së kaluar, a ka kryer (EMRI) ndonjë nga aktivitetet e mëposhtme, qoftë dhe për vetëm një orë? (Lexo secilën prej pyetjeve që vijojnë deri sa të merret një përgjigje pohuese) (a) A ka drejtuar ose bërë ndonjë lloj biznesi, të vogël ose të madh, vetëm ose me një, ose më shumë bashkëpunëtorë? Shembuj: Ka shitur gjëra, prodhuar për të shitur, riparuar gjëra, ruajtur makinat, parukeri, shërbim çerdhe për fëmijë, shërbim taksie ose transporti tjetër, ka një aktivitet praktik ligjor ose mjekësor, interpretuar në publik, berber, lustraxhi këpucësh etj. (b) A ka kryer ndonjë punë kundrejt një page, rroge, komisioni ose ndonjë pagese në natyrë (përfshijë punët e shtëpisë)? Shembuj: Një punë të rregullt, me kontratë, të rastit ose një punë të paguar për copë, punë në këmbim të ushqimit apo strehimit. (c) A ka kryer ndonjë punë si punëtor në ndonjë shtëpi tjetër kundrejt një page, rroge ose pagese në natyrë? (d) A ka ndihmuar pa pagesë në një biznes të familjes të ndonjë lloji? (Pa përfshirë punët e zakonshme të shtëpisë.) Shembuj: Ka ndihmuar për të shitur, ka prodhuar gjëra për të shitur ose për të këmbyer, ka mbajtur llogaritë, pastruar për biznesin etj. (e) A ka bërë ndonjë punë në tokën, fermën, kopshtin e tij/saj ose të familjes, ose a ka ndihmuar në prodhimin bujqësor apo është kujdesur për kafshët e familjes? Shembuj: Lëruar tokën, korrur, kujdesur për bagëtitë. (f) A ka bërë ndonjë ndërtim apo punë riparuese të madhe në shtëpinë, kopshtin, biznesin e tij/saj apo atyre të familjes? (g) A ka zënë peshk, karkaleca, midhje, kafshë të egra ose ndonjë ushqim tjetër për shitje ose për të ushqyer familjen? (h) A ka mbushur ujë ose mbledhur dru zjarri për t'u përdorur nga familja? (i) A ka prodhuar ndonjë të mirë tjetër për t'u përdorur nga familja? Shembuj: veshje, mobilie, poçe argjile etj.	1 = PO 2 = JO	1 = PO 2 = JO	1 = PO 2 = JO	1 = PO 2 = JO	1 = PO 2 = JO	1 = PO 2 = JO	1 = PO 2 = JO	1 = PO 2 = JO	1 = PO 2 = JO	Nëse ka ndonjë "PO" → A21 Përndryshe →A20

Nr. rendor në A1									Shko te pyetja
Emri i anëtarit të familjes →									
Mosha e anëtarit të familjes →									
A20. Megjithëse (EMRI) nuk ka kryer ndonjë nga këto aktivitete gjatë javës së kaluar, a ka ai/ajo një punë, biznes apo aktivitet tjetër ekonomik apo bujqësor në të cilin do të kthehet? <i>(Për aktivitetet bujqësore, periudha jo sezonale në bujqësi nuk është mungesë e përkohshme.)</i> 1. Po..... 2. Jo.....	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	→ A21 → A33
A21. Përshkruani profesionin/punën/detyrën kryesore që po kryente (EMRI) p.sh. po barte tulla; po përziente miellin e bukës; po korrote misrin; etj. <i>("kryesore" i referohet punës në të cilën (EMRI) shpenzon kohën më të madhe gjatë javës)</i>									
Profesioni/Puna/Detyra									
KODI I PROFESIONIT <i>Për kodim në zyrë</i>									
A22. Përshkruani shkurt aktivitetin kryesor p.sh. të mirat e prodhuara dhe shërbimet e kryera në vendin ku (EMRI) punon.									
Aktiviteti/Tipi									
KODI I AKTIVITETIT <i>Për kodim në zyrë</i>									
A23. Në ç'vend e kreu (EMRI) punën e tij/saj kryesore gjatë javës së kaluar? (Lexo me zë përgjigjet e mëposhtme) 1. Në banesën e familjes së tij/saj... 2. Në vendin ku është klienti 3. Zyrë 4. Fabrikë / Punishte 5. Fermë / kopsht / plantacion 6. Kantieret e ndërtimit..... 7. Miniera / gurore..... 8. Dyqan / kioskë / bar kafe / restorant / hotel 9. Vende të ndryshme (i lëvizshëm)..... 10. Vend fiks, rrugë ose tezgë në treg 11. Liqen / lumë / pellg 96. Tjetër.....	01 02 03 04 05 06 07 08 09 10 11 96	01 02 03 04 05 06 07 08 09 10 11 96	01 02 03 04 05 06 07 08 09 10 11 96	01 02 03 04 05 06 07 08 09 10 11 96	01 02 03 04 05 06 07 08 09 10 11 96	01 02 03 04 05 06 07 08 09 10 11 96	01 02 03 04 05 06 07 08 09 10 11 96	01 02 03 04 05 06 07 08 09 10 11 96	
Tjetër (specifiko)									
A24. Gjatë javës së kaluar, cila nga të mëposhtmet e përshkruan më mirë situatën e (EMRI) në punën e tij/saj kryesore? <i>(Lexo me zë përgjigjet e mëposhtme)</i> 1. I punësuar me pagë..... 2. Punëtor për llogari të vet (Në biznesin e tij/saj pa të punësuar të tjerë kundrejt një page) 3. Punëdhënës (Në biznesin e tij/saj me të punësuar të tjerë kundrejt një page) 4. Punëtor pa pagesë i familjes.....	1 2 3 4	1 2 3 4	1 2 3 4	1 2 3 4	1 2 3 4	1 2 3 4	1 2 3 4	1 2 3 4	→A25 } A28 →A30

Nr. rendor në A1									Shko te pyetja
Emri i anëtarit të familjes →									
Mosha e anëtarit të familjes →									
A25. A është i punësuar (EMRI) mbi bazën e një ...									
1. Kontrate të shkruar.....	1	1	1	1	1	1	1	1	
2. Marrëveshje gojore.....	2	2	2	2	2	2	2	2	
8. Nuk e di.....	8	8	8	8	8	8	8	8	
A26. A është kontrata/marrëveshja e (EMRI).....									→A27 } A28
1. Me kohëzgjatje të caktuar.....	1	1	1	1	1	1	1	1	
2. Me kohëzgjatje të pacaktuar.....	2	2	2	2	2	2	2	2	
8. Nuk e di.....	8	8	8	8	8	8	8	8	
A27. Sa është kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes së (EMRI)?									
1. Më pak se 12 muaj.....	1	1	1	1	1	1	1	1	
2. 12-36 muaj.....	2	2	2	2	2	2	2	2	
3. Më shumë se 36 muaj.....	3	3	3	3	3	3	3	3	
8. Nuk e di.....	8	8	8	8	8	8	8	8	
A28. Sa është e ardhura mesatare mujore që merr (EMRI) nga puna kryesore? (në lekë të vjetra)									
Kontrollo A24! Në se A24=2 ose 3 atëherë kalo tek A30									
A29. Çfarë përfitimesh të tjera merr zakonisht (EMRI) në punën e tij/saj kryesore? (Lexo secilën nga pyetjet e mëposhtme dhe rretho përgjigjet. Lejohen më shumë se një përgjigje)									
A. Ditë jave pushim....	A	A	A	A	A	A	A	A	
B. Shpenzime mjekësore.....	B	B	B	B	B	B	B	B	
C. Shpenzime shkollimi.....	C	C	C	C	C	C	C	C	
D. Ndihmë për shkollimin ...	D	D	D	D	D	D	D	D	
E. Leje të paguar për sëmundje.....	E	E	E	E	E	E	E	E	
F. Pushime vjetore.....	F	F	F	F	F	F	F	F	
G. Strehim falas ose të subvencionuar.....	G	G	G	G	G	G	G	G	
H. Ushqim / vakte ngrënie.....	H	H	H	H	H	H	H	H	
I. Leje të paguar	I	I	I	I	I	I	I	I	
J. Veshje.....	J	J	J	J	J	J	J	J	
K. Transport.....	K	K	K	K	K	K	K	K	
U. Tjetër	U	U	U	U	U	U	U	U	
X. Nuk e di	X	X	X	X	X	X	X	X	
Y. Asgjë.....	Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y	
Tjetër (specifiko)									

[illegible]

Nr. rendor në A1									Shko te pyetja	
Emri i anëtarit të familjes →										
Mosha e anëtarit të familjes →										
B. Papunësia									5-9 vjeç	10 vjeç e lart
A33. A po kërkonte punë (EMRI) gjatë javës së kaluar? <i>(Si i punësuar me pagë, punëdhënës ose punëtor për llogari të vet për të ngritur biznesin e tij/saj)</i>									A37	→A34 →A35
1. Po..... 2. Jo.....	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2	1 2		
A34. Në çfarë mënyrash ka kërkuar (EMRI) punë gjatë katër javëve të kaluara? <i>(Shëno deri në 4 kutiza)</i>									A37	→A35
A. U ka kërkuar shokëve ose të afërme për t'i gjetur një punë	A	A	A	A	A	A	A	A		
B. Ka aplikuar në zyrën e punës/ndërmjetës	B	B	B	B	B	B	B	B		
C. Ka vendosur ose i është përgjigjur lajmërimeve për punë në gazeta	C	C	C	C	C	C	C	C		
D. Ka paraqitur një aplikim për punë	D	D	D	D	D	D	D	D		
E. Është përpjekur të sigurojë pajisje, kredi dhe/ose një vend për të ngritur biznesin e tij/saj	E	E	E	E	E	E	E	E		
U. Tjetër	U	U	U	U	U	U	U	U		
X. Nuk e di.....	X	X	X	X	X	X	X	X		
Y. Asgjë.....	Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y	Y		
Tjetër (specifiko)										→A35
A35. A dëshironte (EMRI) të punonte gjatë javës së kaluar?										
1. Po.....	1	1	1	1	1	1	1	1		→A36
2. Jo.....	2	2	2	2	2	2	2	2		→A39
A36. Cila është arsyeja kryesore pse (EMRI) nuk kërkoi punë gjatë javës së kaluar? <i>(Shëno arsyen më të rëndësishme)</i>										
1. Ka gjetur një punë por pret ta fillojë.....	01	01	01	01	01	01	01	01		
2. Punëtor sezonal	02	02	02	02	02	02	02	02		
3. Është lodhur duke kërkuar punë, beson që nuk ka punë të disponueshme që t'i përshtatet.....	03	03	03	03	03	03	03	03		
4. Nuk i plotëson kërkesat e punëdhënësve (trajnim, eksperiencë, kualifikime).....	04	04	04	04	04	04	04	04		
5. Nuk di se ku të kërkojë për një punë.....	05	05	05	05	05	05	05	05		
6. Student (vazhdon studimet).....	06	06	06	06	06	06	06	06		
7. Nuk e lejon familja/prindërit/bashkëshort-i/ja	07	07	07	07	07	07	07	07		
8. I/e angazhuar në punët e shtëpisë	08	08	08	08	08	08	08	08		
